



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 75

Tiranë – E enjte, 20 maj 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13068, datë 14.5.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	8193
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 276, datë 12.5.2021	Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021–2025.....	8193
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2, datë 5.5.2021	Për kriteret e kualifikimit dhe kategoritë e drejtimit të mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë.....	8262
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 197, datë 10.5.2021	Për miratimin e rregullores “Për transportin ajror të mallrave të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë”.....	8274

**DEKRET**

Nr. 13068, datë 14.5.2021

**PËR LEJIMIN E LËNIES
SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 13 e 20, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Elvis Mehmet Ypi
2. Merita Kujtim Almeta (Allko)
3. Xhoi Mersin Sinani
4. Rudina Reshit Ipeku
5. Iris Viktor Melonashi
6. Viola Arjan Kastrati
7. Venera Arjan Kastrati
8. Ina Ridvan Korça
9. Jola Odhise Bresha
10. Vojna Xhevair Ngjeqari
11. Lorin Ylli Lofca
12. Suzana Enver Pano (Myftari)
13. Vjollca Saqo Weibenbach (Shtaro)
14. Fatbardha Ndoc Ukcama
15. Caterina Rosa Giuseppe Russo
16. Cristina Giuseppe Russo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 276, datë 12.5.2021

**PËR MIRATIMIN E PLANIT
KOMBËTAR PËR PERSONAT ME AFTËSI
TË KUFIZUARA, 2021–2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021–2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministritë dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

**PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA,
2021–2025**

Draft final
Prill 2021

PËRMBAJTJA**SHKURTIMET****PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK**

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

2. Kuadri ligjor dhe institucional

2.1 Kuadri ligjor

2.2 Kuadri strategjik

3. Arritjet, analiza dhe sfidat

4. Vizioni dhe misioni i Strategjisë

4.1 Vizionidhe misioni

4.2 Tregues të impaktit dhe rezultatit

**PJESA II. QËLLIMI I POLITIKAVE DHE
OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË**

Qëllimi i politikës 1. Realizimi i aksesueshmërisë në mjedise, shërbime, transport dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara

Objekti i specifik 1.1. Realizimi i aksesueshmërisë në mjedise për personat me aftësi të kufizuara



Objektivi specifik 1.2. Realizimi i aksesueshmërisë në transport për personat me aftësi të kufizuara

Objektivi specifik 1.3. Realizimi i aksesueshmërisë në informacion dhe komunikim për personat me aftësi të kufizuara

Qëllimi i politikës 2. Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara

Objektivi specifik 2.1. Rritja e numrit të individëve me aftësi të kufizuara që përdorin shërbimet e ndihmës juridike falas

Objektivi specifik 2.2. Njohja e barabartë para ligjit të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht të personave me aftësi të kufizuara mendore

Objektivi specifik 2.3. Garantimi i respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në institucionet e dënimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare

Qëllimi i politikës 3. Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe nxitja e mundësive të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara

Objektivi specifik 3.1. Rritja e cilësisë në shërbimet e aftësimin për të nxitur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

Objektivi specifik 3.2. Rritja e mundësive për punësim dhe vetëpunësim për personat me aftësi të kufizuara

Objektivi specifik 3.3. Përmirësimi i cilësisë dhe i efikasitetit të shërbimeve, që synojnë nxitjen e integritetit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

Qëllimi i politikës 4. Sigurimi dhe ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara

Objektivi specifik 4.1. Rritja e mundësive për pjesëmarrje në arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me lloje të ndryshme të AK-së

Objektivi specifik 4.2. Shndërrimi i shkollave të specializuara në qendra burimore, duke përfshirë dhe duke mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës

Qëllimi i politikës 5. Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitumeve të aksesueshme, të përballueshme financiarisht dhe që kanë në qendër klientin.

Objektivi specifik 5.1. Monitorimi i efekteve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga komisionet e

reja, sipas modelit të të drejtave të njeriut që përcakton KDDPAK-në

Objektivi specifik 5.2. Ofrimi i shërbimeve të integruara sociale me anë të kombinimit të pagesave me para në dorë (*cash*) me kujdesin social cilësor

Objektivi specifik 5.3. Promovimi dhe nxitja e jetesës së pavarur nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve sociale komunitare

Qëllimi i politikës 6. Ofrimi i një kujdesi shëndetësor të aksesueshëm e të përballueshëm për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara

Objektivi specifik 6.1. Lehtësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara

Objektivi specifik 6.2. Zhvillimi i shërbimeve të parandalimit, ndërhyrjes së hershme dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara

Qëllimi i politikës 7. Garantimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike në Shqipëri dhe mundësimi i mbrojtjes së interesave të tyre

Objektivi specifik 7.1. Rritja e numrit të personave me aftësi të kufizuara në procesin e votimit, dhënia e mundësisë për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje

Objektivi specifik 7.2. Rritja e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike dhe promovimi i punës së artistëve me aftësi të kufizuara

Objektivi specifik 7.3. Rritja e mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitete dhe evenimente sportive kombëtare dhe ndërkombëtare

Qëllimi i politikës 8. Krijimi i sinergjive ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm për nxitjen dhe monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë të plotë, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme

Objektivi specifik 8.1. Forcimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet strukturave qendrore dhe pushtetit vendor dhe ndërveprimi me OPAK-un në të gjitha nivelet

Objektivi specifik 8.2. Përmirësimi i funksionimit të KKA-së lidhur me koordinimin e politikave publike në nivel horizontal dhe vertikal, të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara



Objektivi specifik 8.3. Ngritja e një sistemi statistikor të qëndrueshëm, për matjen e indikatorëve të monitorimit, në reference dhe përputhje me treguesit e SDG-së për aftësinë e kufizuar.

Objektivi specifik 8.4. Nxitja e bashkëpunimit rajonal për zbatimin e KDPAK-së

PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Përgjegjësia e institucioneve

Raportimi dhe monitorimi

PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE

Shkurtime

AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ANAD	Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë Arsimit Parauniversitar
AZBZH	Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim
BB	Banka Botërore
DBE	Delegacioni i Bashkimit Evropian
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
DPPS	Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale
GTNP	Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës
GTIS	Grupi i Treguesve dhe i Integritetit të Statistikave
IEVP	Institucioni Ekzekutimit të Veprave Penale
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
ISHPSHS	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KKAK	Këshilli Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar
KMCAP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KNF	Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit
KSHP	Kujdesi Shëndetësor Parësor
KVAK	Komisioni i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MK	Ministria e Kulturës
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJF	Ndihma Juridike Falas
NJPF	Ndihma Juridike Parësore Falas
NJDF	Ndihma Juridike Dytësore Falas
NJMF	Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
NJVRN	Njësia e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPAK	Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara
PEI	Plani Edukativ Individual
PKVPAK	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara
QFP	Qendra e Formimit Profesional
RSH	Republika e Shqipërisë
SESIMS	Sistemi Evropian i Statistikave të Integuara të Mbrojtjes Sociale
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZVAP	Zyrat vendore të arsimit parauniversitar



PJESA I KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

Në rrugëtimin për të qenë një anëtare e familjes së madhe evropiane, Shqipëria bën përpjekje të vazhdueshme për të ndërtuar një shoqëri që respekton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe ndalon diskriminimin. Ushtrimi i plotë dhe i barabartë i të gjitha të drejtave të personave me aftësi të kufizuara është një përparësi kombëtare që kërkon politikë aktive, të qëllimshme dhe të qëndrueshme, si dhe veprime të përbashkëta të autoriteteve qendrore dhe lokale, institucioneve të pavarura dhe pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile e sidomos të organizatave përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara.

Kushtet e jetesës së personave me aftësi të kufizuara shpesh perceptohen si çështje që duhet të përfshihen vetëm në fushën e çështjeve sociale apo të kujdesit shëndetësor. Qasja që sjell Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) për aftësinë e kufizuar si një qasje e lidhur drejtpërdrejt me realizimin e të drejtave të njeriut, por edhe karakteri, shkakët dhe kërkesat e aftësisë së kufizuar, e kanë bërë tashmë të qartë fizionominë gjithëpërfshirëse të këtij dokumenti politik për aftësinë e kufizuar. Një nga karakteristikat kryesore të politikave për personat me aftësi të kufizuara është se ndikon në mënyrë të barabartë në secilën fushë të jetës dhe në të gjithë sektorët. Prandaj kjo kërkon vëmendjen maksimale dhe të kujdesshme të të gjitha ministrive të linjës me qëllim hartimin e politikave specifike, të efektshme dhe të koordinuara.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PKVPAK) 2021–2025, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5-vjeçarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritetit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit, duke pasur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDPAK-së përmes masave specifike. Ky plan, vjen si një dokument vijues i PKVPAK 2016–2020.

Hartimi i PKVPAK 2021–2025 kaloi nëpërmjet një procesi të udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës (GTNP) i ngritur me urdhër nr. 528, datë 25.9.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Procesi i formulimit dhe i konsultimit të dokumentit u realizua me asistencën teknike të dy ekspertëve vendës të UNDP-së si pjesë e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas/Leave No One Behind” (LNB), që zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe mbështetet nga Qeveria Zvicerane (SDC).

Procesi i hartimit të këtij dokumenti përputhet edhe me një moment tjetër të rëndësishëm të zbatimit të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri në funksion të realizimit të parimeve të KDPAK-së, të ratifikuar nga shteti shqiptar në shkurt 2013. Sipas procedurës monitoruese të Konventës, në gusht 2019, qeveria shqiptare kreu raportimin e parë përpara Komitetit të KDPAK-së për progresin gjatë këtyre viteve në funksion të zbatimit të parimeve dhe neneve të kësaj Konvente. Rekomandimet e Komitetit në vëzhgimet përmbyllëse të raportit fillestar të Shqipërisë, duhet të adresohen e të përkthehen në masa dhe veprime konkrete në të gjitha fushat që prekin personat me aftësi të kufizuara. PKVPAK-ja është hartuar në mbështetje të zbatimit të rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në OKB. Një tjetër dokument referimi në përcaktimin e masave të këtij plani është raporti i monitorimit dhe i vlerësimit afatmesëm të PKVPAK 2016–2020¹ që u krye në vitin 2018 dhe që përfshin një sërë rekomandimesh për përmirësimin e politikave në vitet në vijim.

Financimi për zbatimin e masave të parashikuara në PKVPAK 2021–2025, është parashikuar në buxhetin e shtetit, pas një vlerësimi të fondeve të disponueshme në ministrinë përkatëse të linjës. Në rastet kur buxheti i shtetit nuk është i mjaftueshëm për

1

<https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/raport-monitorimi-dhe-vleresimi-afatmesem-i-planit-kombetar-te-v.html>



përmbushjen e plotë të objektivave, PKVPAK parashikon një ndarje të hendeut të financimit, si dhe propozimin për fonde donatorësh. Gjithashtu, fondet dhe lloje të tjera burimesh të ofruara nga njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqëria civile janë thelbësore për nxitjen e përfshirjes në nivel vendor, por ato nuk pasqyrohen në këtë Plan Kombëtar Veprimi, i cili fokusohet në angazhimet, aktivitetet dhe buxhetet e qeverisjes qendrore.

Zbatimi i PKVPAK 2021–2025, do të monitorohet nga Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK), nëpërmjet Sekretariatit Teknik dhe me përfshirjen direkte të pikave fokale në ministritë e linjës. Zbatimi i suksesshëm i këtij plani bazohet në bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet aktorëve të ndryshëm për politikatat dhe legjislacionit, kryesisht i institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore dhe organizatave të shoqërisë civile.

2. Kuadri ligjor dhe institucional

Shqipëria ka një kuadër ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike që adresojnë çështjet e personave me aftësi të kufizuara. Një nga prioritetet kryesore në Programin e Qeverisë Shqiptare është “Mirëqenia dhe shërbime publike për të gjithë qytetarët”.

2.1 Kuadri ligjor

Legjislacioni kombëtar ka shumë akte ligjore dhe nënligjore që ndikojnë te personat me aftësi të kufizuara në të gjithë sferat e jetës, duke përfshirë sektorë të ndryshëm, si: arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale, drejtësia, punësimi dhe aftësimi, strehimi social, pjesëmarrja në jetën politike dhe publike, kultura etj.

Të drejtat dhe barazia

Ligji nr. 108/2012, datë 15.11.2012, “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së ‘Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara’”.

Ligji nr. 93/2014, datë 24.7.2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

Ligji nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (i ndryshuar).

VKM-ja nr. 837, datë 3.12.2014, “Për njohjen e gjuhës së shenjave në Republikën e Shqipërisë”.

VKM-ja nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për masat për heqjen e pengesave mjedisore dhe të infrastrukturës në ofrimin e shërbimeve publike”.

VKM-ja nr. 411, datë 19.6.2019, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 708, datë 26.8.2015, të Këshillit të Ministrave, ‘Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivelin qendror dhe lokal’”.

VKM-ja nr. 196, datë 4.4.2018, për një ndryshim në vendimin nr. 48, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e kufizuar”.

VKM-ja nr. 874, datë 24.12.2019, “Për mënyrën e ofrimit të ndihmës personale dhe kriteret për zgjedhjen e ndihmës personal”.

Ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Aksesueshmëria

Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.

Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

VKM-ja nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar.

VKM-ja nr. 85, datë 8.2.2017, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”.

Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

Ligji nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Udhëzimi nr. 4038, datë 4.9.2015, “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare, që ofrohen pa pagesë, për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër” (i ndryshuar).

Udhëzimi nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionin për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar.

Udhëzimi nr. 3743, datë 10.7.2017, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve” (ndryshuar me udhëzimin nr. 436, datë 9.5.2018), i ndryshuar.

Udhëzimi nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, i ndryshuar.



Udhëzim nr. 446, datë 10.5.2018, “Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve”

Rregullore nr. 7, datë 8.7.2008, “Për pajisjen me leje drejtimi të posaçëm të personave me aftësi të kufizuara dhe përcaktimi i ndryshimeve të karakteristikave konstruktive ose funksionale të mjeteve rrugore me motor të tyre”.

Ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive.

Arsimi

Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 79/2017, “Për sportin”, i ndryshuar.

Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”

Urdhri nr. 31, datë 28.1.2020, “Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

Punësimi dhe aftësimi

Ligji nr. 7961/1995, “Kodi i punës së Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”.

Ligji nr. 15/2017, “Për arsimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

VKM-ja nr. 177/2020, “Për përbërjen, kriteret dhe detyrat e bordit të administrimit të fondit social të punësimit dhe mënyrat e përdorimit të tij”.

VKM-ja nr. 17/2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, i ndryshuar.

VKM-ja nr. 348/2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”.

VKM-ja nr. 535/2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”

Ndihma dhe kujdesi social

Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në RSH”.

Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar;

Ligji nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar.

Ligji nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar.

VKM-ja nr. 597, datë 4.9.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

VKM-ja nr. 182, datë 26.2.2020, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, e ndryshuar.

VKM-ja nr. 722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”.

VKM-ja nr. 431, datë 8.6.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, e ndryshuar.

VKM-ja nr. 277, datë 18.6.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar.

VKM-ja nr. 31, datë 20.1.2001, “Përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar.

VKM-ja nr. 869, datë 18.6.2008, “Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, ‘Statusi i invalidit’”;

VKM-ja nr. 78, datë 7.2.2007, “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, i ndryshuar.

VKM-ja nr. 837, datë 3.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për njohjen e gjuhës së shenjave në Republikën Shqipërisë”.

VKM-ja nr. 404, datë 20.6.2012, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik



për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”.

VKM-ja nr. 565, datë 9.8.2006, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, e ndryshuar.

VKM-ja nr. 8, datë 14.1.2015, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 lekë në muaj”.

Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 65/2016, datë 9.6.2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.

VKM-ja nr. 518, datë 4.9.2018, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

VKM-ja nr. 822, datë 6.12.2006, “Për standardet e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për personat me aftësi të kufizuara në qendrat rezidenciale dhe ditore”.

VKM-ja nr. 658, datë 17.10.2005, “Për standardet e shërbimeve shoqërore në Shqipëri”.

VKM-ja nr. 56, datë 31.1.2018, “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”.

Udhëzimi i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 597, datë 22.12.2017, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuara”.

Urdhri i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 381, datë 23.6.2020, “Për miratimin e protokollit për funksionimin e qendrave publike dhe jopublike, jorezidenciale, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, gjatë dhe pas periudhës së fatkeqësisë natyrore, deri në përfundim të masave të distancimit fizik/social, për shkak të epidemisë COVID-19”.

Strehimi

Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

VKM-ja nr. 555, datë 15.7.2020, “Për procedurat, kriteret dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit”.

VKM-ja nr. 362, datë 29.5.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”.

VKM-ja nr. 58 për banesat e specializuara, e cila pritet të miratohet sa më parë.

VKM-ja nr. 454, datë 3.7.2019, “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”.

VKM-ja nr. 301, datë 15.4.2020, “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”.

Shëndetësia

Ligji nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2021, “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar.

Ligji nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar.

Kultura

Ligji nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Ligji nr. 10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar.

Ligji nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme”.

VKM-ja nr. 776, datë 14.12.2005, “Për vendosjen e çmimeve të reduktuara të biletave të muzeve publike për kategori të caktuara shoqërore”, i ndryshuar.

2.2 Kuadri strategjik

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015–2020.

Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale, 2016–2020.

Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar, 2016–2020.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2019–2022.

Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit për Mbrojtjen Sociale, 2020–2023.

Dokumenti politik “Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit, 2019–2024”.

Plan Kombëtar i Deinstitutionalizimit, 2020–2022.

Strategjia Kombëtare Shëndetësore, 2016–2020.

Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri, 2020–2025.



Plani i Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri, 2013–2022.

Strategjia e Strehimit Social, 2016–2025.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, 2016–2020.

Strategjia Kombëtare për Kulturën, 2019–2025.

Ndërlidhja me dokumentet e tjera strategjike

Programi i Qeverisë Shqiptare, 2017–2021.

Lidhja me prioritetet e qeverisë – Mirëqenia dhe shërbime publike për të gjithë qytetarët.

Lidhja me PKIE-në dhe legjislacionin e BE-së: kapitulli 23, nënkaptulli: Të drejtat themelore të njeriut dhe kapitulli 19, nënkaptulli: Përfshirja sociale dhe personat me aftësi të kufizuara.

Lidhje me OZHQ-të – 1, 4, 8, 10, 11, 16.

Lidhja me SKZHI-në

PKVPAK 2021–2025, si një dokument strategjik që parashikon politikat për personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë është tërësisht nën ombrellën dhe në përputhje me objektivat strategjike të dokumentit themelor strategjik “Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim”. Sipas SKZHI-së 2015–2020:

Shtylla 3: Investimi në kapital njerëzor dhe kohezion social

Qëllimi i politikës: Forcimi i të drejtave të njeriut

Objektivat strategjike: Rritja e integritetit dhe e sigurimit të të drejtave të njeriut përmes:

- Sigurimit të një kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare; veçanërisht nëpërmjet: i. përmirësimit të legjislacionit për krijimin e mekanizmave të monitorimit dhe të ndjekjes në lidhje me zbatimin e të gjitha konventave të të drejtave të njeriut të ratifikuara nga Shqipëria; ii. plotësimit të kuadrit ligjor në zbatim të ligjit kuadër “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

- Sigurimi i një jete të pavarur për personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet: i. sigurimit të ofrimit të shërbimeve të integruara socioshëndetësore; ii. sigurimit të një jetese dinjitoze me anë të indeksimit të pagave, punësimit, rritjes së qasjes së tyre në transportin urban dhe ndërrurban, duke përmirësuar shërbimet dhe infrastrukturën e tij; iii. përfshirjes së tyre në sistemin arsimor publik.

3. Arritjet, analiza dhe sfidat

Ky seksion vlerëson progresin e realizimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, që mbulon periudhën 2016–2020, si dhe përshkruan kushtet aktuale në fushat ku personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me pengesa në aksesimin e shërbimeve dhe realizimin e të drejtave të tyre, dhe më konkretisht aksesueshmëria (duke përfshirë aksesueshmërinë fizike dhe atë informative), barazia, punësimi dhe aftësimi, arsimimi, kujdesi social, kujdesi shëndetësor, pjesëmarrja në jetën politike dhe publike (duke përfshirë të drejtën për të zgjedhur e për t’u zgjedhur, aktivitetet kulturore dhe sportive), si dhe nxitja e bashkëpunimit, koordinimit dhe monitorimit e vlerësimit.

3.1 Aksesueshmëria

Një nga fushat me shumë rëndësi të politikave të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara është edhe ajo e sigurimit të aksesueshmërisë në mjedise, transport, informacion dhe komunikim për të gjithë individët që i përkasin këtij targetgrupi. Aksesueshmëri do të thotë që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në mënyrë të barabartë me të tjerët, në mjedise të ndryshme, transport, teknologji informacioni e komunikimi, si dhe për të gjitha lehtësitat e shërbimet. Aksesueshmëria është parakusht për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore.

Në konkluzionet lidhur me zbatimin e nenit 9 të KDPK-së, “Aksesueshmëria”, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në OKB tërheq vëmendjen e qeverisë shqiptare, në lidhje me: i. mungesën e një plani kombëtar gjithëpërfshirës mbi zbatimin e ligjit² nr. 93/2014 dhe VKM³ nr. 1074/2015 mbi heqjen e barrierave mjedisore dhe infrastrukturore në shërbimet publike; ii. mungesën e të dhënave mbi aplikimin e penalteteve administrative dhe financiare për mosplotësimin e standardeve të aksesueshmërisë, duke përfshirë ndërtesat e vjetra në shërbim të publikut; iii. mungesën e informacionit mbi aksesueshmërinë në mediat elektronike, përfshi edhe median sociale.

² “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

³ “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.



3.1.1 Aksesueshmëria fizike

Niveli ende i ulët i njohjes së kuadrit ligjor dhe i ndërgjegjësimit, bën që shpesh aksesueshmëria në mjedise të identifikohet vetëm me vendosjen e një rampe në hyrje të ndërtesës, e cila në shumë raste rezulton jashtë standardeve. Më pak vëmendje i kushtohet aplikimit të elementeve të aksesueshmërisë për personat që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim dhe personat që nuk dëgjojnë ose kanë vështirësi në dëgjim. Mungesa e një strukture të specializuar mbi kontrollin e territorit, ka lejuar krijimin në vazhdimësi të barrierave të reja në mjedis.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), një strukturë në varësi të Ministrisë së Brendshme, objektin kryesor të punës së tij e mbështet në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar. Policia Bashkiake nuk ka të specifikuar në objektin e saj të punës, kontrollin e zbatimit të lejeve të ndërtimit e aq më pak, zbatimin e kërkesave të përshtatshmërisë në ndërtim dhe infrastrukturë për personat me aftësi të kufizuara.

Në raportin e vlerësimit afatmesëm të PVKPAK 2016–2020, në këndvështrimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit, aksesueshmëria përmendet si një pengesë kryesore për të gjitha fushat, duke ritheksuar edhe një herë rëndësinë themelore që ka përmirësimi i saj për të realizuar integrimin e plotë të personave me aftësi të kufizuara. Gjatë viteve të fundit aksesueshmëria në mjedise ka pasur përmirësime kryesisht në qytetin e Tiranës, por në shumë raste jo sipas standardeve të kërkuara dhe sigurisht janë akoma të pamjaftueshme. Përfaqësues të përdoruesve të karrigeve me rrota mendojnë që rampat e realizuara janë jashtë standardeve, ndërsa përfaqësues nga komuniteti i personave që nuk shikojnë, mendojnë se edhe nivelimet për ta nuk janë në përputhje me standardet.

Gjatë 4 viteve të fundit, në funksion të përmirësimit të aksesueshmërisë fizike në shërbimet publike për personat me aftësi të kufizuara është realizuar një vlerësim gjithëpërfshirës në institucionet qendrore dhe atyre të varësisë për nivelin e aksesueshmërisë në objektet e tyre, si dhe zyra ku ofrohen shërbime publike, në nivel qendror dhe vendor. Por ky është vetëm hapi i parë, pasi institucionet duhet të

përdorin rezultatet e këtij vlerësimi për të hartuar planet për ndërhyrje të shoqëruara edhe me buxhetet e nevojshme. Realizimi i aksesueshmërisë kërkon, gjithashtu, një bashkëpunim më të fuqishëm ndërinstitucional, sidomos në drejtim të njohjes dhe të përdorimit të informacionit të mundësuar nga kontrollat që evidentojnë nivelin e aksesueshmërisë. Institucionet, duhet të ndërgjegjësohen më shumë për të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për aksesueshmëri, në mënyrë që të mundësojnë zbatimin e aktiviteteve dhe përcaktimin e buxheteve.

Ka disa përpjekje të vlerësueshme nga disa institucione, siç është MSHMS-ja, MIE, ADISA dhe të tjera, të cilat kanë ndërmarrë masa për realizimin e aksesueshmërisë në institucionet e tyre. Për objektet në varësi të MSHMS-së, rezulton se nga 400 objekte të kontrolluara, 34% ofrojnë akses për personat me aftësi të kufizuara, por jo të gjitha në përputhje me standardet. Duke e vlerësuar vendosjen e rampës si një element të rëndësishëm të aksesueshmërisë, nga të dhënat e vlerësimit, duket se: referuar zyra të punësimit në të gjithë vendin, rezulton që 57% e tyre janë të pajisura me rampa. Shkollat publike të arsimit profesional, të cilat janë të pajisura me rampë zënë 42% të shkollave në vend, ndërsa 40% e QFP-ve kanë elemente të aksesueshmërisë, por jo të plota.

Është e rëndësishme të theksohet se janë të pakta rastet kur aksesueshmëria është realizuar me të gjitha elementet e duhura, në mënyrë që ambientet të aksesohen nga personat me aftësi të kufizuara të të gjitha kategorive. Këtu mund të përmendet mungesa e tualeteve të përshtatura për personat që përdorin karrige me rrota, shiritave të posaçëm dhe parmakëve të vendosur në të gjitha ambientet e godinave apo elementi audio brenda ashensorëve që mundësojnë lëvizjen në mënyrë të pavarur të personave të verbër. Një tjetër pengesë për lëvizjen e këtyre të fundit në Shqipëri është mungesa totale e semaforëve të pajisur me elementin audio.

Rol dhe përgjegjësi të madhe në realizimin e aksesueshmërisë fizike kanë pushteti vendor. Nga ana e bashkive ka një mungesë të theksuar të zbatimit të VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Madje në shumë raste rezulton se



personeli duhet të njihet me aktet ligjore dhe nënligjore që ndikojnë tek aftësia kufizuar. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi i koordinuar i qeverisjes qendrore me nivelin vendor duhet të jetë sistematik në përmirësimin e aksesueshmërisë.

3.1.2 Aksesimi në informacion

Aksesueshmëria mbetet një çështje komplekse, e cila përfshin jo vetëm ndërhyrje fizike, por edhe ndërhyrje në aksesin në teknologji dhe informacion. Informacioni dhe komunikimi janë të rëndësishëm për çdo qytetar, përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara. Ndërkohë që shumë persona me aftësi të kufizuara mund të kenë vështirësi të kuptojnë informacionin e ofruar. Ata mund të jenë me vështirësi në shikim, në të dëgjuar apo mund të kenë pamundësi ose vështirësi në të lexuar. Që personat me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë aktive, të marrin pjesë dhe të bëjnë zgjedhje në lidhje me jetën e tyre, është thelbësore që ata të kenë mundësi të përdorin informacionin përmes sistemeve të përshtatshme të komunikimit. Megjithatë, për pjesën më të madhe të personave me aftësi të kufizuara, informacioni dhe komunikimi vazhdojnë të jenë të paarrtshëm.

Ka nisur një proces bashkëpunimi ndërmjet MSHMS-së dhe AKSHI-t lidhur me ridisnjimin e faqeve të internetit të institucioneve publike, në mënyrë që ato të jenë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara. Personat që nuk dëgjojnë nuk mund të kenë akses në informacion në qoftë se nuk iu ofrohet shërbimi i interpretimit në gjuhën e shenjave. Edhe pse gjuha shqipe e shenjave është zyrtarizuar, ky shërbim ofrohet në shumë pak raste kryesisht në median televizive dhe pothuajse fare në shërbimet publike në të gjitha fushat. Ofrimi i interpretimit të gjuhës së shenjave në shërbimet publike kushtëzohet nga mungesa e interpretëve të gjuhës së shenjave.

Disa zhvillime pozitive janë bërë në disa institucione kulturore për futjen e teknologjisë digjitale, me qëllim përmirësimin e aksesit në informacion. Gjithsesi, ndërhyrjet duhet të realizohen me planifikimet e duhura, me qëllim sigurimin e burimeve financiare për të kryer investimet e nevojshme.

3.1.3 Aksesueshmëria e transportit publik

Për këdo, mungesa e transportit apo pamundësia për ta përdorur atë, është një barrierë për punësimin, edukimin, kujdesin shëndetësor dhe jetën sociale. Është një kosto personale, gjithashtu,

e cila lidhet me humbjen e pavarësisë. Mungesa apo pamundësia për të përdorur sistemin e transportit përbën një kosto të shtuar për shtetin, për shkak të rritjes së varësisë së personave me aftësi të kufizuara ndaj pagesave të jopunësimit, ndaj familjarëve të tyre, si dhe ndaj qendrave të përkujdesjes shoqërore.

Për të rritur nivelin e aksesueshmërisë në transportin publik, fillimisht duhet të merren masa për rregullime legjislative të duhura dhe në përpunime me ato të BE-së. Gjatë viteve të fundit iniciativat për përmirësimin e legjislacionit për mundësimin e pajisjes me leje drejtimi automjeti të personave që nuk dëgjojnë, si dhe rimbursimin e karburantit për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, ka hasur në pengesa. Arsyet e mosmiratimit të akteve nënligjore mbi rimbursimin e biletave të transportit janë të lidhura me përfundimin e reformës në skemën e vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara. Ndërsa për pajisjen me leje drejtimi të personave që nuk dëgjojnë, arsyet e mosrealizimit lidhen me standardet aktuale të parashikuara në legjislacionin shqiptar për sinjalistikën rrugore. Gjithashtu ata theksojnë se transporti, vazhdon të mbetet kryesisht i papërshtatshëm.

3.2 Barazia

Gjatë periudhës zbatuese të planit të mëparshëm, ka pasur ndryshime legjislative të cilat pritet të sjellin një rritje të përfitimit të ndihmës juridike falas nga personat me aftësi të kufizuara. Në kuadër të reformës së përgjithshme të sistemit të drejtësisë në vitin 2017 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij. Ligji synon të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas që do të sigurojë akses të barabartë në drejtësi të të gjithë individëve, duke cilësuar personat me aftësi të kufizuara të të gjitha kategorive, si një nga grupet më në nevojë përfituese të këtij shërbimi. Specifikisht, neni 11, “Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike”, pikat “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” përfshijnë të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuara.



Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë ka ndryshuar strukturën e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, duke krijuar tashmë një strukturë të veçantë, të dedikuar për këtë qëllim. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka për mision, garantimin e ndihmës juridike si një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që duhet të ketë çdo individ për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore dhe kushtetuese, në rastet e kategorive në nevojë. Ky shërbim jepet në formën e ndihmës juridike parësore dhe dytësore falas, përjashtimit nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, dhe përjashtimit nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, e ngritur me urdhrin nr. 59, datë 25.3.2019, përbëhet nga 3 drejtori kryesore dhe skuadra e saj ka në total 25 punonjës. Në përmbushje të funksioneve të saj, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka marrë masa për të informuar kategoritë përfituese të NJF-së, sipas ligjit, nëpërmjet fletëpalosjeve, posterave dhe një manuali shpjegues. Duhet të theksohet që mjetet e informimit vazhdojnë të jenë të paaksesueshme nga pikëpamja e formatit për kategori të caktuara të personave me aftësi të kufizuara. Ligji “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, parashikon ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore pranë qendrave rajonale të shërbimit të ndihmës juridike falas. Deri tani këto qendra janë hapur në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë dhe Lushnjë.

Një masë e marrë së fundmi, për shkak të situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar nga COVID-19 është vendosja e numrit të gjelbër pa pagesë 0801010, ku juristët janë të disponueshëm në çdo moment për të trajtuar problematikat e paraqitura nga qytetarët.

Raporti i vlerësimit afatmesëm të PVPK-së 2016–2020, konkludon se ka një progres të pamjaftueshëm në drejtim të sigurimit të barazisë para ligjit të personave me aftësi të kufizuara. Gjatë periudhës zbatuese nuk është kryer një vlerësim i situatës së personave me aftësi të kufizuara, në lidhje me kapacitetin ligjor për të vepruar, i cili mund të shërbejë si një pikënisje dhe referim të ndryshimeve të duhura legjislative për njohjen e kapacitetit ligjor të personave me aftësi të kufizuara, e përcaktuar në KDPAK, neni 12. Në këtë kuptim njohja e barabartë para ligjit, mbetet akoma një

sfidë, pasi kërkohen ndryshime në Kodin Civil, Kodin e Familjes, Kodin e Procedurës Civile dhe akte të tjera ligjore.

Personat me probleme të shëndetit mendor janë një kategori që paraqet vështirësi për t'u trajtuar në mënyrë adekuate në sistemin e burgjeve, për shkak të kufizimit të lirisë, infrastrukturës së kufizuar të burgjeve për të ofruar një shërbim të përshtatshëm për situatën e tyre shëndetësore, numrit të vogël të mjekëve psikiatër në sistem, infrastrukturës dhe nevojave për shërbim psikologjik dhe terapeutik dhe të vetë profesionistëve, si psikolog dhe/apo punonjës social.

Përkujdesja për verifikim në kohë dhe monitorim të vazhdueshëm ndaj të burgosurve me probleme të shëndetit mendor, ka qenë specifike sidomos gjatë vitit 2019 e në vazhdim, periudhë në të cilën janë kryer analiza të hollësishme dhe verifikime në vend në çdo IEVP për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor, trajtimin dhe gjendjen e tyre shëndetësore dhe ofrimin e suportit shtesë shëndetësor, edhe nëpërmjet transferimit të tyre në strukturat ku ka mjekë psikiatër. Është verifikuar e trajtuar edhe situata për të paraburgosurit apo të dënuarit e sigurisë së lartë me probleme të shëndetit mendor. Janë gjithsej 173 të paraburgosur dhe të dënuarit e sigurisë së lartë me probleme të shëndetit mendor, të cilët konsultohen në mënyrë periodike nga mjekët psikiatër të IEVP-ve dhe spitaleve rajonale. Në fund të vitit 2019 rezultojnë 364 të burgosur me probleme të shëndetit mendor, nga të cilët 323 janë në gjendje të stabilizuar, kurse 41 prej tyre janë me diagnoza të rënda psikiatrike. Shumica e të burgosurve me aftësi të kufizuara mendore që janë nëpër burgje janë akomoduar në sektorë të kujdesit të veçantë (SKV) apo në dhoma të veçanta.

Në këtë kontekst dhe në vijim të rekomandimeve të vazhdueshme për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, nga Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtërues (KPT) pranë Këshillit të Evropës, si dhe agjencitë monitoruese në nivel kombëtar (Avokati i Popullit; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Komiteti Shqiptar i Helsinkit etj.), Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë ndërmarrë



hapa konkretë, tranzitorë dhe të përhershëm. Në kuadër të masave tranzitore, Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, po kryen rikonstruksionin e dy godinave në IEVP Lezhë, me qëllim akomodimin tranzitor të këtyre personave, duke përmirësuar kushtet infrastrukturore, por edhe kapacitete e burimeve njerëzore të specializuara dhe të trajnuara për trajtimin e kësaj kategorie. Në këtë mënyrë do të krijohen kushte për ofrimin e një kujdesi terapeutik, të sigurt nga ekupe multidisciplinare, duke krijuar një praktikë pozitive në trajtimin sipas standardeve të konventave ndërkombëtare dhe dokumentet e Bashkimit Evropian. Njëkohësisht, në spitalin e burgjeve janë kryer investime me vlerë 28.8 milionë lekë, duke e kthyer atë në një qendër spitalore të mirëfilltë, duke përfshirë këtu edhe vënien në efikasitet të plotë të laboratorit kliniko-biokimik për realizimin e analizave laboratorike të të burgosurve.

Sfidat:

- Rritja e aksesit dhe e numrit të personave me aftësi të kufizuara për marrjen e shërbimit të Ndihmës Juridike Falas nëpërmjet një zbatimi efikas të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe akteve nënligjore.

- Realizimi i ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil dhe Kodit të Familjes për të mundësuar ndryshimet e parashikuara në këtë plan për Kodin e Procedurës Penale në përputhje me Konventën.

- Studimi i situatës për kapacitetin ligjor dhe praktikën e mira për vendimmarrjen e mbështetur tregojnë se ka mungesë njohurish të specializuara për këtë fushë. Nga ana tjetër, studimi i situatës, krijimi i udhëzuesve për vendimmarrjen e mbështetur, trajnimet e zyrtarëve në të gjitha institucionet gjyqësore duhet t’i shërbejnë në të njëjtën kohë mundësimin të ndryshimeve ligjore.

- Përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, sipas standardeve ndërkombëtare.

3.3 Punësimi dhe aftësimi

Raporti i monitorimit dhe vlerësimit afatmesëm të PKVPAK-së evidentoi që në fushën e “Punësimit dhe arsimit e formimit profesional” është bërë progres në zbatimin e politikave dhe ndërhyrjeve për punësimin dhe formimin profesional të personave me aftësi të kufizuara. Pjesa më e madhe e aktiviteteve që synonin

përmirësimin e cilësisë dhe mbulimin e shërbimeve të AFP (70%) janë realizuar pjesërisht ose janë ende në proces realizimi⁴. Zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit ka ndikuar në rritjen e numrit të përfituesve me aftësi të kufizuara dhe integrimin e tyre në tregun e punës. Përpjekje janë bërë për të nxitur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha programet e nxitjes së punësimit. Kështu nga 53 persona me aftësi të kufizuara të përfshirë në programet e punësimit në vitin 2016, në 2018 rezultojnë të përfshirë 120 persona (tabela). Po ashtu, është në proces, zbatimi i masave afatgjata përmes mbështetjes në vendin e punës.

Ndërkohë që është fare e qartë se edhe pse ka një lloj progresi në këtë fushë, punësimi i personave me aftësi të kufizuara vazhdon të mbetet në nivele shumë të ulëta. Kjo bën që situata e punësimit të tyre të ketë akoma shumë sfida për vitet që vijnë, duke marrë këtu në konsideratë edhe shtimin e kërkesës për punë nga vetë personat me aftësi të kufizuara. Sipas statistikave zyrtare, numri i personave me aftësi të kufizuara të regjistruar në zyrat e punësimit, si punëkërkues të papunë, ka ardhur në rritje për të gjithë periudhën 2017–2020. Kështu në vitin 2019 ishin të regjistruar si punëkërkues të papunë 542 individë me aftësi të kufizuara ose 4.6% i madh se në vitin 2018, nga të cilët 51.8% ishin gra. Në dy vitet e fundit kanë përfutur nga programet aktive të punësimit (nxitje dhe ndërmjetësim) respektivisht 188 persona (2018) dhe 193 persona (2019), që është mbi 50% më e lartë krahasuar me vitin 2017. Mbi 80% e tyre përfitojnë nga programi i nxitjes së punësimit për PAK⁵.

⁴ Raport monitorimi dhe vlerësimi afatmesëm i Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016–2018.

⁵ VKM-ja nr. 248, datë 30.4.2014, e ndryshuar me VKM-në nr. 460, datë 9.7.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të PAK-së”.



Tabela 1. Përfshirja e PAK-së në programet aktive të tregut të punës

Përshkrimi/vitet	2016	2017	2018	2019	2020 (6-mujori)
Persona me aftësi të kufizuara (PAK) të regjistruar në zyrat e punësimit, si punëkërkuar të papunë		484	518	542	539
Prej të cilëve, femra		216	234	281	
PAK të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit	53	94	120	111	42
Prej të cilëve, femra			38	12	
PAK të punësuar nga zyrat e punësimit, nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit	33	8	68	82	27
Prej të cilëve, femra			28	3	

Persona me aftësi të kufizuara me diplomë të arsimit të lartë⁶ janë, gjithashtu, të regjistruar si punëkërkuar të papunë. Në vitin 2017, 5.4% e personave me aftësi të kufizuara të regjistruar si punëkërkuar të papunë ishin me arsim të lartë. Sipas të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në periudhën 2017–2018 kanë përfituar mbështetje 7 persona⁷ në Shkodër, Korçë, Tiranë nga programi i nxitjes për praktikant profesional për ata që kanë mbaruar arsimin e lartë. Kjo është mundur nga kontaktimi i punëdhënësve në sektorin publik dhe privat nëpërmjet ndërmjetësimeve për të diplomuarit me aftësi të kufizuara brenda programit të praktikave profesionale.

Gjatë tri viteve të fundit është punuar për përmirësimin e legjislacionit të ri të punësimit ku ka marrë vëmendje edhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara. Për politikat e punësimit është bashkëpunuar me shoqërinë civile (ADRF) dhe mbështetur nga USAID-i, në vitin 2018 duke analizuar sistemin aktual të shërbimeve të punësimit nga këndvështrimi i punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Ligji nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” hyri në fuqi në prill të 2019. Ky ligj parashikon dhënien e shërbimeve mbështetëse për personat me aftësi të

kufizuara për aftësimin dhe rehabilitimin e tyre për punë, si dhe asistencë për vlerësimin e aftësisë për punë të personit me aftësi të kufizuara. Ligji për nxitjen e punësimit krijon gjithashtu Fondin Social të Punësimit të dedikuar për aftësinë e kufizuar, i cili shërben për të siguruar nxitjen e punësimit, integrimin dhe përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara. Ky fond përdoret për financimin e projekteve që synojnë punësimin; vetëpunësimin; rehabilitim për punë; aftësimin dhe riaftësimin profesional; orientimin dhe këshillimin për punësim; shërbime mbështetëse; përshtatjen e vendit të punës për persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse⁸; programe riintegrimi social; mbështetjen për nxitjen e punësimit të familjarëve të personave me aftësi të kufizuara. Një element mbështetës i politikave të nxitjes për punësim për personat me aftësi të kufizuara është edhe vazhdimi i përfitimit të pagesës për AK-në edhe pas punësimit.

Ligji nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë” që ka si qëllim të rregullojë veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale, me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël. Personat me aftësi të kufizuara janë nga grupet kryesore përfituese të këtij ligji, si në drejtim të nxitjes së punësimit, ashtu edhe në drejtim të përfitimit të shërbimeve sociale apo të punësimit të mbështetur në përputhje me nevojat e tyre. MSHMS-ja ka miratuar tashmë të gjitha aktet nënligjore. Fondi i planifikuar për këtë qëllim subvencionon: a) veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale; b) vendet e reja të punës të krijuara për punësimin e individëve nga grupet e pafavorizuara;

⁶ Baza ligjore: vendimi nr. 873, datë 27.12.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktika profesionale për punëkërkuar të papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”, i ndryshuar.

⁷ VKM-ja nr. 873, datë 27.12.2000, e ndryshuar me VKM nr. 187, datë 2.4.2014, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuar të papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”.

⁸ Ligji nr. 15/2019, neni 21, pika 5.



si dhe c) sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të të punësuarve në ndërmarrjet sociale.

Politikat e punësimit janë të shoqëruara edhe me ato të aftësimit për punë që konsiderohet si një faktor i rëndësishëm që i paraprin punësimit. Ka pasur një vëmendje të shtuar për sa i përket krijimit të kushteve të domosdoshme në Qendrat e Formimit Profesional (QFP) për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. Përmirësimi i aksesit në këto qendra erdhi si rezultat i një vlerësimi mbi nivelin ekzistues të aksesit, duke identifikuar barrierat dhe duke propozuar elementet kryesore të ndërhyrjes për të arritur një nivel bazë të aksesueshmërisë fizike, dhe aty ku ishte e mundur për të arritur nivelin e plotë të aksesit fizik. Vlerësimi përfshiu 5 QFP: në Vlorë, QFP4 Tiranë, Elbasan, Durrës dhe Shkodër dhe u realizua aksesueshmëria fizike e plotë në QFP Vlorë dhe në QFP 4 në Tiranë.

Në vendin tonë, zhvillojnë aktivitetin e tyre 10 drejtori rajonale të formimit profesional publik në qarqet: Tiranë (2), Durrës, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë, si dhe qendra lëvizëse në të gjitha rrethet e zonës verilindore (Kukës, Dibër, Pukë, Mat, Bulqizë Has Tropojë). Për periudhën 2016–2019 janë trajnuar 307 persona me aftësi të kufizuara në këto qendra, në profesione të ndryshme. Shifrat tregojnë për një ulje të pjesëmarrjes në formim profesional të personave me aftësi të kufizuara në nivel vendi në periudhën 2016–2017, por që rritet në vitin 2019. Numri i personave me aftësi të kufizuara që morën pjesë në kurset profesionale në vitin 2019 ishte 34.1% më i madh krahasuar me vitin 2018 kryesisht në kurse, si rrobaqepësi, sekretari, hidraulik, kuzhinier ku 86.6% e përfituesve janë në Tiranë. Duhet theksuar se QFP të publike ofrojnë falas të gjitha kurset profesionale, përjashtuar kursin për gjuhë të huaj dhe kompjuter të cilat janë me pagesë. Duke pasur parasysh specifikën që kanë personat me aftësi të kufizuara në mundësitë e tyre për punësim, favorizimi i tyre nëpërmjet përjashtimit të plotë nga tarifatat do të ishte i dobishëm.

Në funksion të nxitjes së punësueshmërisë, është hartuar kurrikula për të ofruar trajnime në aftësi bazë, e cila zbatohet në të gjitha QFP publike. Kohëzgjatja e kurseve është dyjavore dhe ka dy komponentë kryesorë: aftësi për të kërkuar punë dhe aftësi sociale për vendin e punës. Ai

përqendrohet më së shumti në ushtrime formimi dhe në vlerësimin e aftësive sociale të lidhura me punën, të cilat kërkohen nga punëdhënësit. Aplikimi i kursit filloi në vitin 2019 ku u trajnuan dhe përfituan 42 persona. Aplikimi i kësaj kurrikule synon të nxisë punësueshmërinë dhe aktivizimin në tregun e punës sidomos të personave me aftësi të kufizuara intelektuale. Aktualisht po punohet edhe për zgjerimin e gamës së kurseve të ofruara në QFP, duke përfshirë kurset e unifikuara për të gjitha qendrat publike, si dhe kurset afatshkurtra për të nxënësit gjatë gjithë jetës, të cilat do të zhvillohen sipas kërkesave të tregut të punës. Tekstet dhe materialet mësimore për 42 kurse të AFP-së janë rishikuar në lidhje me gjuhën gjinore dhe gjuhën e ndjeshme ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Ligji nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ngarkon AKPA-ja për kryerjen e monitorimit dhe vlerësimit të efikasitetit të programeve aktive të tregut të punës, si dhe ndjekjen në vazhdimësi të tyre⁹. Në Sistemin e Menaxhimit të Performancës të AKPA-së, janë përfshirë parime që lidhen me personat me aftësi të kufizuara, por ato ende nuk janë të elaboruara në detaje. Modeli i ri i shërbimeve të punësimit ofrohet në tri nivele dhe niveli i tretë i këtij modeli përfshin personat me aftësi të kufizuara. Personeli i DRP/ZP-së është trajnuar për modelin e ri të shërbimeve. Në të gjitha DRP-të ka specialistë që kanë kapacitetet të punojnë për këshillimin, orientimin profesional dhe ndërmjetësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Mbledhja e të dhënave për personat me aftësi të kufizuara është pjesë e programit statistikor të AKPA. DRP/ZP-të mbledhin të dhëna për personat me aftësi të kufizuara, vetëm në rastet e paraqitjes së tyre pranë ZP-së dhe përfitimit të statusit të punëkërkuar të papunë. Sistemi informatik i shërbimeve të punësimit ka një rubrikë të veçantë për të pasqyruar gjendjen shëndetësore, por edhe pengesat fizike/shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara. Kjo rubrikë pranon edhe informacion shumë të zgjeruar, informacion i cili mund të ndihmojë specialistin e shërbimeve të punësimit për të përshtatur vendet e lira të punës me aftësitë e punëkërkuarve të papunë. Gjithsesi për të bërë vlerësime të efektshmërisë së politikave të punësimit dhe në

⁹ Ligji nr. 15/2019, neni 16, pika 2/c.



funksion të përmirësimit të tyre të vazhdueshëm është e nevojshme që sistemi statistikor i AKPA-së të përmirësohet duke u pasuruar me të dhëna të disagreguara për personat me aftësi të kufizuara.

Sfidat:

- Harmonizimi i kuadrit ligjor.
- Përshtatja e kurrikulave dhe rritja e kapaciteteve në lidhje me eksperiencën dhe njohuritë për të punuar me persona me aftësi të kufizuara të kategorive të ndryshme.
- Trajnimet dhe aktivitetet për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e programeve të trajnimit, duhet të jenë të vazhdueshme dhe të koordinuara.
- Hartimi i instrumenteve dhe moduleve të standardizuar dhe miratimi e përvetësimi nga punonjësit e institucioneve të punësimit e formimit profesional.

3.4 Arsिमimi

Në kuadrin e zbatimit të PKVPAK 2016–2020, raporti i monitorimit dhe i vlerësimit afatmesëm të këtij plani, evidentojnë lloj progresi në fushën e arsimit. Arritjet evidentohen kryesisht në lidhje me shtimin e numrit të mësuesve ndihmës, forcimin e kapaciteteve të mësuesve ndihmës përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe përmirësimin e kurrikulave për aftësinë e kufizuar.

MASR-ja dhe institucionet e varësisë informojnë dhe ndërgjegjësojnë në mënyrë të vazhdueshme nxënësit dhe prindërit, në lidhje me të drejtat e barabarta të fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar në sistemin e përgjithshëm. Kjo realizohet përmes udhëzimit të vitit shkollor dhe njësitë të shërbimit psikosocial në shkolla. Çdo fillim viti MASR-ja udhëzon të gjitha drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrtat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) që të informojnë prindërit e interesuar dhe komunitetin për përparësitë e arsimit të fëmijëve me AK-në në arsimin gjithëpërfshirës. Ndërsa njësitë e shërbimit psikosocial në shkolla punojnë, gjithashtu, me nxënësit, mësuesit dhe me prindërit (edhe në kuadër të shkollave qendra komunitare) tema të veçanta mbi integrimin e fëmijëve me AK-në dhe gjithëpërfshirjen e tyre në arsim. Gjithsesi kryerja e fushatave vjetore të ndërgjegjësimin në bashkëpunim edhe me organizatat e shoqërisë civile do të zgjeronte masën e njerëzve të informuar dhe ndërgjegjësuar.

Në mbështetje të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, MASR-ja me urdhrin nr. 31, datë 28.1.2020, ka miratuar rregulloren për funksionimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, në të cilën përcaktohen rregullat për ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve Multidisiplinare të vlerësimit të nevojave arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuar, pranë çdo ZVAP¹⁰. Funksionimi i këtyre komisioneve është rëndësishëm për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kjo edhe për faktin se funksionimi i tyre është i lidhur ngushtë me vlerësimin biopsikosocial.

Për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Komisioneve Multidisiplinare, në nivel vendor, mbi Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit, sipas parashikimit duhet të organizoheshin trajnime çdo vit për anëtarët e komisioneve në 12 qarqet e vendit (ose 84 persona çdo vit). Aktualisht është zhvilluar një trajnim treditör në nëntor të vitit 2016, i mbështetur nga organizata MEDPAK në Korçë ku janë trajnuar 35 anëtarë të Komisioneve Multidisiplinare. Këto trajnime duhet të jenë në vazhdimësi.

Për sa i përket procesit të trajnimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të personelit arsimor, në fushën e aftësisë së kufizuar janë akredituar 36 programe trajnimi, të cilat ofrohen nga 17 institucione ofruese të trajnimit për personelin arsimor ku përfshihen edhe institucione të arsimit të lartë për formimin e mësuesve. Një pjesë e tyre kanë ofruar trajnime edhe në DRAP/ZVAP të ndryshme. Deri tani janë trajnuar 335 punonjës të personelit arsimor me programet e akredituara duke shënuar një tejkalim të realizimit të objektivit.

Numri i mësuesve ndihmës është rritur nga viti në vit me hapa të shpejtë për të plotësuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kështu, në vitin 2016 numri ishte 113, ndërsa në vitin 2018 është 5.2 herë më i madh se në vitin 2016. Në vitin shkollor 2019–2020 u punësuan në sistemin e arsimit parauniversitar publik dhe privat rreth 1236 mësues ndihmës (nga të cilët 86.5% në sistemin publik), ose 21% më shumë krahasuar me një vit më parë. Një përmirësim të ndjeshëm ka pasur raporti fëmijë me AK/mësues ndihmës. Ky raport në vitin shkollor 2019–2020 është 3.5 në krahasim

¹⁰ Urdhrin nr. 31, datë 28.1.2020, kreun XIV, neni 80.



me vitin shkollor 2017–2018 që ishte 7 (tabela më poshtë). Trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve ndihmës për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara ka qenë një nga përparësitë e MASR-së. Në periudhën prill–qershor 2017 u zhvillua trajnimi mbi nxitjen e zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës përmes ngritjes së rrjeteve profesionale¹¹, ku u trajnuan 450 mësues nga të gjitha DRAP/ZVAP-të. Rrjetet profesionale të mësuesve ndihmës janë ngritur dhe funksionojnë si bërthama të trajnimit dhe të zhvillimit profesional. Gjatë vitit 2020, janë riorganizuar rrjetet profesionale të mësuesve ndihmës në përpunje me riorganizimin e ZVAP-ve, duke ngritur edhe kapacitetet e drejtuesve të rrjeteve profesionale në çdo ZVAP-je të vendit. Aktualisht janë 60 rrjete profesionale si bërthama të zhvillimit profesional të 1100 mësuesve ndihmës në arsimin parauniversitar. Përparësi i është dhënë gjithashtu trajnimit të mësuesve ndihmës dhe të gjithë punonjësve mësimorë për gjithëpërfshirjen. Gjatë vitit 2018–2019 janë trajnuar nga ASCAP-ja mbi 555 mësues për gjithëpërfshirjen.

Profil i mësuesit të arsimit special është përcaktuar si një profesion i rregulluar dhe po punohet për t'i punësuar me përparësi mësuesit e licencuar në këtë profil si mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara. MASR-ja ka miratuar një udhëzim¹², në të cilin është rikonceptuar puna e mësuesit ndihmës në shkollë dhe roli i tij në klasë dhe jashtë saj në mbështetje të zhvillimit konjitiv, socioemocional dhe arsimit të fëmijëve me AK. Për fëmijët që nuk dëgjojnë është nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi¹³ ndërmjet MSHMS-së, MASR-së, MFE-së dhe ANAD-së, ku palët angazhohen të bashkëpunojnë në fushën e edukimit dhe ofrimit të shërbimit të interpretimit në gjuhën e shenjave për njerëzit që nuk dëgjojnë. Nëpërmjet një urdhri në zbatim të Marrëveshjes, MASR-ja ka përcaktuar detyrat institucionale¹⁴.

¹¹ Me mbështetjen financiare të “Save the Children” në Institutin e Zhvillimit Arsimor.

¹² Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

¹³ Marrëveshje e bashkëpunimit nr. 4481, datë 25.4.2018 ndërmjet MSHMS-së, MASR-së, MFE-së dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë.

¹⁴ Urdhri nr. 117, datë 28.2.2019, “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e detyrimeve në fushën e edukimit për nxënësit që nuk dëgjojnë”.

Grupi i punës ka hartuar dhe miratuar planin e veprimit, në kuadër të zbatimit të të cilit është realizuar rishikimi dhe miratimi i planit të ri mësimor për institutin e fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe ka mundësuar futjen për herë të parë të mësimin të gjuhës së shenjave si lëndë mësimore në këtë institut. Gjithsesi duhet theksuar se zbatimi i kësaj marrëveshjeje deri tani nuk ka pasur impenjimin e duhur, nga të gjitha palët. Vetë organizatat e personave me aftësi të kufizuara në nivel vendor, duhet të përfshihen më shumë në përparimin e nxënësve me AK-në.

Planet edukative individuale për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara hartohen sipas nevojës nga mësuesi ndihmës në bashkëpunim me prindin e fëmijës me aftësi të kufizuara dhe Komisionin e shkollës, dhe miratohen nga drejtoria e shkollës. MASR-ja ka rekomanduar disa modele apo skema të këtyre planeve, të cilat janë propozuar për t'u përdorur në trajnime që janë bërë me mësuesit ndihmës. Megjithatë MASR-ja, nuk merr informacion mbi numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara për të cilët janë hartuar planet edukative individuale gjatë një viti shkollor në nivel ZVAP/DRAP-je dhe në nivel kombëtar.

MASR-ja është përgjegjëse për monitorimin dhe evidentimin e arritjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. Baza e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor përditësohet çdo vit shkollor. Të dhënat që mbledhen nga shkollat në DRAP/ZVAP dhe pastaj në MASR janë të detajuara, sipas moshës, gjinisë, klasës, llojit të aftësisë së kufizuar apo vendbanimit dhe prejardhjes. Por duhet theksuar që databaza nuk përmban të dhëna mbi llojin e shërbimit të nevojshëm mbështetës që duhet për çdo fëmijë.

Legjislacioni parashikon përballimin nga buxheti i shtetit të shpenzimeve të transportit për nxënësit e arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara¹⁵. MASR-ja raporton që çdo vit janë rreth 28 mijë nxënës që iu ofrohet transporti falas, por nuk raporton të dhëna mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për ta marrë transportin falas si dhe numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara që e përfitojnë këtë shërbim. Arsyeja e

¹⁵ VKM-ja nr. 682, datë 29.7.2015, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”.



mosevidentimit të këtij numri sipas MASR-së qëndron në faktin që buxheti për transportin menaxhohet nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar”, ndërsa linjat e transportit janë nën varësinë e njësisë të vetëqeverisjes vendore. Kjo kërkon një koordinim më të mirë të punës ndërmjet institucioneve të niveleve të ndryshme, por edhe të përmirësimit të sistemit të mbledhjes së të dhënave dhe funksionimit të tij. Një evidentim i mirë i nevojave për transport që kanë fëmijët me AK-në, do të ndikonte në rritjen e frekuentimit të institucioneve arsimore parauniversitare prej tyre. Një problematikë e mprehtë që ndikon negativisht në frekuentimin e shkollës, është mungesa e mjeteve të transportit të përshtatura për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Nevojat për mjete didaktike duhet të vlerësohen rast pas rasti nga komisionet e shkollave dhe përgatitja e tyre është pjesë e hartimit të PEI. Gjithsesi MASR-ja nuk ka një raport përmblidhës për vlerësimin e nevojave për burime didaktike për në mbështetje të edukimit të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara në sistemin e përgjithshëm e për rrjedhojë nuk ka informacion të saktë nëse është realizuar përgatitja e të gjitha burimeve didaktike të duhura për nxënësit me AK në të gjithë vendin.

Aktualisht funksionojnë 9 shkolla speciale të vendosura në Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Kurbin, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, përfshirë këtu institutin e fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe atë të fëmijëve që nuk shikojnë. KDPAK-ja vjen me një qasje gjithëpërfshirëse për sa i përket edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara që do të thotë përfshirja gjithmonë e më tepër e tyre në institucionet arsimore të zakonshme. Për këtë arsye

në PKVPAK 2016–2020 u parashikua hartimi i një plani për shndërrimin e shkollave speciale në qendra burimore, bazuar edhe në eksperiencat ndërkombëtare. Ka pasur disa raste të veçanta të ofrimit të shërbimeve për nxënës me probleme shikimi dhe dëgjimi që ndjekin institucionet arsimore të zakonshme, duke i mbështetur nxënësit me tekste të përshtatura dhe mësuesit ndihmës me trajnime, por aktualisht asnjë nga shkollat speciale nuk është shndërruar në qendër burimore. Aktualisht MASR po punon për përgatitjen e një strategjie për kthimin e Institutit për Fëmijët që nuk Dëgjojnë në qendër burimore në bashkëpunim me ANAD-në dhe *World Vision*.

Si rrjedhojë e ndërhyrjeve të realizuara nga MASR-ja në kontekstin e gjithëpërfshirjes, është rritur numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që arsimohen në institucionet arsimore të zakonshme. Numri i nxënësve me AK në institucionet arsimore të zakonshme është rritur me 18.6% në vitin shkollor 2019–2020 krahasuar me 2016–2017. Gjatë gjithë periudhës 2016–2020, ky numër ka ardhur gjithmonë në rritje, ndërsa numri i nxënësve në shkollat speciale ka tendencë të bjerë. Kështu, në vitin akademik 2019–2020, numri i fëmijëve me AK-në në shkolla jospesiale në arsimin publik u rrit rreth 5%, krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 3858. Po në këtë vit, në sistemin arsimor parauniversitar ndoqën mësimin në institucione arsimore jospesiale publike dhe private, duke filluar nga arsimi parashkollor, 4566 nxënës me AK ose 13% më shumë se një vit më parë. Rreth 70% e fëmijëve me AK të regjistruar ndjekin arsimin bazë, 19% arsimin parashkollor dhe pjesa tjetër arsimin e mesëm/të lartë. Nisur nga të dhënat për vazhdimin e edukimit edhe pas arsimit bazë për fëmijët me AK, duhet të intensifikohen masat.

Tabela 2. Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara, të integruar në kopshte/ institucionet arsimore të zakonshme dhe speciale publike dhe private

Viti shkollor	Arsimi parashkollor	Arsimi bazë	Arsimi mesëm i lartë	Gjithsej në shk. përgj. + speciale	Nga të cilët në shkolla speciale	Mësues ndihmës publik
2013–2014	319	1822	708	2849	702	0
2014–2015	409	2630	371	3410	673	65
2015–2016	403	2883	389	3675	661	113
2016–2017	440	2986	345	3771	659	310
2017–2018	500	3446	456	4402	678	585
2018–2019	492	3664	530	4686	652	933
2019–2020	494	3550	529	4573	527	1069
2020–2021	471	3693	508	4672	541	1176



Sfidat:

Sfidat e mëtejshme të politikave për ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara lidhen kryesisht me funksionimin dhe fuqizimin e sistemit të gjithëpërfshirjes. Qeveria është e angazhuar të sigurojë arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me AK, por ende duhet të ngrihen disa themele të rëndësishme, ku përfshihet:

- fuqizimi i sistemit të gjithëpërfshirjes dhe funksionimit të tij;
- përgatitja fillestare e mësuesve për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- trajnime të vazhdueshme të mësuesve në sistem për pedagogjinë e specializuar dhe punën me fëmijët me aftësi të kufizuara;
- pajisja me bazë materiale didaktike të përshtatshme për gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme;
- zbatimi i standardeve të aksesueshmërisë për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe në shkolla;
- krijimi i qendrave burimore që do të nxisë edhe të mësuarit gjatë gjithë jetës për personat me aftësi të kufizuara.

3.5 Kujdesi social

3.5.1 Pagesat

Politikat e kujdesit social kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet: balancimit dhe përputhjes së pagesave që ata marrin për shkak të aftësisë së kufizuar me nevojat jetike e përkujdesje ndaj tyre; rritjes së aksesit dhe cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara që duhet të kenë në qendër klientin; si dhe kombinimit të pagesave *cash* me kujdes social cilësor.

Numri i përfituesve¹⁶ që kanë përfutur transferta nga sistemi i mbrojtjes sociale për shkak të aftësisë së kufizuar në fund të vitit 2020 janë 72,711 persona me AK dhe numri i kujdestarëve është 19,402. Njëkohësisht, janë 74,391 invalidë të punës. Transfertat e mbrojtjes sociale përfshijnë: pagesën e aftësisë së kufizuar, ndihmën ekonomike, si dhe lehtësimet në pagesat e energjisë. Familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuara janë ekonomikisht të varur nga pagesat e aftësisë së kufizuar, edhe për faktin që në më të shumtën e rasteve të paktën një nga anëtarët e familjes duhet

të jetë në shërbim të personit me aftësi të kufizuara. Sistemi i shërbimeve shoqërore do të synojë shpesh herë përveç individit përfutur edhe familjet e tyre.

Gjatë 5 viteve të kaluara, fusha e politikave të Kujdesit Social mbarti në vetvete edhe shumë sfida të lidhura me vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar, kontekstin e deinstitutionalizimit, ofrimin e tipologjive të ndryshme të shërbimeve sociale cilësore në komunitet duke përmendur jetesën e pavarur si një nga shërbimet më të reja por edhe shërbime të tjera që kontribuojnë në përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë periudhës zbatuese të Planit është punuar fort për kalimin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga modeli mjekësor, drejt atij biopsikosocial, bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit e të reflektuara në KDPAK-në. Në kuadër të reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar janë ngritur dhe funksionojnë 6 komisione shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, të cilat janë në varësi të drejtorisë rajonale të SHSSH-së Tiranë dhe funksionojnë pranë qendrave shëndetësore, përkatësisht, Poliklinika e Specialiteteve nr. 1, Poliklinika e Specialiteteve nr. 3, Qendra Shëndetësore nr. 6, Qendra Shëndetësore nr. 10, Dispanceria dhe Spitali Kavajë. Që nga hyrja në fuqi e VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfutimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, vlerësimi biopsikosocial bëhet në të gjithë qarkun e Tiranës. Në zbatim të këtij vendimi është miratuar nga Shërbimi Social Shtetëror, rregullorja “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e komisioneve shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar”.

Stafi i komisioneve përbëhet nga 1 mjek dhe 1 punonjës social dhe çdo komision asistohet nga 1 operator për hedhjen e të dhënave. Gjithashtu, është krijuar edhe komisioni shumëdisiplinor i nivelit të dytë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH-së për shqyrtimin e ankesave. Ky komision përbëhet nga 1 mjek dhe 2 punonjës socialë. Është trajnuar i gjithë stafi i komisioneve gjatë vitit 2019 dhe janë organizuar trajnime për rreth 500 mjekë (mjekë familje dhe mjekë specialistë) lidhur me

¹⁶ Personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre.



modelin biopsikosocial të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Gjithashtu, është miratuar udhëzimi nr. 667, datë 1.10.2019, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për metodologjinë e kontrollit të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar”. Kjo metodologji kontrolli është një udhëzues, që standardizon, unifikon procedurat, rregullon veprimtarinë e kontrollit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar sipas modelit biopsikosocial, si dhe drejton sjelljen profesionale të punonjësve të njërive të kontrollit në këtë institucion. Zbatohet vetëm për modelin e ri biopsikosocial të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Si pjesë e përpjekjeve për mirëmenaxhimin e fondeve publike dhe për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të skemës, po bëhet ristrukturimi i disa pagesave, përfitimeve dhe shërbimeve të aftësisë së kufizuar në përputhje me nevojat e përfituesve. Ky ristrukturim përfshin: a) ristrukturimin e pagesës me para në dorë (*cash*); b) ristrukturimin e pagesës së ndihmës personal; dhe c) kthimin e pagesave *cash* në pagesa në natyrë (shërbime).

Pagesat progresive janë dhënë sipas udhëzimit nr. 629, datë 27.8.2018 të Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Mbi përcaktimin e masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal”, vendimit nr. 431, datë 8.6.201 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit, procedurave dhe të masës së përfitimit për aftësinë e kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave e të detyrave të tyre në zonat pilot”, të ndryshuar.

3.5.2 Shërbimet

Gjatë viteve të fundit MSHMS-ja ka punuar në drejtim të një reforme të shërbimeve shoqërore, duke synuar drejt krijimit të shërbimeve të integruara në nivel qendror dhe lokal. Sipas ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, sistemi i menaxhimit dhe referimit për shërbimet sociale për grupin e synuar, garanton të drejtën e personave me aftësi të kufizuara, për të përfituar shërbime. Bazuar mbi këtë ligj është miratuar VKM-në nr. 518/2018, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, procedurat, kriteret për përfitimin e tyre për përfituesit e shërbimeve sociale”. Po ashtu, pilotimi i reformës së vlerësimit biopsikosocial të personave me aftësi të kufizuara është i fokusuar në referimin e tyre drejt shërbimeve, çka dikton marrjen e shpejtë të masave

për iniciimin e shërbimeve mbështetëse dhe rehabilituese të të gjitha tipologjive dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. MSHMS-ja është e angazhuar në zbatimin e reformës.

Në kuadër të reformës është miratuar vendimi nr. 111, datë 23.2.2018, “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”. Në bazë të tij është krijuar një mekanizëm për mbështetje financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore për vijimin e ofrimit të shërbimeve ekzistuese dhe ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror, sipas standardeve të miratuara. Fondi social krijohet me burime financiare nga fondet e kushtëzuara që akordohen nga MSHMS-ja, fonde nga buxhetet e njërive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore, të ardhurat nga OJF-të, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë. Lidhur me programimin dhe financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas ligjit të ri 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, është njësia e vetëqeverisjes vendore që vlerëson nevojat për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor, në përputhje me planin e tyre strategjik të zhvillimit dhe me programin buxhetor afatmesëm. Gjithashtu, bashkitë vlerësojnë kapacitetet e veta financiare dhe njerëzore që mbështesin ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror brenda territorit të tyre. Reforma e shërbimeve shoqërore po vijon me fuqizimin e NJVRN-në, të cilat vlerësojnë nevojat për shërbime shoqërore.

Për ofrimin e shërbimeve duhet të merren masa për të analizuar më mirë llojet e aktiviteteve dhe kostimin e tyre për të gjitha institucionet në bazë të tipologjisë së shërbimeve drejt kategorive të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara. Këtu mund të sjellim shembuj pozitivë të bashkëpunimit të pushtetit vendor me OJF-të në krijimin dhe ofrimin e shërbimeve, nëpërmjet të cilit sigurohet vazhdimësia, qëndrueshmëria dhe cilësia e shërbimit të ngritur. Shoqata “Ndihmoni Jetën” në partneritet me *Save the Children* dhe bashkitë Durrës e Vlorë, në periudhën 2017–2020 ka ngritur dy qendra komunitare për fëmijët me AK, ku marrin shërbime mbi 200 fëmijë me AK nga 0 deri në 21 vjeç. Pas vitit të tretë të dy qendrat kanë hyrë në juridiksionin e bashkive përkatëse. Po ashtu dhe Qendra Komunitare Kukës, ka parashikuar me një kapacitet shërbimi për 100 fëmijë.



Gjatë periudhës së zbatimit të PKVPAK 2016–2020, me mbështetjen e UNDP-së, u ngritën 12 qendra të reja funksionale, në bashki të ndryshme, si: Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Bulqizë, Shijak, Dibër, Përmet, Ura Vajguore, Korçë, Maliq, Krujë, Vlorë. Këto qendra ofrojnë shërbime në komunitet për personat me aftësi të kufizuara të grup-moshave të ndryshme, si p.sh. Qendra e Zhvillimit Lushnjë ofron shërbime me bazë komunitare për fëmijë deri 16 vjeç, Qendra Multifunkionale Pogradec ofron shërbime me bazë komunitare për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara etj. Gjatë dy viteve të fundit janë realizuar trajnime të personelit jo vetëm në këto qendra por edhe në qendrat e tjera rezidenciale dhe ditore për personat me aftësi të kufizuara.

Një tjetër nismë është ajo e Bashkisë Shkodër që ka ngritur dy shërbime të reja pranë Qendrës së Zhvillimit, të cilat kanë në fokus shërbimin e terapisë okupacionale e nga ku përfitojnë 78 persona me aftësi të kufizuara. Qëllimi i tyre është përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në procese pune të përshtatshme për to. Procesi i riorganizimit të shërbimeve shoqërore do të sjellë ndërthurjen e shërbimeve rezidenciale me ato komunitare për personat me aftësi të kufizuara. Po punohet në këtë drejtim me Qendrën Rezidenciale Vlorë dhe Qendrën Rezidenciale “Pëllumbat” në Tiranë. Një hap tjetër pozitiv në këtë drejtim është se në të 6 qendrat e zhvillimit për personat me aftësi të kufizuara po zbatohet ngritja e atelieve, të cilat do të aftësojnë personat me aftësi të kufizuara drejt një jete më të pavarur.

Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet konsiderohet nga KDKPAK-ja, neni 19, si një parim i rëndësishëm në kuadër të realizimit të plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Deri tani ofrimi i shërbimeve publike për jetesën e pavarur është i munguar, ndërkohë që kanë filluar të bëhen përpjekjet e para për ngritjen e shërbimeve të reja, me fokus nxitjen e të jetuarit në komunitet të personave me probleme të shëndetit mendor, të hospitalizuar për kohë të gjatë në spitalet psikiatrike. Një praktikë pozitive për jetesën e pavarur ka sjellë shoqata “Ndihmoni jetën”, e cila gjatë periudhës mars 2019–shkurt 2020, me financim të UNDP-së dhe me mbështetjen e MSHMS-së, ka ngritur shërbimin e jetesës së pavarur në apartamente, me/pa mbështetje për personat me aftësi të kufizuara mbi moshën 24

vjeç. Krijimi i kushteve për jetesën së pavarur siç e parashikon edhe KDKPAK-ja, është parashikuar në legjislacionin për përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst plotësimi i legjislacionit duhet të shoqërohet me ofrimin e shërbimeve sociale për kategori dhe grup-mosha të ndryshme të AK-së dhe të mbështetet nëpërmjet fondit social.

Duke qenë se institucionet rezidenciale publike e kanë të përcaktuar grup-moshën që marrin shërbim, aktualisht janë rreth 25 persona që kanë dalë nga institucionet rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara dhe që duhet të orientohen në shërbimet komunitare, por që aktualisht janë të munguara për personat madhorë me aftësi të kufizuara. Kjo është reflektuar me masa të veçanta në PKVPAK.

Masat për epideminë COVID-19:

Qeveria shqiptare dhe autoritetet shëndetësore morën masa të menjëhershme për të përballur shpërthimin e COVID-19 në planin shëndetësor dhe ekonomik.

Ndër masat e marra për komunitetet dhe grupet e mëdha të popullsisë, për sa u takon programeve të mbrojtjes sociale, ishin:

Bashkëpunimi midis pushtetit qendror dhe atij vendor në implementimin e nevojave më të menjëhershme për shtresat në nevojë solli ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e VKM-së nr. 236, datë 19.3.2020, “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”. Ndihma për familjet në nevojë dhe për pensionistët në nevojë ishte fokusi kryesor në ditët e para të pandemisë, ku bashkitë u mobilizuan gjerësisht për të asistuar këto shtresa shoqërore.

233,248 ishte numri i familjeve që morën asistencë ushqimore dhe jo ushqimore, si: ofrimi i asistencës në banesë, duke përfshirë dërgimin në banesë të pagesave të përfituara nga programi i mbrojtjes sociale (NE dhe PAK) dhe sigurimeve shoqërore (invalidë pune e pensionistë); dërgimin e pakove ushqimore dhe joushqimore dhe barnave të rimbursueshme, si edhe të pastrehët dhe ata që kanë humbur banesën për shkak të tërmetit;

Gjatë periudhës së pandemisë disa organizata të shoqërisë civile (Terre des Homes, Save the Children, World Vision, Santa di Frontiera etj), apo Agjenci të UN (UNICEF, Leave No One Behind)



sipas zonave të tyre të mbulimit/sipas projekteve respektive, i erdhën në ndihmë pushtetit vendor me planifikimin dhe shpërndarjen e ndihmave ushqimore dhe financiare, me ofrimin e shërbimit në shtëpi, me planifikimin dhe shpërndarjen e ndihmës ekonomike apo të pagesave të aftësisë së kufizuar.

Në zbatim të VKM-së nr. 254, datë 27.3.2020, u realizua dhënia e pagesës shtesë në formën e ndihmës financiare për individët dhe familjet që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike (2-fishi i pagesës së NE), ku nga kjo masë përfituan edhe familjet në nevojë përfituese të ndihmës ekonomike që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara. Aktualisht, vijnë të përfitojnë 2-fishin e masës së ndihmës ekonomike 8,088 familje të skemës së ndihmës ekonomike që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuar. Pagesa e aftësisë së kufizuar nuk lidhet me gjendjen ekonomike dhe të ardhurat e familjes. Kështu, të gjitha familjet që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuara dhe janë familje në nevojë kanë të drejtën të aplikojnë për përfitim nga skema e ndihmës ekonomike.

3.5.3 Strehimi social

Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”, dhe të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tij i sigurojnë akses me përparësi individëve dhe familjeve që kanë në përbërjen e tyre persona me aftësi të kufizuara në programet e strehimit. Këta individë dhe/ose familje mund dhe janë përfitues në të gjitha programet e strehimit social, si skema e aplikimit të bonusit të qirasë, grant i menjëhershëm, projektet e përmirësimit dhe përshtatshmërisë së kushteve të banimit, si dhe investimit në banesa me kosto të ulët. Në vitin 2019, janë trajtuar nga programet e strehimit social gjithsej 1280 familje, nga të cilat 245 familje ose 19.1% kanë pasur në përbërje një person me aftësi të kufizuara. 82% e aplikuesve persona me aftësi të kufizuara kanë përfituar nga programi i subvencionimit të qirasë në treg të lirë. Grant të menjëhershëm, për lehtësimin e blerjes së banesave me kosto të ulët kanë përfituar gjithsej 74 persona me aftësi të kufizuara për periudhën 2017–2019, nga të cilat 25 familje ose 33.8% kanë përfituar në vitin 2019. Përfituesit e këtij programi janë banor në 13 bashki të vendit (Kavajë, Gramsh, Pogradec, Vlorë, Korçë, Lezhë, Berat, Kamzë, Krujë, Tiranë, Përrenjas, Lushnjë, Durrës).

Tabela 3. Numri i familjeve përfituese nga programet e strehimit, viti 2019

Programi	Numri i familjeve përfituese	Numri i familjeve me përfitues PAK	Në %
Subvencionim të qirasë në treg të lirë	536	201	37.5%
Projekte për përmirësimin dhe përshtatshmërinë e kushteve të banimit	634	7	1.1%
Grant të menjëhershëm	26	25	96.2%
Banese me kosto të ulët	84	12	14.3%
TOTALI	1280	245	19.1%

Sfidat:

- Shtrirja e reformës.
- Përgatitja e amendimeve ligjore të ligjit të prokurimit publik, për të mundësuar blerjen e shërbimeve nga OJF-të.
- Mungesa e një vlerësimi të strukturuar të nevojave për shërbime në mbarë vendin.
- Numri i pamjaftueshëm i qendrave komunitare për personat me aftësi të kufizuara mbi moshën 25 vjeç, të cilët jetojnë në spitale psikiatrike pasi janë të vetmuar etj.
- Ngritja e shërbimeve për persona madhorë me aftësi të kufizuara intelektuale.

- Bashkëpunimi më i mirë i MSHMS-së dhe SHSSH-së me pushtetin vendor për të bërë bashkërendimin dhe planifikimin e shërbimeve.

- Ndërgjegjësimi dhe përqafimi i reformës së re të vlerësimit nga grupet e interesit.

- Shërbimet e ngritura nuk mbulojnë dot të gjitha nevojat sipas grup-moshës dhe tipologjisë së nevojshme.

3.6 Kujdesi shëndetësor

Gjatë viteve të fundit në sistemin shëndetësor është punuar kryesisht në forcimin e kapaciteteve të personelit të institucioneve shëndetësore që janë përfshirë në aplikimin e reformës së re të vlerësimit



biopsikosocial dhe në rritjen e kapaciteteve për stafin e shërbimeve të reja komunitare socioshëndetsore, si dhe në rritjen e gamës së shërbimeve, si: ofrimi i karrigeve me rrota individëve në nevojë, ngritjen e shtëpive të mbështetura për personat me probleme të shëndetit mendor, pilotimin e zbatimit të depistimit të fëmijët e porsalindur për problemet me dëgjimin.

Të gjithë mjekët e familjes në qarkun e Tiranës, mjekët specialistë dhe ata pjesë e komisioneve të vlerësimit, kanë marrë trajnime mbi zbatimin e reformës së re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Planifikohet që trajnimet të vazhdojnë, me përfshirjen e qarqeve të tjerë në zbatimin e reformës së re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Elbasan dhe Durrës. MSHMS-ja ka ndërmarrë, gjithashtu organizimin e trajnimeve për personelin e Shtëpisë së Mbështetur në Korçë, një shërbim i ri komunitar i ngritur në vitin 2017, me qëllim trajtimin dhe rehabilitimin e individëve me probleme kronike të shëndetit mendor. Gjithashtu është trajnuar në fund të vitit 2019 stafi multidisciplinar (10 punonjës) i dy shërbimeve të reja komunitare për shëndetin mendor në qytetin e Kavajës mbi tipologjinë e ofrimit të kujdesit në këto dy shërbime. Trajnimet janë realizuar me mbështetjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe komunitetit *Sant'Egidio*.

Aktivitetet e informimit dhe ndërgjegjësimin për njohjen dhe përfitimin e të gjitha shërbimeve shëndetsore për personat me aftësi të kufizuara do të ndikonte në një masë të konsiderueshme për të pasur një shëndet sa më të mirë. Gjatë viteve të fundit, MSHMS-ja në bashkëpunim me OJF-të ka realizuar aktivitete informimi dhe ndërgjegjësimi kryesisht për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe për personat që nuk dëgjojnë, të cilat duhet të jenë të pranishme dhe në PKVPAK 2021–2025,

Një mbështetje e rëndësishme për personat me vështirësi në lëvizje është pajisja e karrigeve me rrota. Që prej muajit qershor 2017 dhe në vazhdim MSHMS-ja ka mbështetur shërbimin e karrigeve me rrota, duke filluar që nga vlerësimi i individualizuar, montimi, përshtatja e karrigeve me rrota dhe shpërndarja e tyre. Afërsisht 900 persona në nevojë për karrige me rrota, kanë përfituar nga ky shërbim çdo vit. MSHMS-ja parashikon çdo vit buxhet për prodhimin e ortezeve dhe protezeve dhe fondi vjetor për ofrimin e këtij shërbimi është

5,000,000 lekë. Megjithatë, fondi i parashikuar nuk është përdorur, pasi nuk ka pasur asnjë kompani që mund të ofronte materialet e nevojshme, në përputhje me teknologjinë që kemi në vend për prodhimin e protezeve dhe ortezeve.

MSHMS-ja dhe CESTAS nënshkruan një marrëveshje për realizimin e nismës së quajtur DEAF_AL - AID 10966, “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara të dëgjimit në Shqipëri”, që përfshin periudhën 1 qershor 2018–10 janar 2020. Projekti kishte si qëllim përmirësimin e përfshirjes socioekonomike dhe autonominë e fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë me aftësi të kufizuara dëgjimore nëpërmjet testimit të hershëm dhe përdorimit të mjeteve e teknologjive informatike të përparuara, metodologjive edukative të përshtatshme dhe metodave inovative të integritit në punë. Aktivitetet që përfshiheshin në këtë marrëveshje synonin të kontribuonin në forcimin e sistemit shëndetësor publik shqiptar në diagnozën e hershme të aftësisë dëgjimore nëpërmjet zbatimit të protokollit përkatës të përdorur në nivel ndërkombëtar. Në projekt u përfshinë spitalet e Durrësit, Elbasanit, Fierit dhe Korçës. Praktika të tilla duhet të shtrihet në të gjitha maternitetet e vendit, si një shërbim i qëndrueshëm dhe i vazhdueshëm.

Në kuadër të fuqizimit të rrjetit komunitar të shërbimeve të shëndetit mendor, MSHMS-ja ka investuar dhe ka ngritur 2 shërbime të reja me fokus jetesën në komunitet të personave me probleme të shëndetit mendor, të hospitalizuar për kohë të gjatë në spitalet psikiatrike. Njëri prej këtyre shërbimeve, i cili ka filluar funksionimin në vitin 2016 është një “Shtëpi e Mbështetur” për shëndetin mendor (shërbim rezidencial) në Korçë. Përfituesit prej tij janë 12 persona me probleme të shëndetit mendor, ish-rezidentë kronikë në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit (6 burra dhe 6 gra) dhe një “Shtëpi të Mbështetur” në Kavajë, për 8 gra me çrregullime të shëndetit mendor, ish rezidente kronike të po këtij spitali. Të dyja shërbimet janë të ngritura me fonde të buxhetit të shtetit. Për “Shtëpinë e Mbështetur” në Kavajë, investimi kap vlerën e 3,606,014 lekë. Për “Shtëpinë e Mbështetur” në Korçë, investimi ishte 43,651,000 lekë. Gjithashtu, në qytetin e Kavajës është ngritur edhe një Qendër Komunitare e Shëndetit Mendor, një shërbim ambulator i ofruar nga një ekip



multidisiplinar që ndjek në dinamikë gjendjen e shëndetit mendor të popullatës në zonën e mbulimit, me qëllim shmangien e hospitalizimit dhe zhvendosjen nga ambienti familjar apo komuniteti ku banojnë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka ndjekur procesin për përmirësimin e legjislacionit për shëndetin mendor. Ndryshimet dhe shtesat e reja të miratuara nga ligji nr. 20/2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012, ‘Për shëndetin mendor’”, i ndryshuar, përmirësojnë mbrojtjen ligjore të personave me çrregullime të shëndetit mendor, kryesisht duke diferencuar procedurat e shtrimit nga ato të trajtimit, qoftë të një natyre të vullnetshme apo të pavullnetshme. Ndryshimet e fundit, gjithashtu, sigurojnë një mbrojtje të shtuar ligjore për personat të cilëve gjykata kompetente u ka hequr zotësinë për të vepruar, duke i siguruar mundësinë për të përfituar nga procedurat për shtrimin ose trajtimin e pavullnetshëm në kushte të njëjta me personat me aftësi të plota për të vepruar.

Për sa i përket kategorisë së personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar” Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, janë tërësisht të angazhuar për adresimin e nevojave për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të tyre.

Sfidat:

- Sigurimin e lehtësirave në institucionet shëndetësore për vizitat e personave me aftësi të kufizuara.

- Trajnimin e infermierëve dhe dentistëve në shkolla dhe zgjerimin e përshkrimeve të punës së tyre për të shërbyer në komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, në zonat ku ato punojnë.

- Hartimin e paketës bazë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe trajnimin e personelit që do ta përdorë atë.

- Informimin e prindërve mbi shërbimet shëndetësore, si dhe mbi lloje të ndryshme sëmundjesh që shkaktojnë aftësi të kufizuara.

- Plotësimin e kuadrit ligjor për të mundësuar ofrimin e pajisjeve të teknologjisë ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara dhe rritjen e kapaciteteve për njohjen, vlerësimin dhe aplikimin e saj në përputhje me nevojat e personit me aftësi të kufizuara.

- Ngritjen e qendrave kombëtare dhe/ose lokale të rehabilitimit.

- Rritjen e kapaciteteve të ndihmës personal rreth kujdesit shëndetësor të personave me aftësi të kufizuara.

- Dehospitalizimi i pacientëve kronikë pranë spitaleve psikiatrike.

- Përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar”.

3.7 Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

3.7.1 Pjesëmarrja në zgjedhje e vendim-marrje

E drejta e votës është një nga të drejtat themelore. Kjo nuk do të thotë vetëm pjesëmarrje në procesin politik, por integrim në shoqëri dhe mundësi për të shprehur mendimin e një personi. Mungesa e pjesëmarrjes në zgjedhje për shumë persona me aftësi të kufizuara është ende një problem. Kjo përfshin mundësinë e përdorimit të informacionit në lidhje me zgjedhjet, që duhet të jetë i përshtatshëm, i arritshëm dhe i kuptueshëm (p.sh., për personat me aftësi të kufizuara shqisore ose mendore), duke garantuar të drejtën e votës për këtë kategori. E drejta për të votuar vazhdon të jetë e mohuar edhe për personat me aftësi të kufizuara që e kanë të pamundur të dalin nga kushtet e shtëpisë. Ka gjasa që votimi elektronik ta kapërcejë këtë pengesë.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare, viti 2017, edhe me iniciativën e organizatave të personave me aftësi të kufizuara, KQZ-ja bëri një fushatë për promovimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në procesin e votimit, e shoqëruar me udhëzimet për procedurat që ndjek zgjedhësi me aftësi të kufizuara në procesin e votimit, duke përdorur informacion të aksesueshëm nëpërmjet përdorimit të gjuhës së shenjave dhe përdorimin e teknikës *Braille*. Gjithashtu u realizuan disa trajnime njëditore nga OSBE-ja për ngritjen e kapaciteteve për personat me aftësi të kufizuara. Praktika e konsoliduar e KQZ-së për përdorimin e fletës së votimit në alfabetin *Braille* është një hap për realizimin e të drejtave. Përfshirja e interpretimit të gjuhës së shenjave në spotet e fushatës ndërgjegjëse të KQZ-së, si dhe aksesueshmëria fizike e qendrave të votimit. Institucionet nuk mbledhin ende të dhëna mbi numrin e personave me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në zgjedhje



apo për numrin e qendrave të votimit të aksesueshme. Në lidhje me rishikimin e përbërjes së këshillave dhe komiteteve në nivel qendror dhe vendor, KQZ-ja përgjigjet që ky aktivitet nuk është realizuar, pasi sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, dokumentet e kandidimit nuk përmbajnë të dhëna për aftësinë e kufizuar të kandidatëve të paraqitur nga partitë politike. Deri tani nuk ka të dhëna për përfshirjen apo numrin e personave me aftësi të kufizuara në këshillat vendorë apo komitetet, pasi nuk është në statistikën e KQZ-së. Për të realizuar të drejtën e pjesëmarrjes në jetën politike të personave me aftësi të kufizuara dhe promovimin e aftësive që ata kanë do të ishte e nevojshme marrja e masave përfshirëse nëpërmjet vendosjes së kuotave për aftësinë e kufizuar të ngjashme me ato të barazisë gjinore.

Kodi elektoral përmirësohet në mënyrë të tillë që mundëson votimin në banesë. Lidhur me të gjitha këto ka pasur iniciativë nga KQZ-ja, duke bërë propozime dhe rekomandime për përmirësimin e Kodit Zgjedhor, por deri tani nuk janë marrë parasysh akoma nga komisionet e ngritura për reformën zgjedhore apo nga Kuvendi.

3.7.2 Pjesëmarrja në aktivitetet kulturore dhe sportive

Për sa i përket përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën kulturore, ka pasur një praktikë të mirë nga MK-ja për promovim nëpërmjet mbështetjes së projekteve në art-kulturë dhe trashëgimi kulturore. Gjatë tri viteve të para të zbatimit të Planit janë financuar pesë projekte të zbatuara nga organizata të ndryshme, që kanë pasur në fokus promovimin e artistëve me aftësi të kufizuara. Gjatë vitit 2019, projekti “Shijoni një gatim nga duart tona”, organizuar nga Shoqata “Solidariteti Tani” dhe zhvilluar në qytetin e Përmetit, konsistoi në përfshirjen në jetën komunitare të tridhjetë fëmijëve me aftësi të kufizuara, jo vetëm duke i promovuar, por edhe duke i edukuar për ruajtjen e traditave më të mira të kulinarisë së zonës. Ndërsa aktivitetet e parealizuara të PVKPAK-ut 2016–2020, lidhen me emërimin e një personi përgjegjës për trajtimin e çdo shkelleje të VKM-së për hyrjen falas të personave me aftësi të kufizuara në muze, me dorëzimin e agjendës së aktiviteteve në KKAK-së, si dhe përcaktimin e një mase për veprim afirmues (p.sh. kuota ose pikë bonus) për përzgjedhjen e projekteve të propozuara nga personat me aftësi të kufizuara.

Këto aktivitete nuk janë realizuar për shkak të mosnjohjes së detyrimeve që vijnë nga ky plan që, nga ana tjetër, lidhet me mungesën e burimeve njerëzore dhe prioritizimin e çështjes së aftësisë së kufizuar në këtë fushë.

Sipas PKIE 2020–2022, Ministria e Kulturës është angazhuar me hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016, ‘Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to’”. Në këtë projektligj parashikohet të harmonizohet direktiva (BE) 2017/1564 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Mbi disa përdorime të lejuara të veprave të caktuara dhe fusha të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara, dhe amendimin e direktivës 2001/29/KE mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në shoqërinë e informacionit”. Direktiva e sipërcituar synon të përcaktojë rregulla për lehtësimin e aksesit në veprat e publikuara për personat të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara. Kjo direktivë është në zbatim të Traktatit të Marakeshit. Duke qenë se aderimi në Traktatin e Marakeshit është edhe një ndër detyrimet që burojnë nga Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelktuale 2016–2020, në Ministrinë e Kulturës grupi i punës po punon “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Marakeshit”, për të lehtësuar aksesin në veprat e publikuara për personat të cilët janë të verbër, të dëmtuar në shikim ose me aftësi të kufizuara në shikim”, si dhe në Traktatin e Pekinit për veprat audiovizuale”.

Në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin” (i ndryshuar) është parashikuar që “Personat me aftësi të kufizuara mund të organizohen në shoqata sportive dhe të anëtarësohen në federata të cilat kanë ekskluzivitetin e trajtimit të të gjitha çështjeve të një sporti”, duke krijuar hapësirën e nevojshme ligjore, për vetorganizim të këtij grupi në organizata e veprimtari sportive.

Referuar kategorisë së personave me aftësi të kufizuara intelektuale, përpjekjet për organizimin e tyre kanë qenë më rezultative duke nisur nga viti 2017, me krijimin e Organizatës “Olympic Special Albania”, si një organizatë që në mision të saj ka të



ofrojë trajnim sportiv gjatë gjithë vitit dhe konkurrencë atletike në një shumëllojshmëri të sporteve olimpike për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara intelektuale, duke u dhënë atyre mundësi të vazhdueshme për të zhvilluar aftësitë fizike, të tregojnë kurajë, të gëzojnë përvojë dhe të marrin pjesë në ndarjen e dhuntive, aftësive dhe miqësinë me familjet e tyre, atletët e tjerë të Olimpikut Special dhe komunitetin. Kjo organizatë është anëtarësuar pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Komitetit Olimpik Special Ndërkombëtar. Kjo organizatë, në bashkëpunim me MASR-në, realizoi projektin “3 points for inclusion”, qëllimi i të cilit ishte ofrimi i mundësisë për të rinjtë me aftësi të kufizuara intelektuale të marrin pjesë në veprimtaritë e titulluara “Sporte të unifikuara”, të cilat vijnë si praktika të reja sportive gjithëpërfshirëse, për herë të parë në vendin tonë. Këto praktika konsistojnë në krijimin e skuadrave të përbashkëta me individë me dhe pa aftësi të kufizuara, si mundësi shumë e mirë për gjithëpërfshirje dhe rritje të sensibilitetit social ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Vështirësitë kryesore, që lidhen me aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në veprimtari sportive, lidhen kryesisht me infrastrukturën sportive, në të cilën përfshihen ambientet sportive të hapura (stadione, fusha sportive etj.) e të mbyllura (pallate sporti, palestra e qendra sportive etj.). Këto janë objekte në administrim të pushtetit vendor, për të cilat ka një *data-bazë* të detajuar në rang vendi, por nuk disponohet informacion i detajuar mbi kushtet që ato duhet të plotësojnë për të qenë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara. Duke përjashtuar infrastrukturën sportive të ndërtuar rishtas (pallati i lojërave tek “Olimpik Park” dhe stadiumi kombëtar “Air Albania”), ku janë përfshirë elementet e aksesueshmërisë, në infrastrukturën sportive duhen ndërhyrje.

Sfidat

- Trajnimin e komisionerëve zgjedhorë, të cilët nuk marrin pjesë në trajnimet mbi procedurat e votimit të personave me aftësi të kufizuara e për pasojë kjo sjell vështirësi në zbatimin e dispozitave që përmban Kodi Zgjedhor (pavarësisht përgatitjes së moduleve të veçanta).

- Dërgimin në kohë, nga ana e kryetarëve të bashkive, të të dhënave për zgjedhësit me aftësi të kufizuara apo koha e pamjaftueshme në

dispozicion për të realizuar përshtatjen e përmbajtjes së fletës së votimit në *Braille*.

- Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në vendimmarrje, nëpërmjet vendosjes së kuotave për përfaqësim në këshillat bashkiakë.

3.8 Bashkëpunimi rajonal, monitorimi dhe vlerësimi

Raporti i vlerësimit afatmesëm identifikoi progres të konsiderueshëm, për sa i përket: ngritjes së rrjetit të zyrtarëve për aftësinë e kufizuar, nëpërmjet përcaktimit të pikave të kontaktit për aftësinë e kufizuar në çdo ministri të linjës dhe në 61 bashkitë e vendit, sipas përcaktimit dhe në zbatim të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”; fuqizimit të kapaciteteve të tyre nëpërmjet trajnimeve të mbështetura nga UNDP-ja e të realizuara jo vetëm për trajtimin bashkëkohor të çështjeve të aftësisë së kufizuar si çështje të të drejtave të njeriut, por edhe për mënyrën se si ata duhet të ushtrojnë rolin e tyre si punonjës për aftësinë e kufizuar në përpunime me ligjin nr. 93/2014; hartimi i planeve lokale për aftësinë e kufizuar në 10 bashki të vendit; përgatitja dhe realizimi në kohë i takimeve të KKAK-së.

Bazuar në përvojën e bashkërendimit dhe monitorimit të planeve kombëtare të zbatuar deri tani, do të ishte e përshtatshme dhe e duhur për sistemin monitorues, hartimi dhe paraqitja e një Raporti vjetor të Progresit për masat e Planit Kombëtar, nga të gjitha ministratë e linjës në kompetencën e tyre për çdo vit kalendarik. Janë hartuar dy raporte vjetore për zbatimin e PKVPAK 2016–2020, të cilat janë të fokusuara në politikat, strategjitë, aktivitetet dhe masat e marra nga institucionet, por nuk përmbajnë raportim për buxhetin.

Pavarësisht punës së mirë të bërë në drejtim të ngritjes së kapaciteteve, pikat e kontaktit të zgjedhura si në nivel qendror ashtu edhe atë vendor, kanë mbivendosje të shumë detyrave gjë që e bën të vështirë fokusimin dhe dedikimin e tyre në politikat që afektojnë personat me aftësi të kufizuara. Janë përgatitur përshkrime pune të detajuara për pikat e kontaktit në nivel qendror dhe në nivel vendor, por nuk ka raporte të matjes së performancës së tyre.

NJQV-të kanë detyrim të raportojnë çdo 6 muaj pranë MSHMS-së mbi realizimin e aksesueshmërisë, por raportimet nga bashkitë janë vetëm për pagesat për AK-në dhe shërbimet



shoqërore që ofrohen në nivel vendor dhe nuk raportohet për të gjitha detyrimet që NJQV-të kanë për zbatimin e PKVPAK-ut. Gjithashtu, problem mbetet fakti që bashkitë nuk raportojnë pranë MSHMS-së për vlerësimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara në zonat e tyre.

Sipas vëzhgimeve përmbyllëse të Komitetit të KDPAK-ut, deri tani mbledhja e të dhënave për personat me aftësi të kufizuara bazohet në aspektin mjekësor (sipas KMCAP-së) dhe pagesave të aftësisë së kufizuar që ata marrin. Gjithashtu, ka të dhëna për numrin e individëve që marrin shërbime në institucionet e përkujdesjes shoqërore. Nuk ekzistojnë të dhëna që lidhen me nevojat e tjera sociale në aspektin e edukimit, punësimit dhe rritjes së aftësive, strehimit, nevojave për shërbime mjekësore, përfshirjes së tyre në jetën publike dhe vendimmarrje etj. Ligji nr. 93/2014, neni 17, përcakton detyrimin e institucioneve të mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar sipas fushave ku ato operojnë, të përcaktuara sipas VKM-së nr. 708, datë 26.8.2015, “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, por institucionet duhet të analizojnë të dhënat sipas fushave dhe indikatorëve përkatës. Nga ana e INSTAT-it ka filluar përfshirja e disa moduleve pyetjesh mbi aftësinë e kufizuar në studimet kombëtare si Cens 2021, SILC, anketa e shëndetësisë WHIS 2020.

Sfidat

- Përmirësimi i funksionimit të KKAK-ut, sipas rekomandimeve të dhëna nga Komiteti i OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

- Organizimin e takimeve të strukturuaras mes MSHMS-së dhe ministrive të linjës, bashkive e organizatave të shoqërisë civile ku të raportohet çdo vit mbi zbatimin e PKVPAK-ut, si dhe të parashikohen aktivitetet që do të zbatohen në vijim.

- Përgatitjen e raporteve të strukturuaras dhe të mbështetura në zbatimin e PKVPAK-ut nga ministritë e linjës dhe nga bashkitë.

- Botimin e raporteve vjetore, përfshirë informacione mbi realizimin e buxheteve, për zbatimin e PKVPAK-ut.

- Ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm statistikor për mbledhjen e të dhënave të të gjitha dimensioneve të aftësisë së kufizuar në çdo sektor.

- Organizimin e konferencave dhe ndarjen e modeleve pozitive nga rajoni e nga vendi.

4. Vizioni dhe misioni i dokumentit

4.1 Vizioni

Vizioni i qeverisë shqiptare për politikën e aftësisë së kufizuar që mishërohen në këtë dokument është:

“Përparimi i të drejtave dhe statusit të personave me aftësi të kufizuara, duke mundësuar përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre në të gjitha sferat e jetës në një bazë të barabartë me të tjerët, dhe duke siguruar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë nivelin e mundshëm të pavarësisë dhe lirisë së zgjedhjes, në përputhje me standardet ndërkombëtare.”

4.2 Misioni

Përcaktimi i prioriteteve strategjike dhe politikave të qëllimshme afatmesme dhe afatgjate, me qëllim që të sigurojë gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë, rritjen e cilësisë së jetës dhe mirëqenien e tyre, si dhe përmbushjen e detyrimeve shtetërore drejt zbatimit të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Në funksion të zbatimit të KDPAK-ut dhe përmbushjes së rekomandimeve të Komitetit të Monitorimit të kësaj konvente, një vëmendje të veçantë në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të Planit do të kenë grupet e cënueshme, që mund të përballen me diskriminim të shumëfishtë, si:

- fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillimore, zhvillimi i të cilëve, si dhe efektet e aftësisë së kufizuar, varen në mënyrë të konsiderueshme në zbulimin e hershëm dhe ndërhyrjen e mbështetjen për përfshirjen e tyre në sistemin e arsimit;

- të rinjtë me aftësi të kufizuara, të cilët përballen me pengesa të shumta dhe kufizime në ushtrimin e të drejtave të tyre për arsim, punësim, strehim, fillimin e një familjeje etj.;

- gratë me aftësi të kufizuara, të cilat për shkak të paragjykimëve kulturorë dhe stereotipave gjinorë shpesh ballafaqohen me diskriminim të shumëfishtë;

- personat me aftësi të kufizuara të moshuar, numri i të cilëve vjen duke u rritur;

- personat me aftësi të kufizuara, që u përkasin komuniteteve vulnerabël, siç janë ato romë dhe egiptiane;

- personat me aftësi të kufizuara të rënda, cilësia e jetës së të cilëve varet nga shërbimet e



disponueshme në komunitet dhe të cilët kërkojnë mbështetje të konsiderueshme sociale.

Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultatit

- Përqindja e institucioneve qendrore, që kanë miratuar planin e aksesueshmërisë dhe kanë planifikuar fondet e duhura.

- PAK-u që përfiton nga ndihma ligjore falas në raport me grupet e tjera vulnerabël.

- Numri i personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga kurset falas të AFP-së.

- Rritja e punësimit të PAK-ut nëpërmjet programeve të punësimit.

- Fonde të alokuara nga FSP-ja për përshtatjen e vendit të punës.

- Funksionimi i komisioneve multidisiplinare të arsimit për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- Raporti fëmijë me AK/mësuesndihmës.

- Numri i mësuesvendihmës të trajnuar për aftësinë e kufizuar.

- Numri i fëmijëve me AK që përfitojnë transport falas për frekuentimin e shkollës.

- Numri i shërbimeve publike që ofrojnë interpretimin në gjuhën e shenjave.

PJESA II

QËLLIMET I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Qëllimet strategjike të Planit të Veprimit, janë:

1. Realizimi i aksesueshmërisë në mjedise, shërbime, transport dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara.

2. Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

3. Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe nxitja e mundësive të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara.

4. Sigurimi dhe ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.

5. Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitimeve të aksesueshme, të përbalueshme financiarisht dhe që kanë në qendër klientin.

6. Ofrimi i një kujdesi shëndetësor të aksesueshëm e të përbalueshëm për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

7. Garantimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike në Shqipëri dhe mundësimi i mbrojtjes së interesave të tyre.

8. Krijimi i sinergjive ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm për nxitjen dhe monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të plotë, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Arritja e këtyre qëllimeve kërkon përpjekje të gjithanshme nga të gjitha ministritë dhe institucionet që zbatojnë politika të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në jetesën e personave me aftësi të kufizuara. Masat dhe ndërhyrjet që propozohen kanë karakter ligjor, institucional, por edhe karakter specifik, në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim që ata të ushtrojnë me lehtësi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Një nevojë e domosdoshme dhe e vazhdueshme është gjetja e mekanizmave të duhur dhe të përshtatshëm që sigurojnë një bashkëpunim të fortë dhe efektiv ndër-institucional, si në drejtimin horizontal ashtu dhe atë vertikal. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, kanë gjithashtu rëndësi themelore, pasi ato mund të ndikojnë ndjeshëm në ndërgjegjësimin rreth proceseve të reformave për aftësinë e kufizuar, si dhe ofrimin e ekspertizës për zhvillimin e standardeve dhe shërbimeve të reja. Gjithashtu, ato duhet të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në monitorimin e zbatimit të këtij Planit Veprimi.

Qëllimi i politikës 1. Realizimi i aksesueshmërisë në mjedise, shërbime, transport dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara

Një nga fushat politike me shumë rëndësi, që renditet si një fushë prioritare në PVKPAK 2021–2025, është ajo e sigurimit të aksesueshmërisë fizike në të gjitha mjediset dhe shërbimet, aksesit në transport, aksesit në informacion dhe komunikim për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

Aksesueshmëria, e shprehur në nenin 9 të KDKPAK-së, është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me një nga liritë e të drejtat themelore të njeriut që është liria e lëvizjes, e drejta për të marrë normalisht shërbimet publike në të gjitha fushat e jetës, e drejta e informimit dhe komunikimit që lidhet me lirinë e çdo njeriu për t'u përfshirë në mënyrë aktive në jetën publike dhe



politike të vendit. Mungesa e aksesueshmërisë sjell detyrimisht kufizimin e realizimit të lirive dhe të drejtave të individit. Në këtë kontekst, është fare e qartë arsyeja pse aksesueshmëria vlerësohet si një parakusht për realizimin e të gjitha të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Duke qenë politikë e lidhur ngushtësisht me realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, por edhe atë të përfshirjes e mosdiskriminimit, ajo kontribuon dhe lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kapitujt 23 dhe 19 të negociatave me BE-në sipas MSA-së.

Komiteti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, rekomandon që qeveria shqiptare, duhet: i) të adaptojë një plan veprimi gjithëpërfshirës në zbatim të ligjit nr. 93/2014, duke siguruar buxhetin e mjaftueshëm, një mekanizëm të efektshëm të monitorimit të standardeve për heqjen e barrierave, si dhe sanksione të forta dhe efektive në rastet e moszbatimit të tyre; ii) të vendosë një mekanizëm për monitorimin e zbatimit të standardeve të aksesueshmërisë në të gjitha fushat, si edhe imponim të sanksioneve në rastet e mospërbushjes së tyre; iii) të sigurojë informacione të plota mbi aksesueshmërinë e

mediave elektronike, me vëmendje të veçantë kushtuar medias sociale.

Qëllimi, objektivat specifike dhe masat e parashikuara në këtë plan për realizimin e aksesueshmërisë, adresojnë reduktimin e barrierave për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim: i) sigurimin e aksesit në të mirat materiale, shërbimet dhe lehtësirat; ii) sigurimin dhe mbajtjen e vendit të punës; iii) përfshirjen dhe pjesëmarrjen në komunitet; iv) ndryshimet në sjelljet, qëndrimet dhe veprimet, të cilat diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara.

Politika orienton institucionet publike në masat që ato duhet të marrin për realizimin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, në: i) mjedise; ii) transport; iii) informacion e komunikim (përfshirë këtu aksesueshmërinë e platformave dhe portaleve); aksesueshmërinë në botimet e njoftimet publike; aksesueshmërinë në telekomunikacion, në faqet e internetit, si dhe në programacionet televizive.

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këta objektiva specifike:

Objektivi specifik 1	Realizimi i aksesueshmërisë në mjedise për personat me aftësi të kufizuara
Objektivi specifik 2	Realizimi i aksesueshmërisë në transport për personat me aftësi të kufizuara
Objektivi specifik 3	Realizimi i aksesueshmërisë në informacion dhe në komunikim për personat me aftësi të kufizuara

Objektivi specifik 1. Realizimi i aksesueshmërisë në mjedise për personat me aftësi të kufizuara

Një element i rëndësishëm në realizimin e aksesueshmërisë në mjedise dhe forcimin e masave për zbatimin e kuadrit ligjor, është përmirësimi i strukturave bashkërenduese dhe monitoruese, bazuar në ligjin nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”¹⁷. Pikat fokale në çdo institucion, duhet të jenë pika lidhjeje me sektorët dhe institucionet e tjera, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave pozitive në realizimin e aksesueshmërisë, mbajtjen e

informacionit mbi zbatimin e ligjit, mbajtjen e regjistrit të sugjeruar nga ky plan veprimi me të dhëna mbi situatën e aksesueshmërisë së aseteve (ndërtesave dhe infrastrukturës) të institucionit, përfshirë vlerësimin e nivelit të aksesueshmërisë së aseteve dhe propozimin e masave për përmirësimin/realizimin e saj, si edhe mirëmbajtjen dhe përditësimin e këtij informacioni. Krijimi i një regjistri do të lehtësonte ndjeshëm punën e autoriteteve përgjegjëse, për të vendosur mbi planifikimin e investimeve. Këto pika fokale duhet të merren ekskluzivisht me çështje të personave me aftësi të kufizuara, sipas ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë.

¹⁷ Neni 14, pika 1:... Në çdo ministri, me urdhër të ministrit përkatës, caktohet një nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar.



Një nga masat e parashikuara për arritjen e këtij objekti është funksionimi i task-forcës pranë MSHMS-së (grupi ndërinstitucional¹⁸ i punës për marrjen e masave në kuadër të aksionit kombëtar “Mjedis të përshtatur të gjithë”). Task-forca, me përfaqësim nga institucionet qendrore, e cila është e angazhuar me aftësinë e kufizuar, duhet: i) të konsultojë politikën e programeve mbi përshtatshmërinë e mjedisit; ii) të propozojë projekte sektoriale; iii) të monitorojë zbatimin e standardeve të aksesueshmërisë nga secili institucion; iv) të propozojë programe për përmirësimin e nivelit të përshtatshmërisë së tyre në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse; v) të mbledhë e të përpunojë raportet nga institucione të tjera qendrore dhe vendore dhe të përgatisë një raport kombëtar të përvitshëm; vi) të raportojë periodikisht pranë KKAK-së, i cili duhet të ndërmarrë një rol më proaktiv ndaj politikave dhe zbatimit të legjislacionit. Kjo task-forcë duhet të riformatohet dhe fuqizohet më tej, me një sekretariat të posaçëm dhe, gjithashtu, me personel administrativ mbështetës. Kjo do të përmirësonte ndjeshëm punën e kësaj task-force, i cili në kushtet aktuale e ka të pamundur të përmbushë misionin e përcaktuar.

Me qëllim monitorimin e zbatimit të kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë në të gjitha ndërtimet e reja dhe ato që rikonstruktohen, nevojitet një strukturë kontrolli e specializuar ose fuqizimi i strukturave ekzistuese të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në nivel qendror dhe vendor, të cilat duhet të funksionojnë si struktura monitoruese në parashikim të VKM-së¹⁹ nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Aktualisht, ekziston një kuadër ligjor i plotë dhe bashkëkohor për të garantuar mjedis të përshtatur në të gjithë territorin e vendit, por zbatimi i tij po kryhet me ritme të ngadalta. Për

të nxitur zbatimin, duhen kryer përmirësime në akte ligjore dhe nënligjore (VKM, rregullore, udhëzime, manuale etj.) në zbatim të ligjeve, me të cilat operon çdo institucion, me qëllim detajimin dhe forcimin e detyrimeve për aplikimin e kërkesave dhe standardeve për të realizuar aksesueshmërinë në mjedise, si dhe aplikimin e penaliteteve përkatëse, në rast të moszbatimit të tyre. Rëndësi të veçantë marrin përmirësimet në kuadrin ligjor sektorial, që ka lidhje me zhvillimin dhe kontrollin mbi territorin në nivel qendror dhe vendor, zhvillimin e turizmit, funksionimin e strukturave mbështetëse e monitoruese të zbatimit të ligjit dhe prokurimet me fonde publike. Për ndryshimet dhe plotësimet e kuadrit ligjor sektorial, duhet të forcohet bashkëpunimi me KKAK-un, në zbatim të ligjit²⁰ nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara”.

Një moment i rëndësishëm i zbatimit të planit është edhe vlerësimi i situatës së aksesueshmërisë së aseteve publike (ndërtesa dhe infrastrukturë), si dhe planifikimi i buxhetit përkatës për përfshirjen e elementeve të aksesueshmërisë në të gjitha asetet, sipas përparësive. Të dhënat mbi vlerësimin e objekteve, do të hidhen në regjistrin e aseteve, duke e pasuruar atë me informacion, mbi: i) nivelin ekzistues të aksesueshmërisë; dhe ii) planifikimin për ndërhyrjet e domosdoshme për realizimin e saj, sipas afateve kohore të përcaktuara. Bazuar në vlerësimin e bërë në lidhje me objektet që çdo institucion ka në varësi, përcaktohen objektet parësore, të cilat diskutohen në dëgjesa publike me grupet e interesit, kryesisht individë me aftësi të kufizuara dhe organizata të personave me aftësi të kufizuara. Më tej, hartohen projektet, përcaktohen kostot reale dhe bëhet realizimi i tyre, bazuar në një plan afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Institucionet përgjegjëse për realizimin e aksesueshmërisë në mjedise, duhet të inkurajojnë rritjen e kapaciteteve të stafit të tyre, të strukturave të varësisë dhe operatorëve të shërbimit në lidhje me njohjen e Konventës së

¹⁸ Urdhri i Kryeministrit nr. 71, datë 5.4.2019 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për marrjen e masave në kuadër të aksionit kombëtar “Mjedis të përshtatur të gjithë”.

¹⁹ Kreu III, “Monitorimi dhe ankimimi”, 1. *Monitorimi për zbatimin e këtij vendimi bëhet nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili merr masat përkatëse sipas kompetencave të veta dhe njofton ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar për çdo rast shkeljeje.*

²⁰ Ligji nr. 93/2014, neni 13, pika “e”: “Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara”.



OKB-së, të kuadrit ligjor shqiptar dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare, për: planifikim, projektim, ndërtim dhe përdorim të ndërtimeve dhe infrastrukturës. Institucionet, gjithashtu, duhet të inkurajojnë promovimin e praktikave pozitive dhe denoncimin e rasteve me shkelje ose anashkalim të kërkesave të aksesueshmërisë.

Për zhvillimin e programeve trajnuese dhe të fushatave ndërgjegjëse, task-forca do të bashkëpunojë me pikat fokale në të gjitha institucionet, si dhe anëtarët e KKAK-ut. Përfshirja dhe kontributi i personelit akademik dhe studentëve të Universitetit Politeknik në këtë proces, është një vlerë e shtuar për pasurimin e programeve të fushatave ndërgjegjëse me informacione bashkëkohore dhe eksperiencë ndërkombëtare. Ndërkohë, Universiteti Politeknik i cili luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm që do të punojnë për projektimin dhe ndërtimin e një mjedisi të përshtatur për të gjithë, nevojitet të rishikojë dhe të përditësojë kurrikulat për të reflektuar standardet bashkëkohore në këtë drejtim.

Objekti i specifik 2. Realizimi i aksesueshmërisë në transport për personat me aftësi të kufizuara

Ekzistenca e një transporti të aksesueshëm përbën diferencën mes të ndjerit i izoluar apo i përfshirë në shoqëri. Ai nuk ka të bëjë vetëm me sigurimin e aksesueshmërisë në transport për të gjithë, por edhe me mundësimin e ofrimit të shërbimeve që duhet të ngrihen e financohen nga pushteti vendor në komunitetet ku personat me aftësi të kufizuara jetojnë.

Ofrimi i transportit të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara, është një nga objektivat kryesorë të këtij Plani. Ky dokument parashikon masa të rëndësishme, zbatimi i të cilave do të mundësojë që personat me aftësi të kufizuara të përdorin në mënyrë të pavarur transportin e aksesueshëm.

Për të rritur nivelin e aksesueshmërisë në transportin publik, fillimisht duhet të merren masa për rregullime legjislative të duhura dhe në përputhje me ato të BE-së. Aplikimi i standardeve të BE-së dhe përafrimi i një kuadri ligjor për të mundësuar realizimin e të drejtave të pasagjerëve me aftësi të kufizuara në udhëtimet me trena, autobusë (brenda qyteteve dhe ndër

qytete), avionë dhe anije, është edhe një kusht për integrim.

Aktivitetet, të cilat janë parashikuar për zbatimin e këtij objekti, do të fokusohen në përmirësimin e kuadrit ligjor që mundëson transportin e aksesueshëm për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Po ashtu, ato do të fokusohen në hartimin e kriterëve të aksesueshmërisë për transportin qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas, si edhe në sigurimin e aksesueshmërisë në terminalët/ stacionet e autobusëve, hekurudhore, detare dhe ajrore. Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në transport, do të punohet për të siguruar pajisjen e një pjese të konsiderueshme të mjeteve të transportit publik me platformë, me kamera sigurie, pajisje GPS dhe opsione/teknika audiopamore në të gjitha mjetet që ofrojnë transport publik, si edhe do të hartohen guida, harta, udhëzues për të lehtësuar aksesin e tyre në transport. Aty ku nuk është i mundur ofrimi i transportit të aksesueshëm (përfshirë zona të largëta periferike), do të rregullohet baza ligjore dhe do të financohen projekte/operatorë, që ofrojnë transport “derë më derë” për personat me aftësi të kufizuara fizike.

Rëndësi do t'i kushtohet informimit elektronik, duke ndërtuar një faqe interneti me elemente aksesueshmërie, që do të informojë publikun në përgjithësi, përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara, mbi linjat, oraret, ndalesat dhe kohëzgjatjen e udhëtimeve. Gjithashtu, duhet të realizohet zhvillimi i një aplikacioni të shkarkueshëm falas, i cili mundëson informacion në kohë reale në aparatet celulare, mbi të gjitha udhëtimet.

Personat me aftësi të kufizuara jo rrallë mund të përballen me një gjuhë fyese dhe qëndrime diskriminuese gjatë lëvizjes me transport publik. Për këtë arsye, një nga synimet e këtij Plani është përmirësimi i qëndrimeve dhe i sjelljeve ndaj udhëtarëve me aftësi të kufizuara. Fokus i aktiviteteve për këtë synim, do të jetë fuqizimi i kapaciteteve të stafit të angazhuar në transportin rrugor të udhëtarëve (ndërqytetas, rrethqytetas, qytetas) dhe transporti hekurudhor për trajtimin, komunikimin dhe dhënien e shërbimit përkatës për personat me aftësi të kufizuara, si edhe përgatitja e një Kodi Etike, me synim përmirësimin e komunikimit dhe terminologjisë



gjatë ndërveprimit me pasagjerët me aftësi të kufizuara.

Aktivitetet të tjera, do të fokusohen në organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit për të drejtat në transport për personat me aftësi të kufizuara, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, grupet e interesit, organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe mediat.

Objektivi specifik 3. Realizimi i aksesueshmërisë në informacion dhe në komunikim për personat me aftësi të kufizuara

Qasja në informacion dhe komunikim është një aspekt kryesor për pjesëmarrjen në shoqëri. Nëse personat me aftësi të kufizuara duhet të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë aktive, të marrin pjesë dhe të bëjnë zgjedhje në lidhje me jetën e tyre, është thelbësore që ata të mund të përdorin informacionin përmes sistemeve të përshtatshme të komunikimit. Institucionet publike e ato jopublike, kanë detyrimin të sigurojnë që informacioni të jetë i arritshëm në një gamë të formateve, që u përgjigjen nevojave të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, duhet të jenë modele të praktikave më të mira për sektorin privat, dhe të gjithë ata që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, duhet të inkurajohen të miratojnë praktika të tilla. Nëse kërkojmë një shoqëri me të vërtetë gjithëpërfshirëse, personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë në gjendje të përdorin sistemet e informacionit dhe komunikimit së bashku me të gjithë të tjerët.

Aksesueshmëria në informacion dhe komunikim për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, duhet të sigurohet në të gjitha shërbimet që ofrohen për publikun, përfshirë sportele dhe portale, faqe interneti, pajisje dhe shërbime celulare, televizione dhe programacione, si dhe publikime, takime dhe ngjarje publike. Aktivitetet e parashikuara janë grupuar në 4 nënobjektiva:

i. aksesueshmëria në shërbimet për publikun, qofshin këto shërbime të TIK-ut apo publikime, takime dhe ngjarje publike;

ii. aksesueshmëria në shërbimet e komunikimeve elektronike;

iii. aksesueshmëria në faqet e internetit;

iv. aksesueshmëria e programacioneve televizive.

i.1 Aksesueshmëria në informacion dhe në komunikim në shërbimet publike

Në zbatim të VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017, sportelet dhe portalet e institucioneve të administratës shtetërore, të cilat ofrojnë shërbime publike (si p.sh.: ADISA Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara) kanë detyrimin të sigurojnë që shërbimet e ofruara të jenë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara. KDPAK-u njeh potencialin e TIK-ut për të mundësuar akses dhe pjesëmarrje nga personat me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e shoqërisë. TIK-u përdoret gjithnjë e më shumë si mediumi i preferuar i komunikimit dhe ofrimit të shërbimeve në të gjithë sektorët, përfshirë punësimin, arsimin, qeverisjen dhe sistemin bankar. Zhvillimi i një kulture dhe praktike për aksesueshmërinë në TIK, për personat me aftësi të kufizuara, është domosdoshmëri, veçanërisht në pikat ku ofrohen shërbime publike, duke ndërmarrë masa, që sigurojnë aksesin në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Fokusi i këtij nënobjektivi është rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, me qëllim përfshirjen e elementeve të aksesueshmërisë në informacion e komunikim për personat me aftësi të kufizuara, si edhe në adaptimin e standardeve ndërkombëtare të sigurimit të aksesueshmërisë në TIK në portale dhe sportele qeveritare. Parashikohen, gjithashtu, masa institucionale që lidhen me përmirësimin apo krijimin e strukturave përgjegjëse për zbatimin, monitorimin e inspektimin dhe zbatimin të kuadrit ligjor dhe politik që siguron aksesueshmërinë në informacion dhe komunikim për personat me aftësi të kufizuara.

Masat marrin në konsideratë nevojat specifike, që kanë kategori të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara, duke referuar që pajisjet dhe shërbimet publike të jenë të aksesueshme nga persona që kanë dëmtime të shikimit, nga ata që kanë probleme me dëgjimin, si dhe nga ata që kanë vështirësi me lëvizjen. Këto pajisje, duhet: i) të përdorin ikona universale; ii) të kenë programe, të cilat mundësojnë leximin për personat me vështirësi në shikim; iii) të kenë pajisje audio; iv) të kenë programe që u mundësojnë përdoruesve me probleme në shikimin të zmadhojnë shkrimin dhe madhësinë



e ikonave; v) të kenë lexues dhe printera të kodit *Braille* (në një numër të arsyeshëm). Aktivitete të tjera do të fokusohen në aplikimin gradual të standardeve të aksesueshmërisë në portalin <https://e-albania.al> dhe në të gjitha portalet e tjera ndërvepruese me publikun. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet aksesueshmërisë së portaleve të emergjencave apo situatave të jashtëzakonshme, si: tërmetet, pandemitë apo fatkeqësi të tjera natyrore.

Informimi dhe ndërgjegjësimi publik mbi aksesueshmërinë në pikat e shërbimeve për publikun, është një tjetër synim që duhet të jetë në fokus të këtij nënobjektivi. Masat respektive lidhen me fuqizimin e kapaciteteve të stafit për mënyrën se si t'u shërbejnë personave me aftësi të kufizuara, por edhe informimi, ndërgjegjësimi dhe trajnimi i personave me aftësi të kufizuara mbi përdorimin e TIK-ut në formate të aksesueshme.

i.2 Aksesueshmëria e botimeve/ publikimeve/ ngjarjeve publike/ takimeve ballë për ballë

Për personat me aftësi të kufizuara është e rëndësishme që informacioni të ofrohet në një mënyrë të arritshme/aksesueshme, në gjuhë dhe formate të ndryshme, të cilat kuptohen dhe përdoren lehtë nga kategori të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara. Personat me dëmtime ose humbje shqisore mund të kenë nevojë për informacion në formate alternative, të tilla si: audio, *Braille*, gjuha e shenjave, formate lehtësisht të lexueshme ose printim me germa të mëdha.

Masat që do të merren për realizimin e këtij nënobjektivi do të synojnë në përmirësimin e kuadrit ligjor rregullator për aksesueshmërinë e botimeve/ publikimeve/ ngjarjeve publike/ takimeve ballë për ballë nga institucionet publike, por edhe në hartimin dhe miratimin e Standardeve të Informacionit dhe Komunikimit të Aksesueshëm në publikimet, ngjarjet dhe takimet publike, standarde të cilat do të shërbejnë si udhërrëfyes për institucionet publike, qendrore e vendore. Disa aktivitete fokusohen tek orientimi i të gjitha institucioneve publike për të përgatitur dhe ofruar informacionin e shtypur/botuar, si edhe dhe atë të ofruar *online* dhe në portale, të arritshëm/aksesueshëm dhe

përfshirës. Informacioni²¹ duhet të ofrohet në formate dhe gjuhë alternative, përfshirë: i) komunikimin, me qëllim që personat me aftësi të kufizuara të kontaktojnë institucionet publike dhe të mbështeten për pjesëmarrje në takime ballë për ballë; ii) informacionin, përfshirë të gjitha informacionet e publikuara nga institucionet publike, qofshin të printuara ose në mënyrë elektronike, të cilat duhet të prodhohen në formate alternative; iii) adresimin e nevojave për komunikim, përfshirë rregullimin e një profesionisti të interpretit në gjuhën e shenjave, për të mbështetur diskutimin ballë për ballë.

Rëndësi në zhvillimin e aktiviteteve i është dhënë edhe realizimit të fushatave të ndërgjegjësimi dhe informimit, me qëllim që personat me aftësi të kufizuara të mësojnë mbi tipologjinë e informacionit dhe komunikimit të aksesueshëm në botimet dhe eventet zyrtare, si edhe në fuqizimin e stafeve të institucioneve publike qendrore e vendore për të njëjtin.

ii. Aksesueshmëria në shërbimet e komunikimeve elektronike publike, përfshirë telefoninë e lëvizshme

PKVPAK 2021–2025 ka në fokus të tij edhe qasjen në komunikimet elektronike të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. Institucionet politikëbërëse, rregullatorët dhe aktorët e tjerë aktivë në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit po edhe në bashkëpunim me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, kanë përgjegjësitë e tyre për të mundësuar aksesin në komunikimin celular të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara.

Masat e parashikuara për sigurimin e aksesit në komunikimet elektronike, sidomos ato celulare, janë në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, mbështeten në udhëzimet e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), si edhe në udhëzimet e “G3ict”, Iniciativa Globale për TIK gjithëpërfshirës. Në këtë kontekst synohet rritja e ndërgjegjësimi në aksesueshmërisë dhe të marrë

²¹ Ministria e Kulturës duhet të marrë rol lider në futjen e pajisjeve audio/digitale dhe gjuhën e shenjave nëpër muze, ndërsa Biblioteka Kombëtare do të rrisë numrin e librave të disponueshëm në formate digjitale dhe alfabetin *Braille*. (Marrë nga PKVPAK-u.)



pjesë në nismën rajonale të ITU në bashkëpunim me Forumin Mobile Wireless (MWF) të cilët kanë krijuar bazën e të dhënave GARI (Global Accessibility Reporting Initiative), që synon të ofrojë qasje falas në bazën e të dhënave që mbart mjetet ekzistuese të TIK-ut me karakteristika të aksesueshme.

Qëllimi i përfshirjes së sigurimit të komunikimeve të telefonisë së lëvizshme të aksesueshme, në Planin e Veprimit, është të sigurojë një kornizë për të mbështetur zhvillimin e një kulture dhe praktike të zbatimit të aksesit të TIK-ut, përmes: i) përcaktimit të parimeve të përgjithshme të komunikimit celular të aksesueshëm; ii) identifikimit dhe mënjanimit të pengesave kryesore të identifikuar për komunikimet e telefonisë së lëvizshme të aksesueshme; iii) promovimit të ndërgjegjësimit për komunikimet e telefonisë lëvizëse të aksesueshme, mes personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuara; iv) identifikimit të standardeve përkatëse, bazuar në ato ndërkombëtare; v) promovimit të përdorimit të aparateve dhe pajisjeve të tjera celulare me karakteristika të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara; vi) marrjes së masave për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje të njëjtë, si ata pa aftësi të kufizuar, në rrjetet e lëvizshme, pajisjet, shërbimet, aplikacionet dhe përmbajtjen e ofruar për publikun në zonat urbane, periferike dhe rurale; vii) përcaktimit të një kornize institucionale për të siguruar monitorim transparent me qëllim forcimin e promovimit të mundësive të komunikimit celular të aksesueshëm.

Autoriteti (AKEP-i ka miratuar rregulloren nr. 49 (vendim nr. 2, datë 11.3.2021) “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike duke përcaktuar në një krye të veçantë masat që duhet të marrin operatorët krijimin, publikimin dhe respektimin e politikave dhe procedurave të qarta dhe efektive për trajtimin e drejtë dhe të duhur të pajtimtarëve që janë persona me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit përkatës të RSH-së, referuar ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” dhe në konsultim me shoqërinë civile. Rregullorja e miratuar nga AKEP-i (dhe zbatimi i

masave të mësipërme) hyn në fuqi në fillim të muajit tetor 2021.

Fokusi i aktiviteteve të parashikuara për të arritur këtë nënobjektiv do të jetë në përmirësime ligjore me qëllim përfshirjen në kuadrin ligjor rregullator të komunikimeve elektronike, sidomos për telefoninë e lëvizshme, të koncepteve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara dhe të aplikueshme, për: i) shërbimet e telefonisë së lëvizshme (zëri, aksesit në internet, brez i gjerë), përfshirë shërbimet e urgjencës; ii) kujdesin ndaj klientit, qendrat e mbështetjes së klientit, faqet e internetit dhe pikat e shitjes; iii) inkurajimin e ofrimit të pajisjeve fundore për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë telefonat bazë, telefonat me karakteristika, *smartphone*, tableta dhe aplikacione dhe shërbime ndihmëse.

Përmirësimet ligjore do të përfshijnë, gjithashtu, edhe krijimin e standardeve dhe rregulloreve, të cilat do të garantojnë aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, sidomos të rrjeteve celulare dhe shërbimeve të emergjencës.

Organizatat e personave me aftësi të kufizuara do të informohen në mënyrë periodike për produktet dhe shërbimet e aksesueshme të telefonisë së lëvizshme. Institucionet përgjegjëse do të marrin masa dhe do të ofrojnë ndërgjegjësimin e publikut se si personat me aftësi të kufizuara mund të përdorin shërbimet e urgjencës, të ofruara përmes telefonave celularë. Do të ketë masa edhe për rritjen e kapaciteteve të stafit të institucioneve qendrore dhe atyre rregullatore, ofruesve të shërbimeve, operatorëve mbi aftësinë e kufizuar, kodet etike, aksesueshmërinë. Aktivitetet synojnë, gjithashtu, edhe ofrimin e trajnimeve për organizatat e personave me aftësi të kufizuara mbi aksesueshmërinë e telefonisë së lëvizshme dhe përdorimin e saj nga kategori të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.

iii. Aksesueshmëria në faqet e internetit

Plani i Veprimit ofron një kornizë orientuese për të siguruar që të gjitha informacionet *online* të qeverisë, si edhe shërbimet (përfshirë faqet e internetit, aplikacionet në internet) të jenë të arritshme dhe të përdorshme nga personat me aftësi të kufizuara. Synimi i këtij nënobjektivi



është të sigurojë komunikim efektiv përmes internetit, për të mundësuar që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në informacion, në baza të barabarta me të tjerët.

Qëllimi i aksesueshmërisë në internet është heqja e barrierave ndaj personave me aftësi të kufizuara në përdorimin e faqeve të internetit. Individët që janë të verbër ose me shikim të reduktuar, kërkojnë që faqet e internetit të jenë të shoqëruara me lexues të ekranit, të cilët lexojnë tekstin me zë të lartë; ofrojnë tekste alternative për imazhet dhe përshkruajnë imazhet; lejojnë ndryshimin e madhësisë së tekstit, imazheve dhe faqosjet e faqeve dhe sigurojnë mjete alternative të lundrimit në internet. Personat që nuk dëgjojnë apo kanë vështirësi dëgjimi, do të kërkojnë titra për çdo përmbajtje, përfshirë edhe video, *media-player*, aplikacione. Personat me aftësi të kufizuara në lëvizje, mund të kërkojnë kohë shtesë për të lundruar.

Masat e parashikuara lidhen me përmirësimet e kuadrit ligjor duke përfshirë zhvillimin/adaptimin e standardeve të sigurimit të aksesueshmërisë në internet, për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses, në baza të barabarta me të tjerët, në faqet e internetit të sektorit publik, shërbimet, aplikacionet dhe përmbajtjen e tyre. Institucionet publike do të realizojnë raportime vjetore mbi zbatimin e realizimit të aksesueshmërisë në internet për personat me aftësi të kufizuara, sipas indikatorëve të përcaktuar nga AKSHI dhe MSHMS-ja.

iv. Aksesueshmëria e programacioneve televizive

Transmetimi televiziv përmendet specifikisht në nenin 30(1)(b) të KDPK-ut: “Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të marrin pjesë, njëloj si të tjerët, në jetën kulturore dhe duhet të marrin të gjitha masat që të sigurojnë se ato: a) gëzojnë akses në materiale kulturore në formate të aksesueshme; b) kanë akses në programet televizive, filmat, teatrot apo aktivitete të tjera kulturore, në formate të aksesueshme”. Aplikimi i nenit 30, nuk mbulon vetëm aspektin e ndërgjegjësimit për akses në transmetimet televizive, por edhe ofrimin e shërbimit.

Plani i Veprimtari synon të ofrojë një kornizë mundësuese për të mbështetur zhvillimin e një

kulture dhe praktike për transmetime televizive/programacione të aksesueshme, përmes: i) përcaktimit të parimeve, mbi të cilat do të zhvillohet aksesueshmëria e programeve video për personat me aftësi të kufizuara; ii) identifikimit të barrierave dhe adresimit të tyre përmes ligjeve, standardeve, mekanizmave financues; iii) marrjes së masave për zbatimin, me qëllim që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses, në baza të barabarta, në përmbajtjen e transmetimeve televizive, shërbimeve, pajisjeve, sistemeve dhe aplikacioneve, të ofruara për publikun, në platformat dhe teknologjinë, përmes të cilave ai ofrohet.

Aktivitetet për realizimin e këtij nënobjektivi do të fokusohen në hartimin, adaptimin apo rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, i cili mundëson aksesueshmërinë e televizionit dhe programeve të ofruara për personat me aftësi të kufizuara, qofshin këto ligje apo politika të veçanta, apo të integruara në ato ekzistuese (audio, subtitrimi, gjuha e shenjave). Përmes realizimit të aktiviteteve nën këtë objektivi, synohet të vendosen kërkesat minimale të cilësisë për përshkrimin audio (përshkrimin e titrave audio kur është e aplikueshme), titrat dhe gjuhën e shenjave. Po ashtu, orientohen institucionet përgjegjëse të vendosin kritere në lejet e licencave, kodet apo rregullore, kërkesa që orientojnë se si programet do të jenë të shoqëruara me shërbimet e aksesueshmërisë; si personat me aftësi të kufizuara do të informohen mbi programacionet e aksesueshme për to; si do të sigurohet që guidat e programeve janë të aksesueshme për personat me dëmtime sensore, përfshirë ato që nuk shikojnë apo me shikim të reduktuar

Aksesueshmëria e transmetimeve televizive do të realizohet përmes masave që do të merren, që ofruesit e licencuar të shërbimeve të ofrojnë subtitrat, gjuhën e shenjave dhe versionet audio në programe specifike. Kjo do të kërkojë rregullime të ligjeve, standardeve, kushteve në kontrata, kodeve të praktikave të mira etj. Ato, së bashku me ofruesit e televizioneve dhe me organizatat e aftësisë së kufizuar, do të vendosin mbi programet, të cilat do të jenë të aksesueshme, si p.sh.: lajmet, situatat e emergjencës, transmetimet drejtpërsëdrejti etj.



Televizionet publike kanë përgjegjësi të bëjnë të aksesueshme më shumë programe se ato private.

Autoritetet rregullatore do të miratojnë standarde, bazuar në ato ndërkombëtare, standarde të cilat, do të sigurojnë bashkërendimin mes shërbimeve televizive dhe pajisjeve që u mundësojnë përdoruesve me aftësi të kufizuara marrjen, dekodimin, shfaqjen e shërbimeve të aksesueshme. Një rëndësi të veçantë ka ofrimi i informacioneve të aksesueshme gjatë situatave të emergjencave dhe fatkeqësive natyrore.

Qëllimi i politikës 2. Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara

Barazia përpara ligjit dhe sigurimi i një qasjeje efektive në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara, paraqiten në një kapitull të veçantë të PVKPAK 2021–2025, duke iu referuar kështu nenet 12 dhe 13 të KDPAK-ut. Personat me aftësi të kufizuara shpesh herë përballen me vështirësi të shumta për të pasur akses të barabartë me të tjerët në sistemin e drejtësisë, gjë e cila vjen si pasojë e shumë faktorëve, siç janë: barrierat në infrastrukturë, pamundësia për të marrë informacionin e duhur, pamundësia financiare për pagesat që kërkojnë etj.

Qëllimi kryesor i politikës në fushën e barazisë, bazohet në progresin që Shqipëria duhet të bëjë për të realizuar parimin respektiv të KDPAK-ut e për pasojë eliminimin e barrierave të ndryshme për të pasur akses të barabartë në sistemin e drejtësisë. Lidhur me zbatimin e kërkesave të KDPAK-ut në fushën e njohjes së barabartë përpara ligjit dhe mundësitë të

sistemit të drejtësisë nga personat me aftësi të kufizuara në kushte të barabarta me të tjerët, Komiteti i OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara ka rekomanduar që shteti shqiptar, duhet: i) të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në ndihmë juridike falas, duke pasur në vëmendje ata që ende jetojnë në institucione; ii) të sigurojë pa diskriminim mundësinë e përdorimit të teknologjive ndihmëse dhe përkthyesve të certifikuar dhe të kualifikuar të gjuhës së shenjave dhe ofrimin e *Braille*, *Easy Read*, gjuhën e shenjave dhe formate të tjera alternative, në procese gjyqësore dhe shërbime noteriale; iii) të forcojë përpjekjet për të ofruar trajnime dhe programe për ndërtimin e kapaciteteve për Konventën të personelit gjyqësor, zbatuesve të ligjit dhe noterëve në zbatim të qasjes për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; iv) të rishikojë legjislacionin për të përfshirë ndalimin e qartë të diskriminimit me bazë aftësinë e kufizuar që përfshin specifikisht të gjitha format e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, përfshi diskriminimin e shumëfishtë dhe të ndërthurur.

Duke qenë politikë e lidhur ngushtësisht me realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht në barazinë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, ajo kontribuon dhe lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kapitullin 23 të negociatave me BE-në sipas MSA-së.

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në 3 objektiva specifikë:

Objektivi specifik 1	Rritja e numrit të individëve me aftësi të kufizuara që përdorin shërbimet e ndihmës juridike falas
Objektivi specifik 2	Njohja e barabartë para ligjit i personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht i personave me aftësi të kufizuara mendore
Objektivi specifik 3	Garantimi i respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në institucionet e dënimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare

Objektivi specifik 1. Rritja e numrit të individëve me aftësi të kufizuara që përdorin shërbimet e ndihmës juridike falas

Në kuadër të reformës së përgjithshme të sistemit të drejtësisë në vitin 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili

përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshme të tij. Ligji synon të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas që do të sigurojë akses të barabartë në



drejtësi të të gjithë individëve, duke cilësuar personat me aftësi të kufizuara të të gjitha kategorive si një nga grupet më në nevojë përfituese të këtij shërbimi. Specifikisht neni 11 “Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike”, pikat “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” përfshijnë të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar.

Ministria e Drejtësisë po punon për hartimin e politikave të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat do të jenë të mishëruara në një strategji të re 5-vjeçare dedikuar ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e aksesit në drejtësi për grupet vulnerabël, ku personat me aftësi të kufizuara zënë një vend të veçantë.

Masat e parashikuara për arritjen e këtij objektivit fokusohen në radhë të parë te mundësia e ofrimit të këtij shërbimi në formate të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, si: hartimi i formularëve të aplikimit për NJF të aksesueshëm për personat e verbër (gjuha *Braille*), ofrimi i shërbimit të NJF-së në gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë, mundësia e ofrimit të shërbimit lëvizës të NJF-së në rastet kur personi e ka të pamundur lëvizjen jashtë kushteve të banesës. Një masë paraprake në këtë kontekst është ridizenjimi i faqes së internetit të DNJF-së, me qëllim që të jetë e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Masat institucionale janë, gjithashtu, të rëndësishme ku mund të përmendim: ngritja e qendrave rajonale të ndihmës juridike parësore në të gjitha rajonet e vendit, ngritja e klinikave të ligjit si institucione ofruese të parashikuara nga ligji për shërbime të ndihmës juridike falas, si dhe ngritja e kapaciteteve të punonjësve të qendrave të NJF-së që e ofrojnë drejtpërdrejt shërbimin e ndihmës juridike parësore falas, i studentëve të klinikave të ligjit dhe juristëve të OJF-ve të autorizuar nga MD-ja për ofrimin e NJPF-së dhe i avokatëve që japin ndihmën juridike dytësore, lidhur me trajtimin bashkëkohor të çështjeve të aftësisë së kufizuar sipas modelit që sjell KDPK-u.

Nën përgjegjësinë e DNJF-së, në bashkëpunim me MSHMS-në, do të ketë edhe aktivitete që lidhen me fushatat e komunikimit për personat me aftësi të kufizuara. Në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, struktura përgjegjëse e ndihmës juridike ka parashikuar në

planin e punës organizimin e një takimi me organizata që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, kjo drejtori po përgatit kurrikulat e trajnimit, ku një ndër pikat është dhe trajnimi i anëtarëve të personelit që punojnë me personat me aftësi të kufizuar. Krahas këtyre masave, organizatat përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara duhet të ndërmarrin aktivitete informimi dhe ndërgjegjësimi për grupet që ata përfaqësojnë lidhur me legjislacionin dhe procedurat e reja për përfitimin e shërbimit të NJF-së.

Objektivi specifik 2. Njohja e barabartë para ligjit i personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht i personave me aftësi të kufizuara mendore

Për personat me aftësi të kufizuara në sistemin e drejtësisë kërkohen ndryshime në legjislacion për të mundësuar ushtrimin e lirive dhe zgjedhjeve individuale. Është e rëndësishme të krijohet një mekanizëm ligjor për të mbështetur vendimmarrjen²², ndërkohë që mbizotëron kujdestaria ligjore. Kjo çështje është e rëndësishme si për aksesin në drejtësi, ashtu edhe për fusha të tjera të Planit të Veprimit. Administrimi i pasurisë nga një kujdestar u mohon personave me aftësi të kufizuara të drejtën për të menaxhuar pasuritë e tyre financiare dhe të drejtën e posedimit të pasurisë. Sipas nenit 33, të Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të paraqiten padi ligjore nga një person të cilit i mungon zotësia për të vepruar. Në të njëjtën kohë, në procedurat për të hequr zotësinë

²² Neni 7 i ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara e përcakton atë si: “ushtrim i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara përmes një kompetence specifike të shtuar që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundësuar atij të kryejë veprime për të fituar të drejtave dhe për të marrë përsipër detyrime”. I njëjti nen, gjithashtu, shpjegon se: “Çdo person me aftësi të kufizuara që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje do të marrë mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, duke përfshirë mbështetjen përmes interpretimit në gjuhën e shenjave dhe gjuhë të thjeshtuar, si dhe duke ndihmuar personin me aftësi të kufizuara në marrëdhëniet me të tretët, të cilët nuk janë në gjendje të kuptojnë mënyrën e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht, duke i dhënë kohën e mjaftueshme personave që e kërkojnë atë për të mësuar se si të përdorin mbështetjen për interesin e tyre më të mirë.”.



e një personi për të vepruar, personi në fjalë nuk ka të drejtë të jetë palë²³.

Kodi Civil përmban dispozita ligjore, të cilat bien ndesh me parimin e zotësisë për të vepruar dhe i referohet koncepteve të “prapambetjes mendore”, “çrregullimeve të shëndetit mendor” dhe “çrregullimeve psikike”, ndërsa Kodi i Familjes parashikon emërimin e një kujdestari në rastet e heqjes/kufizimit të zotësisë për të vepruar. Kodi i Procedurës Penale parashikon përkthimin për njerëzit që nuk e kuptojnë gjuhën shqipe, por nuk trajton të drejtën për interpretim në gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë.

Siç argumentohet në konkluzionet përmbyllëse të Komitetit të OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, legjislacioni shqiptar lidhur me zotësinë juridike për të vepruar, vazhdon të mbetet i vjetruar dhe duhet domosdoshmërisht të fillojnë përpjekjet për ta sjellë atë në përputhje me këndvështrimin e KDDPAK-ut. Konkretisht ky Komitet rekomandon që shteti shqiptar, duhet: “Të harmonizojë legjislacionin në përputhje me Konventën, të shfuqizojë të gjitha ligjet që kufizojnë zotësinë juridike të personave me aftësi të kufizuara, në veçanti të personave me aftësi të kufizuara psikosociale ose intelektuale, duke zëvendësuar mënyrën e vendimmarrjes së zëvendësuar me vendimmarrje të mbështetur që respektojnë autonominë, vullnetin dhe preferencat e personit.”.

Për të arritur të ndërhyrjet për përmirësime dhe ndryshime në Kodin Civil, Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Familjes, me qëllim njohjen e zotësisë ligjore të personave me aftësi të kufizuara, proces që kërkon ndërgjegjësim, njohuri dhe dakordësim të disa institucioneve, Plani parashikon të kryejë aktivitete për ndërgjegjësimin e institucioneve përkatëse nëpërmjet trajnimeve të punonjësve lidhur me zotësinë ligjore për të vepruar të përcaktuar nga KDDPAK-u, si dhe kryerjen e vlerësimeve për situatën e personave me aftësi të kufizuara në lidhje me zotësinë ligjore për të vepruar.

Objektivi specifik 3. Garantimi i respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në institucionet e dënimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare

Personat me probleme të shëndetit mendor janë një kategori që paraqet vështirësi për t'u trajtuar në mënyrë adekuate në sistemin e burgjeve, për shkak të kufizimit të lirisë, infrastrukturës së kufizuar të burgjeve për të ofruar një shërbim të përshtatshëm për situatën e tyre shëndetësore, numrit të vogël të mjekëve psikiatër në sistem, infrastrukturës në burgje, mungesës së hapësirave të përshtatshme për ofrimin e shërbimit psikologjik dhe terapeutik dhe të vetë profesionistëve si psikolog dhe/apo punonjës socialë. Gjithashtu, për sistemin e burgjeve është sfidë trajtimi i kategorisë së shtetasve me masë mjekësore “mjekim i detyruar” apo “shtrim i përkohshëm”.

Në zbatim të këtij objekti, institucionet përkatëse do të sigurojnë ambiente dhe shërbime të reja për personat me aftësi të kufizuara që janë në (para)burgim, duke përfshirë ambiente të specializuara për trajtimin shëndetësor mendor të urdhëruar nga gjykata. Duke qenë se edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka ngritur shqetësime në lidhje me kushtet e personave me aftësi të kufizuara në institucionet e vuajtjes së dënimit, MD-ja dhe MSHMS-ja janë duke vlerësuar alternativat e mundshme për zhvendosjen e të burgosurve nga Burgu i Zaharisë Krujë, në ambiente më të përshtatshme për këtë kategori. Këtë vit pritet të zhvendosen shtetasit që vuajnë dënimin me masë mjekësore në ambientet e rikonstruktura të IEVP Lezhë. Ndërkohë vazhdon të mbetet një sfidë e madhe mungesa e mjekëve psikiatër. Në PBA 2021–2023 është parashikuar një rritje e ndjeshme e pagave të mjekëve të stafit shëndetësor në burgje, në mënyrë që të mund të rritet interesi i mjekëve psikiatër për punësim në sistemin e burgjeve. Për të mundësuar aplikimin e modelit të ri të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara sipas KDDPAK-ut edhe në institucionet e vuajtjes së dënimit, mjekët psikiatër, që shërbejnë në këto institucione, do të mbështeten edhe me një psikolog.

Qëllimi i politikës 3. Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe nxitja e mundësive të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara

Në qendër të integritetit të personave me aftësi të kufizuara qëndron aftësimi dhe punësimi i tyre, duke i dhënë një rëndësi të veçantë kësaj fushe të Planit. Një nen i veçantë i KDDPAK-ut përcakton njohjen dhe respektimin e “së drejtës së personave me aftësi të kufizuara për të punuar, në baza të

²³ Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, *Drejt drejtësisë: analiza e procedurave civile në gjykatat e rrethëve*, <http://www.osce.org/albania/100388>, f. 13.



barabarta me të tjerët”, duke “ndaluar diskriminimin me bazë aftësinë e kufizuar në të gjitha çështjet lidhur me punësimin”. Kuadri ligjor në Republikën e Shqipërisë garanton aksesin në punësim të personave me aftësi të kufizuara, ndalon çdo formë diskriminimi në fushën e punësimit dhe profesionit dhe mundëson pjesëmarrjen në tregun e punës përmes programeve specifike për nxitjen e punësimit dhe formimit.

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, që është faktor kyç për përfshirjen sociale, është në të njëjtën kohë edhe një çështje shumë komplekse që lidhet me shumë faktorë siç janë: arsimimi, aftësimi për punë, diskriminimi, aksesueshmëria dhe përshtatja e vendit të punës që krijojnë barrierë në punësim. Hartimi i politikave specifike mbështetëse për punësim dhe formim profesional synohet nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit të politikave të gjithëpërfshirjes.

Lidhur me një përfshirje më të madhe të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës, Komiteti i OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara ka rekomanduar që shteti shqiptar duhet: “i) të promovojë më shumë punësimin në tregun e hapur të punës në sektorin publik dhe privat, me theks të veçantë për gratë, në konsultim të ngushtë me personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese,

përfshirë organizatat e grave; ii) të mbledhë të dhëna statistikore të ndara për shkallën e punësimit dhe gjendjen e personave me aftësi të kufizuara, të ndara sipas gjinisë, moshës, llojit të punësimit dhe pagës, dhe për ndikimin e ligjit nr. 15/2019.”.

Promovimi i punësimit të personave me aftësi të kufizuara, nëpërmjet modeleve pozitive dhe historive të suksesit, duhet të vazhdojë si një praktikë e efektshme jo vetëm për të mënjauar elementet e diskriminimit në ambientet e punës, por edhe për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit të aftësive. Në këtë kontekst, bashkëpunimi me punëdhënësit, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat e ndryshme është një parakusht i domosdoshëm.

Duke qenë politikë e lidhur ngushtësisht me realizimin e së drejtës për punësim të personave me aftësi të kufizuara, por edhe atë të aftësimin të tyre dhe nxitjes për punësim, ajo kontribuon dhe lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kapitullin 23 “Të drejtat dhe liritë themelore” dhe kapitullin 19 “Punësimi dhe çështjet sociale të negociatave me BE-në sipas MSA-së”.

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore, që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucionet publike dhe private dhe organizatat e tjera, do të fokusohen në 3 objektiva specifike:

Objektivi specifik 1	Rritja e cilësisë në shërbimet e aftësimin për të nxitur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës
Objektivi specifik 2	Rritja e mundësive për punësim dhe vetëpunësim për personat me aftësi të kufizuara
Objektivi specifik 3	Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve që synojnë nxitjen e integritetit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

Objektivi specifik 1. Rritja e cilësisë në shërbimet e aftësimin për të nxitur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

Një nga elementet kryesore, që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e punësueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara, është aftësimi i tyre nëpërmjet ndjekjes së kurseve profesionale. Politika e ofrimit të këtyre kurseve pa pagesë, në qendrat e formimit profesional në të gjitha rajonet e vendit, ndihmon në rritjen e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara. Duke synuar zgjerimin e llojshmërisë së profesioneve të mundësuar për PAK-un, Plani parashikon jo vetëm zgjerimin e gamës së kurseve

të AFP-së, të unifikuara apo të veçanta, por edhe përfshirjen e tyre në kurset e gjuhës së huaj (anglisht) dhe atë të mësimin të bazave në përdorimin e kompjuterit, duke u përjashtuar nga tarifat e pagesës së këtyre kurseve sipas legjislacionit në fuqi.

Aktivitete të rëndësishme, që do të ndihmojnë në rritjen e numrit të personave me aftësi të kufizuara, që regjistrohen në kurset e formimit profesional, janë ato që kanë lidhje me rritjen e aksesueshmërisë, si p.sh.: shoqërimi i kurrikulave ekzistuese dhe atyre të reja me programe të përshtatura për të akomoduar nevojat e të gjitha kategorive të aftësisë së kufizuar, hapjen e kurseve



të reja, siç është formimi profesional për interpretët e gjuhës së shenjave. Këto do të shoqërohen edhe me trajnim të mësuesve dhe instruktorëve të AFP-së për të punuar me personat me aftësi të kufizuara, si edhe me promovimin e rasteve pozitive të punësimit pas përfundimit të arsimit profesional apo kurseve të formimit nga personat me aftësi të kufizuara, si modele pozitive në fushën e aftësimit profesional.

Objektivi specifik 2. Rritja e mundësive për punësim dhe vetëpunësim për personat me aftësi të kufizuara

Përmirësimi i legjislacionit të punësimit përmban ndryshime thelbësore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke sjellë programe dhe masa të reja për të nxitur punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Ligji nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” krijon, gjithashtu, Fondin Social të Punësimit (FSP) të dedikuar për aftësinë e kufizuar, i cili shërben për të siguruar nxitjen e punësimit, integrimin dhe përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara. Ky fond përdoret për financimin e projekteve që synojnë punësimin; vetëpunësimin; rehabilitim për punë; aftësimin dhe riaftësimin profesional; orientimin dhe këshillimin për punësim; shërbime mbështetëse; përshtatjen e vendit të punës për persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse²⁴; programe riintegrimi social dhe mbështetjen për nxitjen e punësimit të familjarëve të personave me aftësi të kufizuara.

Miratimi i aktit nënligjor që e bën FSP-në funksionale, është parashikuar të kryhet në vitin e parë të zbatimit të PVPK 2021–2025. Gjithashtu, parashikohet miratimi i paketës së këshillimit dhe mentorimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve me aftësi të kufizuara, si paketë në kuadër të zbatimit të FSP-së. Nëpërmjet funksionimit të FSP-së dhe rritjes së mbështetjes për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në programet e reja të nxitjes së punësimit, synohet që çdo vit të rritet me 20% numri i personave me aftësi të kufizuara përfitues nga PNP-ja.

Një nga masat kryesore për arritjen e objektivit ka të bëjë me rritjen e aksesueshmërisë në vendin e punës nëpërmjet financimit e punëdhënësve për të kryer përshtatjen e vendit të punës në rastet e kërkuara. Duke marrë në konsideratë faktin që

numri i personave me aftësi të kufizuara me arsim të lartë që paraqiten në Zyrës së Punës si punëkërkues të papunë është rritur, Plani parashikon rritjen e bashkëpunimit të AKPA-së me universitetet për të informuar studentët me AK për programet e praktikave profesionale, por edhe me punëdhënësit për promovimin e punësimit të studentëve me aftësi të kufizuara që mbarojnë arsimin e lartë në institucionet arsimore publik dhe private.

Rritja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara gjatë zbatimit të Planit do të mbështetet edhe nga zbatimi i ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka synon të rregullojë veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale, me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël. Personat me aftësi të kufizuara janë nga grupet kryesore përfituese të këtij ligji, si në drejtim të nxitjes së punësimit, ashtu edhe në drejtim të përfitimit të shërbimeve sociale apo të punësimit të mbështetur në përputhje me nevojat e tyre.

Objektivi specifik 3. Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve që synojnë nxitjen e integritet të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

Ristrukturimi i institucionit qendror AKPA, përgjegjës për zbatimin e politikave të punësimit, përcakton edhe masat e duhura që do të ndërmerren në PKVPAK për arritjen e objektivit. Përveç hartimit të kurrikulave të reja për të ofruar trajnime në “Aftësi bazë”, të cilat tashmë kanë filluar të aplikohen në QFPP, në veçanti për personat me aftësi të kufizuara, do të merren masa për hartimin dhe miratimin e udhëzuesve mbi manualët e ofrimit të shërbimeve për punëkërkuesin dhe punëdhënësin. Në këtë proces do t’i jepet përparësi vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara lidhur me profilizimin dhe punësueshmërinë. Është parashikuar rishikimi i kriterëve vlerësues në sistemin e menaxhimit të performancës dhe sigurimit të cilësisë së AKPA-së për realizimin dhe raportimin e synimeve të vendosura për rritjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Masa të lidhura me ndërgjegjësimin dhe informimin e punëdhënësve dhe punëmarrësve me aftësi të kufizuara kanë të bëjnë me detyrimin e punëdhënësve për kontribute në kuadër të FSP-së, krijimin e paketave informuese në lidhje me kuotat për punësimin e personave me aftësi të kufizuara

²⁴ Ligji nr. 15/2019, neni 21, pika 5.



dhe realizimin e fushatave të ndërgjegjësimin për afrimin pranë zyrave të punësimit të punëkërkuarve PAK.

Në rritjen e efektivitetit të shërbimeve të punësimit ndikon identifikimi i situatës reale të punësimit të personave me aftësi të kufizuara në nivel kombëtar. AKPA-ja do të ndërhyjë në përmirësimin dhe zgjerimin e bazës së të dhënave statistikore të AKPA-së, për të grumbulluar informacion specifik për personat me aftësi të kufizuara si punëkërkuar të papunë në përpunje me të dhënat e marra nga Regjistri Elektronik i Aftësisë së Kufizuar. Bashkëpunimi me Inspektoratin Shtetëror të Punës është një faktor kyç në zbatimin e legjislacionit për Fondin Social të Punësimit (FSP).

Qëllimi i politikës 4. Sigurimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe i të mësuarit gjatë gjithë jetës për personat me aftësi të kufizuara

Arsimimi për personat me aftësi të kufizuara është prioritet në kontekstin e përfshirjes sociale. Neni 24 i KDPAK-ut për edukimin përcakton, se: “që të realizohet e drejta për edukim për personat me aftësi të kufizuara, pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, shtetet Palë duhet të sigurojnë një sistem edukimi përfshirës në të gjitha nivelet, dhe të mësuar gjatë gjithë jetës”. Kushtetuta dhe legjislacioni kombëtar në Republikën e Shqipërisë garantojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve, në veçanti personat me aftësi të kufizuara në fushën e arsimit.

Lidhur me realizimin e të drejtës për të pasur akses në arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara, Komiteti i OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara ka rekomanduar që shteti shqiptar, duhet: “i) të amendojë ligjet për të njohur arsimin gjithëpërfshirës, si e drejtë dhe për t’u dhënë të gjithë studentëve me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga karakteristikat e tyre individuale, të drejtën për të aksesuar mundësi të nxëni gjithëpërfshirëse në sistemin arsimor tradicional me mbështetje të individualizuar, sipas

kërkesave; ii) të sigurojë mundësinë e përdorimit të mjediseve shkollore në përpunje me Konventën, përmes sigurimit të masave specifike, të tilla si: materiale të aksesueshme dhe të përshtatura dhe kurrikula gjithëpërfshirëse, duke siguruar mbështetje dhe përshtatje të individualizuar; iii) të përfshijë trajnime për arsimin gjithëpërfshirës në programet universitare për mësuesit e ardhshëm dhe programe trajnimi të detyrueshëm për personelin mësimor aktual, me një buxhet të përshtatshëm; iv) të përmirësojë mbledhjen e të dhënave për zbatimin e ligjeve dhe politikave për arsimin gjithëpërfshirës dhe aksesueshmërinë e infrastrukturës shkollore, informacionit dhe komunikimit, përfshirë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, për të informuar politika të arsimit gjithëpërfshirës.”.

MASR-ja dhe institucionet e varësisë informojnë dhe ndërgjegjësojnë në mënyrë të vazhdueshme nxënësit dhe prindërit në lidhje me të drejtat e barabarta të fëmijëve me aftësi të kufizuara për t’u arsimuar në sistemin e përgjithshëm. Ligji për arsimin parauniversitar përcakton parime dhe promovon konceptin e arsimit gjithëpërfshirës, duke theksuar se përfshirja në institucione arsimore të specializuara është e përkohshme dhe se përparësi ka përfshirja në kopshte dhe në shkolla të përgjithshme. Qeveria është e angazhuar të sigurojë arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët, duke krijuar kushte të përshtatshme, siç janë: sigurimi i aksesueshmërisë në mjediset e shkollave, materialeve didaktike që përdorin nxënësit e mbulimi i plotë me mësuesndihmës të kualifikuar për trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kjo kërkon domosdoshmërisht forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të ndërhyrjeve të pushtetit lokal me atë qendror.

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet edhe me institucione dhe organizata të shoqërisë civile do të fokusohen në dy objektiva specifike

Objektivi specifik 1	Rritja e mundësive për pjesëmarrje në arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me lloje të ndryshme të AK-së
Objektivi specifik 2	Shndërrimi i shkollave të specializuara në qendra burimore, duke përfshirë dhe mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës



Objektivi specifik 1. Rritja e mundësive për pjesëmarrje në arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me lloje të ndryshme të AK-së

Duke konsideruar kategoritë e ndryshme të aftësisë së kufizuar dhe për të realizuar gjithëpërfshirjen një rol të rëndësishëm luajnë komisionet multidisiplinore. Komisionet multidisiplinore të vlerësimit të nevojave arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara, bazuar në vlerësimin e fëmijës dhe nevojave, udhëzojnë planin edukativ individual (PEI) të fëmijës me aftësi të kufizuara. Mësuesit ndihmës ndjekin dhe zbatojnë planin. Fuqizimi i rolit të komisioneve multidisiplinore është parakusht për realizimin e gjithëpërfshirjes, duke filluar që nga trajnimet e anëtarëve të komisioneve dhe mësuesve ndihmës. Bashkëpunimi me komisionet e reja të vlerësimit të AK-së, sipas modelit të gjithëpërfshirjes dhe monitorimi i rregullt i ecures së fëmijës në procesin arsimor, është i rëndësishëm për zbatimin e planit edukativ individual. Gjithashtu, është përparësi vlerësimi i nevojave për materiale didaktike dhe planifikimi i buxheteve për sigurimin e tyre sipas kërkesave specifike të kategorive të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Njësitë e qeverisjes vendore në bashkëpunim me ministrinë dhe donatorët (BE-ja, OKB-ja etj.) kanë përmirësuar infrastrukturën në shkolla për t'i kthyer ato në mjedise të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Masat që do të merren në këtë drejtim dhe zbatimi i legjislationit për aksesueshmërinë, duhet të jenë në fokus të ndërgjegjësimit të institucioneve për të evidentuar situatën në institucionet arsimore.

Objektivi specifik 2. Shndërrimi i shkollave të specializuara në qendra burimore, duke përfshirë dhe mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës

Në kuadër të qasjes për arsimin gjithëpërfshirës që KDPAK-u rekomandon për të gjitha shtetet palë, Komiteti është shprehur se shteti shqiptar duhet t'i kushtojë një rëndësi të veçantë formulimit, vendosjes dhe zbatimit të objektivave specifikë për promovimin e një kulture të përfshirjes në arsimin tradicional, vlerësime të individualizuara të kërkesave arsimore në kontekstin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Komiteti i KDPAK-ut parashtron se duhet përshtatje e nevojshme, udhëzime dhe mbështetje për mësuesit për sa i përket respektimit të diversitetit, garantimin e të drejtave të barazisë dhe mosdiskriminimit. Për

zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse në arsim qasjeje dhe rekomandimit të Komitetit të KDPAK-ut është vendosur objektivi për shndërrimin e 9 shkollave speciale publike që ekzistojnë në nivel kombëtar në qendra burimore.

Në zbatimin e objektivit parashikohen masa me karakter ligjor dhe institucional, ngritja e kapaciteteve, ndërgjegjësimi dhe planifikimi i buxheteve përkatëse në mënyrë progresive për kohëzgjatjen e zbatimit të PKVPAK-ut. Procesi i shndërrimit të shkollave speciale në qendra burimore, bazuar në praktika të mira ndërkombëtare, do të ndiqet e monitorohet nga një grup pune i posaçëm, i cili do të hartojë edhe metodologjinë e funksionimit të qendrave burimore. Kjo do të shoqërohet me infrastrukturë për mësimdhënien, materiale didaktike në qendrat burimore, përgatitjes së botimeve për specialistët dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe trajnimit të mësuesve të zakonshëm dhe atyre ndihmës. Objektivi për qendrat burimore synon mundësinë për të mësuarit gjatë gjithë jetës për personat me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i politikës 5. Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitimeve të aksesueshme, të përballueshme financiarisht dhe që kanë në qendër klientin

Politikat e kujdesit social kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet: balancimit dhe përputhjes së pagesave që përfitojnë për shkak të aftësisë së kufizuar me nevojat jetike e përkujdesjen sociale; rritjes së aksesit dhe cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara që duhet të kenë në qendër klientin; si dhe kombinimit të pagesave *cash* me shërbime sociale cilësore.

Gjatë 5 viteve të kaluara, fusha e politikave të kujdesit social mbartti në vetvete edhe shumë sfida të lidhura me kalimin e vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar, kontekstin e deinstitutionalizimit, ofrimin e tipologjive të ndryshme të shërbimeve sociale cilësore në komunitet duke përmendur jetesën e pavarur si një nga shërbimet më të reja, por edhe shërbime të tjera që kontribuojnë në përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara.

MSHMS-ja punoi në drejtim të një reforme të shërbimeve shoqërore për ngritjen e shërbimeve të integruara në nivel qendror dhe lokal. Sipas ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në



Republikën e Shqipërisë”, sistemi i menaxhimit dhe referimit për shërbimet sociale për personat me aftësi të kufizuara, garanton të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të përfituar shërbime sociale.

Lidhur me reformën e shërbimeve shoqërore dhe legjislacionin, do të kryhet ndërgjegjësimi i njësive vendore për Fondin Social, zbatimi i metodologjisë për fondet dhe përdorimin e tyre në ngritjen e shërbimeve të reja, duke marrë në konsideratë se nuk janë ngritur NJVRN-të të cilat duhet të dizajnojnë paraprakisht hartën e nevojave për shërbime shoqërore.

Një çështje tjetër që paraqet sfidë, është bashkëpunimi i institucioneve publike me OJF-të apo institucionet private sipas legjislacionit kur shërbimet duhet të kontrahohen nga organizatat jofitimprurëse apo ofrues të tjerë të shërbimeve. Kjo do të lehtësonte procesin dhe do të lejonte fleksibilitet më të madh në ofrimin e shërbimit. Në analizën e situatës së tipologjisë së shërbimeve drejt kategorive të ndryshme duhet të konsiderohen me përparësi personat me aftësi të kufizuara.

Për zbatimin, institucionet shtetërore qendrore dhe vendore në partneritet edhe me institucione dhe organizata të shoqërisë civile do të fokusohen në 3 objektiva specifike:

Objektivi specifik 1	Monitorimi i efekteve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga komisionet e reja, sipas modelit të të drejtave të njeriut që përcakton KDDPAK-un
Objektivi specifik 2	Ofrimi i shërbimeve të integruara sociale me anë të kombinimit të pagesave me para në dorë (<i>cash</i>) me kujdesin social cilësor
Objektivi specifik 3	Promovimi dhe nxitja e jetesës së pavarur nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve sociale komunitare

Objektivi specifik 1. Monitorimi i efekteve të vlerësimit të ri të aftësisë së kufizuar, sipas modelit të të drejtave të njeriut që përcakton KDDPAK-un

Në kushtet kur zbatimi i reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar po pilotohet në zonën e Tiranës, për t’u shtrirë në të gjithë vendin, është e domosdoshme që ky proces të shoqërohet nga një monitorim i vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës së pilotimit. Për këtë arsye është miratuar udhëzimi nr. 667, datë 1.10.2019, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për metodologjinë e kontrollit të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar”, i cili po zbatohet. Procesi i pilotimit do të shoqërohet me një analizë vlerësuese të efekteve të aplikimit të vlerësimit të AK-së sipas modelit biopsikosocial në rajonin e Tiranës, dhe impaktin e tij në jetesën e personave me aftësi të kufizuara dhe prezantimi i rezultateve në Këshillin Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar.

Në kuadrin e progresit të Shqipërisë në zbatimin e KDDPAK-ut, Komiteti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara rekomandon “rishikimin e dispozitave të ndihmës financiare për aftësinë e kufizuar, në mënyrë që të shfuqizohen praktikrat diskriminuese”. Për këtë qëllim dhe si pjesë e përpjekjeve për mirëmenaxhimin e fondeve publike dhe për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të skemës, po bëhet ristrukturimi i disa pagesave,

përfitimeve dhe shërbimeve të aftësisë së kufizuar në përputhje me nevojat e përfituesve. Ky ristrukturim përfshin: a) ristrukturimin e pagesës me para në dorë (*cash*); b) ristrukturimin e pagesës së ndihmës personale; dhe c) kthimin e pagesave *cash* në pagesa në natyrë (shërbime).

Aplikimi i vlerësimit të ri të AK-së kërkon që masat për trajnim të punonjësve në të gjitha institucionet ku ofrohen shërbime për personat me aftësi të kufizuara të vijojnë edhe në vitet në vazhdim. Duke qenë se vlerësimi i ri i AK-së, ka përfshirë edhe personat që nuk dëgjojnë, parashikohet ofrimi i shërbimit me interpret të gjuhës së shenjave gjatë komisionimit.

Organizimi i takimeve konsultuese me grupet e interesit dhe shoqatat përfaqësuese për/të PAK do të ndikojë në përmirësimin e vazhdueshëm të punës së komisioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar (KVAK) në kuadër të monitorimit nga MSHMS-ja.

*Objektivi specifik 2. Ofrimi i shërbimeve të integruara sociale me anë të kombinimit të pagesave me para në dorë (*cash*) me kujdesin social cilësor*

Reforma e shërbimeve shoqërore është aktualisht në zbatim dhe përgjegjësitë e ofrimit të shërbimeve janë kryesisht nën përgjegjësinë e njësive vendore. Bashkëpunimi ndërmjet MSHMS-së, SHSSH-ja dhe bashkive duhet të konkretizohet



me masa nga bashkitë. Planet sociale duhet të përmbajnë evidentimin e nevojave për tipologjinë e shërbimeve sociale posaçërisht personat me aftësi të kufizuara. Masat e parashikuara të Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2019–2022, për ngritjen e kapaciteteve vendore të NJVRN-ve, me qëllim që ato të aplikojnë e thithin buxhete nga Fondi Social, do të kontribuojnë, gjithashtu, në realizimin e objektivit.

Institucionet qendrore, të cilat kanë edhe rolin monitorues të ofrimit të shërbimeve shoqërore për personat me aftësi të kufizuara, duhet të analizojnë të dhënat e nevojave për shërbime, në krahasim me të dhënat e vlerësimeve të kryera për individët me aftësi të kufizuara nga komisioni përkatës. Këto duhet të përqasen me vlerësimin e nevojave për shërbime për nivel vendor. Kombinimi i pagesës *cash* me ofrimin e shërbimit të duhur është në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve për PAK-un, të përshtatura me analizën e nevojave të identifikuar.

Masa të rëndësishme në arritjen e këtij objekti, duke pasur në vëmendje nevojat specifike që kanë kategori të ndryshme të AK-së, janë: analiza dhe rishikimi i legjislacionit lidhur me përfitimin e mjeteve higjieno-sanitare në përputhje me vlerësimin e kryer rast pas rasti nga KVAK-u. Një shërbim i munguar në Shqipëri është ai i shoqërimit të personave të verbër nga qentë ndihmës, shërbim i cili prej vitesh aplikohet në shumë vende të botës. Për të kuptuar se si mund të ngrihet një sistem që ofron një shërbim të tillë është parashikuar kryerja e një studimi fizibiliteti lidhur me mundësinë e ngritjes së një sistemi të shoqërimit të personave të verbër nga qentë ndihmës, duke u bazuar te praktikat e ngjashme në vendet e tjera.

Objekti i specifik 3. Promovimi dhe nxitja e jetesës së pavarur nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve sociale komunitare

Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet konsiderohet nga KDPAK-u, neni 19, si një parim i rëndësishëm në kuadër të realizimit të plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Deri tani ofrimi i shërbimeve publike për jetesën e pavarur ka qenë kryesisht i munguar, me përjashtim të disa modeleve nga shoqëria civile dhe përpjekjeve të para për ngritjen e shërbimeve të reja publike, me fokus nxitjen e të jetuarit në komunitet të personave me probleme të shëndetit mendor, të

hospitalizuar për kohë të gjatë në spitalet psikiatrike.

Koncepti i jetesës së pavarur, siç e parashikon edhe KDPAK-u dhe ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK-ut”, është një nga kushtet për garantimin e përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara. Ofrimi i shërbimeve sociale për kategori dhe grup-mosha të ndryshme të AK-së dhe masat për jetesën e pavarur, janë përqendruar në një objektiv specifik, si shërbim që duhet të ofrohet bërë gjatë 5-vjeçarit nëpërmjet planifikimit të burimeve financiare në Fondin Social, për të siguruar qëndrueshmërinë.

Masat për realizimin e objektivit janë të shumëllojshme, duke filluar që nga miratimi i akteve nënligjore; nxitja e ndërgjegjësimit të qeverisjes vendore; mbështetja e jetesës së pavarur për personat madhorë me aftësi të kufizuara që dalin nga institucionet rezidenciale; ngritja e shtëpive të mbështetura që ofrojnë shërbime për mbështetjen e jetesës së pavarur të personave me aftësi të kufizuara intelektuale, mbi 25 vjeç, që janë aktualisht në spitalet psikiatrike; nxitja dhe formalizimi i shërbimeve të reja jopublike nga operatorë të specializuar nëpërmjet licencimit dhe inspektimit të tyre dhe/apo mundësimin e krijimit të skemave të reja të strehimit që mbështesin jetesën e pavarur të personave me aftësi të kufizuara, duke iu referuar eksperiencave në vendet e tjera.

Qëllimi i politikës 6. Ofrimi i një kujdesi shëndetësor të aksesueshëm e të përballueshëm për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara

Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejta të barabarta për akses në kujdesin shëndetësor cilësor njëloj si pjesa tjetër e popullsisë dhe në programe rehabilitimi falas në komunitetin e tyre. Neni 25 i KDPAK-ut përcakton qartë, se: “Shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin për personat me aftësi të kufizuara të shërbimet shëndetësore të lidhura me gjininë, përfshirë rehabilitimin lidhur me shëndetin”.

Komiteti i OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, pas raportimit të parë për zbatimin e KDPAK-ut, vëren se vazhdojnë të mbeten të pamjaftueshme: shërbimet dhe mjediset e kujdesit shëndetësor në komunitet për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht ata me aftësi të kufizuara intelektuale dhe ata që kërkojnë mbështetje të plotë; programet për identifikimin e



hershëm për personat me autizëm dhe për personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në zonat rurale; mundësia e përdorimit nga personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht të moshuarit, romët dhe gratë e vajzat me aftësi të kufizuara, të shërbimeve të kujdesit shëndetësor gjithëpërfshirës dhe shqetësimet për shëndetin seksual e riprodhues dhe për të drejtat, në kushte të barabarta me të tjerët.

Rekomandimet e dhëna nga Komiteti theksojnë se shteti shqiptar, duhet: “Të sigurojë dhe të monitorojë në mënyrë efektive që ofruesit e shërbimeve shëndetësore të ofrojnë shërbime shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara pa diskriminim dhe në kushte të barabarta me të tjerët, duke bërë të disponueshme dhe të aksesueshme pajisjet dhe instrumentet e nevojshme dhe

teknologjitë ndihmëse, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë, të aksesojnë shërbime, përfshirë shërbimet e shëndetit riprodhues sa më afër shtëpisë, në konsultim të ngushtë me organizatat përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara.”.

Qëllimi i politikës së hartuar në këtë dokument, në fushën e shëndetësisë për të pasur shërbime shëndetësore të aksesueshme, të përballueshme dhe të barabarta është në përputhje të plotë me rekomandimet e përmendura më sipër. Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore qendrore dhe vendore në partneritet edhe me institucionet apo/dhe organizata të shoqërisë civile do të fokusohen në 2 objektiva specifike:

Objektivi specifik 1	Lehtësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara
Objektivi specifik 2	Zhvillimi i shërbimeve të parandalimit, ndërhyrjes së hershme dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara

Objektivi specifik 1. Lehtësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara

Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020–2025 parashikon edhe adaptimin e paketës së shërbimeve shëndetësore publike. Hartimi i një rregulloreje të brendshme për lehtësimin e vizitave mjekësore në institucionet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara është parashikuar në kontekst të Planit të Veprimit.

Me qëllim rritjen e mundësisë së përdorimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor gjithëpërfshirës nga personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht të moshuarit, romët dhe gratë e vajzat me aftësi të kufizuara, është parashikuar në PKVPAK 2021–2025 vendosja e një pike kontakti për çështjet që lidhen me personat me aftësi të kufizuara pranë operatorëve DROSHKSH dhe NJV, me qëllim monitorimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Lidhur me shëndetin dentar të fëmijëve me aftësi të kufizuara e sidomos të atyre me çrregullime të spektrit të autizmit, MSHMS-ja po shqyrton një plan të propozuar nga ana e Klinikës Stomatologjike Universitare (KSU) mbi sigurimin e trajtimit stomatologjik të fëmijëve me çrregullime të spektrit të autizmit. Planit parashikon adresimin e nevojave për këtë kategori fëmijësh në nivel terciar/universitar dhe më tej pranë DSHP-së/DRSH-ve. Ky plan do të parashikojë masa, të

tilla si: planifikim i pajisjeve mjekësore të nevojshme dhe materialeve, sesione trajnimi për personelin e shërbimit të KSU-së etj.

Ndërkohë që për ofrimin e shërbimeve dentare për fëmijët me aftësi të kufizuara në përgjithësi, Planit parashikon fuqizimin e kabineteve ekzistuese stomatologjike të shkollave në nivel kombëtar, si dhe krijimin e kabineteve të reja në 4 drejtori rajonale; rishikimin e rregullores për të siguruar ofrimin e shërbimit stomatologjik falas nëpër shkolla edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara që nuk frekuentojnë shkollën, por që banojnë në të njëjtën bashki.

Objektivi specifik 2. Zhvillimi i shërbimeve të parandalimit, ndërhyrjes së hershme dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara

Për sa i përket aspektit shëndetësor tek aftësia e kufizuar e lindur apo e fituar në vitet e para të jetës, shërbimet e parandalimit dhe ndërhyrjes së hershme sjellin reduktimin e rasteve. Meqenëse shërbimet duhet të fuqizohen, PKVPAK-ut e trajton këtë problematikë si një objektivi të veçantë. Hartimi i planeve individuale të shërbimeve të duhura të përshtatura për fëmijët me aftësi të kufizuara, diagnostikimi dhe monitorimi nga personeli shëndetësor do të shoqërohet me ndërgjegjësim të familjarëve. Aktivitetet e informimit dhe ndërgjegjësimi të prindërve janë



parashikuar, si: aktivitete promociionale për parandalimin e shkaqeve që mund të sjellin aftësi të kufizuara të fëmijët; organizimi i sesioneve informuese për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara për njohjen me paketën dhe llojin e shërbimeve shëndetësore që ofrohen nga institucionet publike.

Një nga targetgrupet më të prekura nga diagnostikimi i hershëm janë personat që nuk dëgjojnë apo që kanë vështirësi në dëgjim. Masat konkrete lidhen me hartimin dhe zbatimin e protokolleve të duhura në të gjitha maternitetet e vendit për të institucionalizuar pilotimin e bërë në tri maternitete të vendit gjatë tri viteve të fundit. Aktivitetet e informimit dhe ndërgjegjësimit për njohjen dhe përfitimin e të gjitha shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara do të përmirësojnë ndërgjegjësimin e kategorive të ndryshme të PAK-ut.

Evidentimi i nevojave për orteza dhe proteza për personat me aftësi të kufizuara dhe identifikimi i prodhuesve do t'i paraprijnë planifikimit dhe mbulimit financiar të shpenzimeve për mjete ndihmëse për ata persona që vlerësohen për këtë lloj përfitimi nga KVAK-u. Synim është ngritja e shërbimeve të rehabilitimit të financuara me fondet publike si dhe shtrirja e tyre në të gjithë vendin. Plani parashikon krijimin e një qendre kombëtare rehabilitimi për të koordinuar shërbimet në nivel lokal dhe për të trajtuar personat që janë bërë gjatë jetës me AK-në apo për të aftësuar rastet me aftësi të kufizuara të lindura.

Dehospitalizimi nëpërmjet strehimit në shtëpi sociale të mbështetura të ngritura është një model ekzistues, por numri i PAK-ut personat me aftësi të kufizuara intelektuale mbetet i lartë në spitale. Krahas ngritjes së shtëpive sociale të mbështetura në përputhje me nevojat në terren, do të hartohen edhe standardet e shërbimeve shëndetësore për shtëpitë e mbështetura për personat me aftësi të kufizuara intelektuale.

Pasurimi i rrjetit të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor do të kryhet në kuadër të zbatimit të politikave të deinstitutionalizimit për personat me çrregullime të shëndetit mendor. Fuqizimi dhe pasurimi i Rrjetit të Integruar të Shërbimeve të Shëndetit Mendor konsiston në përmbushjen e dy objektivave madhorë strategjike, atë të decentralizimit të shërbimeve të shëndetit mendor përmes shtrirjes dhe pasurimit të rrjetit

ekzistues me shërbime sa më pranë komunitetit dhe deinstitutionalizimit, përmes reduktimit të numrit të shtretërve psikiatrikë dhe ngritjes dhe fuqizimit të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor. Nëpërmjet IPA III 2021–2022 është planifikuar financimi për ngritjen dhe funksionimin e 4 (katër) shtëpive të mbështetura.

Një objektiv i rëndësishëm është ngritja dhe funksionimi i institucionit mjekësor të posaçëm për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar” sipas standardeve ndërkombëtare. Përveç masave tranzitore të shprehur dhe në qëllimin 3.2 Barazia, me synim zgjidhjen përfundimtare të problematikave të kësaj kategorie, qeveria shqiptare, në dokumentin “Përgjigja strategjike e Shqipërisë për IPA III”, i paraqitur nga koordinatori kombëtar IPA, ka parashikuar ngritjen e një institucioni mjekësor të posaçëm për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, i parashikuar nën prioritetin tematik 1 – Arsimi, punësimi, politikat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale dhe shëndetësia, për vitet programuese 2023 dhe 2024, me një buxhet të vlerësuar prej 15 milionë euro.

Qëllimi i politikës 7. Garantimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike në Shqipëri dhe mundësimi i mbrojtjes së interesave të tyre

Neni 29 i Konventës, pjesëmarrja në jetën politike dhe publike garanton të drejtat politike dhe pjesëmarrjes publike, duke konfirmuar aftësitë e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike, qoftë drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur.

Komiteti i OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, vëren se vazhdon të ketë dispozita të tilla ligjore që kufizojnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të votuar, të ketë mungesë të aksesit në të gjitha fazat e procesit zgjedhor, veçanërisht mundësinë e aksesit në qendrat dhe materialet e votimit. Gjithashtu, vërehet një lloj përjashtimi në praktikë, të personave me aftësi të kufizuara nga jeta publike dhe politike duke përfshirë edhe gratë me aftësi të kufizuara. Për të bërë të mundur realizimin e përfshirjes politike dhe publike të personave me aftësi të kufizuara, Komiteti rekomandon: “Amendimin e ligjeve përkatëse, përfshirë ligjet elektorale dhe rregulloren e procedurës përkatëse të



KQZ-së, për të garantuar të drejtën e pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike, përfshi të drejtën e votës për të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe të shfuqizojë çdo dispozitë që i mohon këto të drejta personave, të cilët konsiderohen se nuk kanë aftësi ligjore; promovimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara, përfshi gratë, në jetën politike dhe vendimmarrjen publike; marrjen e masave për të lejuar akses fizik të pakufizuar në votim, për krijimin e mekanizmave të sigurt për garantimin e fshehtësisë së fletëvotimit, dhe për të siguruar disponueshmërinë e materialeve dhe informacioneve të tjera zgjedhore në formate të

aksesueshme, përfshi në gjuhën e shenjave, *Braille* dhe *Easy Read*.

Realizimi i qëllimit të politikës në këtë fushë kërkon domosdoshmërisht bashkëpunim të ngushtë me OPAK-un. Për të rritur e forcuar aftësinë e këtyre organizatave, në mënyrë që ato të kontribuojnë në procesin e hartimit të politikave dhe programeve, kërkohet që të promovohen partneritetet midis OPAK-ut me shtetin dhe partnerët e tjerë shoqërorë. Kjo fushë konsiderohet edhe si objekt i masave në lidhje me sigurimin e pjesëmarrjes së OPAK-ut në procesin legjislativ.

PKVPAK 2021–2025 përcakton tre objektiva specifike në këtë fushë:

Objektivi specifik 1	Rritja e numrit të personave me aftësi të kufizuara në procesin e votimit, dhënia e mundësisë për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje
Objektivi specifik 2	Rritja e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike dhe promovimi i punës së artistëve me aftësi të kufizuara.
Objektivi specifik 3	Rritja e mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitete dhe evenimente sportive kombëtare dhe ndërkombëtare

Objektivi specifik 1. Rritja e numrit të personave me aftësi të kufizuara në procesin e votimit, dhënia e mundësisë për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje

E drejta e votës është një nga të drejtat themelore. Kjo nuk do të thotë vetëm pjesëmarrje në procesin politik, por integrim në shoqëri dhe mundësi për të shprehur mendimin e një personi. Mungesa e pjesëmarrjes në zgjedhje për shumë persona me aftësi të kufizuara është ende një problem. Kjo përfshin mundësinë e përdorimit të informacionit në lidhje me zgjedhjet, që duhet të jetë i përshtatshëm, i arritshëm dhe i kuptueshëm (p.sh. për personat me aftësi të kufizuara shqisore ose mendore), si dhe së drejtës për të votuar pasi personave me aftësi të kufizuara mendore shpesh u është mohuar kjo e drejtë. E drejta për të votuar vazhdon të jetë e mohuar edhe për personat me aftësi të kufizuara që e kanë të pamundur të dalin nga kushtet e shtëpisë. Ka gjasa që votimi elektronik ta kapërcejë këtë pengesë.

Për të realizuar të drejtën e pjesëmarrjes në jetën politike e në vendimmarrje të personave me aftësi të kufizuara dhe promovimin e aftësive që ata kanë, do të ishte e nevojshme marrja e masave përfshirëse nëpërmjet vendosjes së kuotave për

aftësinë e kufizuar të ngjashme me ato të barazisë gjinore.

Masat e parashikuara për realizimin e këtij objektivi janë të lidhura me: përmirësime në Kodin Zgjedhor dhe procedurave administrative për të siguruar akses në procesin e votimit; mundësimi i votimit të personave të verbër në mënyrë të pavarur nëpërmjet realizimit të përshtatjes së fletës së votimit në *Braille*, përfshirja e interpretimit të gjuhës së shenjave gjatë fushatave zgjedhore etj. Promovimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së individëve me aftësi të kufizuara në këshillat bashkiakë, nëpërmjet vendosjes së kuotave të ngjashme me kuotat gjinore do të mbështetet nga aktivitete, të tilla si: analiza studimore, vlerësim të eksperiencave bashkëkohore, ndryshime legjislative etj. Për të monitoruar efektin e të gjitha masave të parashikuara, kërkohet ndërhyrje e menjëhershme për ridizenjimin e sistemit të mbledhjes së të dhënave statistikore të KQZ-së me qëllim futjen dhe prodhimin e statistikave që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar.

Objektivi specifik 2. Rritja e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike dhe promovimi i punës së artistëve me aftësi të kufizuara

Në analizën e situatës identifikohet progres për sa i përket përfshirjes në jetën publike të artistëve



me aftësi të kufizuara. PKVPAK 2021–2025 synon që të rritet kjo përfshirje nëpërmjet: institucionalizimit të bashkëpunimit me OPAK-un për promovimin e pjesëmarrjes së artistëve me AK-në në aktivitetet kulturore/artistike, si dhe i aktiviteteve të organizuara nga vetë personat me aftësi të kufizuara; vendosjes së kuotave ose pikëve bonus në favor të propozimeve të organizatave/personave me AK-në gjatë procesit të përzgjedhjes së projekteve të financuara nga MK-ja dhe vlerësimi i impaktit të ndryshimeve të bëra; rritjes së financimit të projekteve artistiko-kulturore të propozuar nga një organizatë apo artist me aftësi të kufizuara; monitorimit të të gjitha institucioneve kulturore në varësi të pushtetit qendror dhe atij vendor, për aplikimin e tarifave të reduktuara dhe hyrjen falas në të gjithë muzetë apo objektet e tjera kulturore.

Objektivi specifik 3. Rritja e mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitete dhe evenimente sportive kombëtare dhe ndërkombëtare

Në ligjin nr. 79/2017, “Për sportin”, është parashikuar, që: “Personat me aftësi të kufizuara mund të organizohen në shoqata sportive dhe të anëtarësohen në federata, të cilat kanë ekskluzivitetin e trajtimit të të gjitha çështjeve të një sporti”, duke krijuar hapësirën e nevojshme ligjore, për vetorganizim të këtij grupi në organizata e veprimtari sportive.

Vështirësitë kryesore që lidhen me aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në veprimtari sportive, lidhen kryesisht me infrastrukturën sportive, në të cilën përfshihen ambientet sportive të hapura (stadione, fusha sportive etj.) e të mbyllura (pallate sporti, palestra e qendra sportive etj.). Këto janë objekte në administrim të pushtetit vendor, për të cilat ka një *data-bazë* të detajuar në rang vendi, por nuk disponohet informacion i detajuar mbi kushtet që ato duhet të plotësojnë për të qenë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara.

Masat e parashikuara në plan për realizimin e këtij objekti janë të lidhur me promovimin e sportistëve me aftësi të kufizuara duke i bërë pjesë në takimet e Komitetit Olimpik jashtë vendit apo si anëtar të Komitetit Kombëtar të Sporteve, në aktivitete promovuese për sportistët me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e financimit në përputhje me legjislacionin. Kryerja e një studimi për praktikën e mira të vendeve të tjera, lidhur me

mundësinë e krijimit dhe financimit të një federate sportesh të personave me aftësi të kufizuara, do t'i hapte rrugë hartimit të kurrikulave të plota që udhëzojnë kryerjen e sportit të unifikuar për personat me aftësi të kufizuara. Ajo çka është më kryesore lidhet me sigurimin e aksesit të të gjitha ambienteve sportive për personat me aftësi të kufizuara. Një vend të rëndësishëm zë aksesit në ambientet sportive të shkollave që duhet të shoqërohet edhe me trajnimin dhe specializimin e mësuesve të edukimit fizik për të punuar me fëmijë me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i politikës 8. Krijimi i sinergjive ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm për nxitjen dhe monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të plotë, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme

Zbatimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i Planit është një proces ambicioz, koheziv dhe ndërdisiplinor që përfshin shumicën e autoriteteve të qeverisë qendrore dhe shumë institucione dhe organizata të tjera të personave me aftësi të kufizuara.

Qëllimi strategjik i kësaj fushe të PKVPAK-ut, është krijimi i sinergjive mes sektorëve të ndryshëm për nxitjen dhe monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të plotë, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. PKVPAK-u ka katër objektiva, përmbushja e të cilëve synon të nxisë bashkëpunimin dhe koordinimin mes institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij në nivel qendror dhe vendor, forcimin e bashkëpunimit me OPAK-un, si dhe të mundësojë ngritjen e mekanizmave dhe instrumenteve të qëndrueshëm, të cilët do të përdoren për të monitoruar zbatimin e tij.

Bazuar në raportimin e parë për zbatimin e KDPK-ut, Komiteti i OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në rekomandimet e përgjithshme përcakton se shteti shqiptar, duhet: “Të rishikojë dhe të harmonizojë legjislacionin, duke përfshirë modelin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në përputhje me Konventën; të eliminojë nga gjithë legjislacioni, dokumentet publike dhe fjalimet, përdorimin e të gjitha gjuhëve përçmuese ndaj personave me aftësi të kufizuara; të rivlerësojë legjislacionin lidhur me përzgjedhjen dhe nivelin e përfaqësimit të anëtarëve të KKAK-ut që përfaqësojnë organizatat e shoqërisë civile në Këshill, si dhe me sigurimin e burimeve të



mjaftueshme dhe të vazhdueshme financiare dhe mbështetje administrative për Këshillin.”.

Politika do të zbatohet duke u fokusuar në arritjen e 4 objektivave:

Objektivi specifik 1	Forcimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet strukturave qendrore dhe pushtetit vendor dhe ndëreveprimi me OPAK-un në të gjitha nivelet
Objektivi specifik 2	Përmirësimi i funksionimit të KKAK-ut lidhur me koordinimin e politikave publike në nivel horizontal dhe vertikal, të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara
Objektivi specifik 3	Ngritja e një sistemi statistikor të qëndrueshëm, për matjen e indikatorëve të monitorimit, në reference dhe përputhje me treguesit e SDG për aftësinë e kufizuar
Objektivi specifik 4	Nxjtja e bashkëpunimit rajonal për zbatimin e KDPAK-ut

Objektivi specifik 1. Forcimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet strukturave qendrore dhe pushtetit vendor dhe ndëreveprimi me OPAK-un në të gjitha nivelet

Edhe pse masat sipas Planit Kombëtar nuk mund të vendosin detyra për pushtetin vendor, është e rëndësishme dhe praktike t’iu sigurohet atyre një mbështetje e vazhdueshme metodologjike dhe të ndërmjetësohet një dialog për problemet aktuale të politikave rajonale në favor të personave me aftësi të kufizuara dhe lidhjeve midis politikave rajonale dhe politikës kombëtare në favor të këtij grupi qytetarësh. Nëpërmjet mbështetjes së institucioneve qendrore, bashkitë duhet të zhvillojnë përgjegjësitë e tyre në lidhje me përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, duke filluar që nga vlerësimi i nevojave që ata kanë, planifikimi i buxheteve dhe kryerja e investimeve për të siguruar mjedise e transport të aksesueshëm, rritjen e kapaciteteve për dhënien e shërbimeve bazë për personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi parashikohet të realizohet nëpërmjet masave të tilla mbështetëse që fuqizojnë bashkëpunimin ndërmjet pushteteve të dy niveleve, si: zbatimi i një plani masash të përbashkët në kuadrin e zbatimit të politikave të aftësisë së kufizuar; ofrimi i një guide metodologjike për të ndihmuar bashkitë në kryerjen e një vlerësimi të nevojave të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara që jetojnë në territorin e tyre; organizimi i takimeve periodike të strukturuar me pjesëmarrjen e ministrive të linjës, NJQV-ve dhe grupeve të interesit; organizimi i aktiviteteve promovuese të iniciativave të mira duke shpallur bashkitë më të mira të vitit lidhur me realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

Objektivi specifik 2. Përmirësimi i funksionimit të KKAK-ut lidhur me koordinimin e politikave publike në nivel horizontal dhe vertikal, të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara

Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, përcakton KKAK-un si strukturën më të lartë të hartimit, koordinimit dhe monitorimit të politikave për aftësinë e kufizuar si dhe të legjislacionit kombëtar që afekton jetën e personave me aftësi të kufizuara. Në vëzhgimet përmbyllëse të raportimit të parë, Komiteti i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara vëren se: kanë qenë të pamjaftueshme përpjekjet për të rishikuar legjislacionin ekzistues dhe për ta sjellë atë në përputhje të plotë me Konventën; vazhdon të ketë akoma terma përçmuese dhe diskriminuese në legjislacionin kombëtar, dokumente publike apo fjalime të ndryshme. Këto konkluzione duhet të shqyrtohen imtësisht në takimet e KKAK-ut dhe të dilet me propozime konkrete për qeverinë qoftë për përmirësimet e duhura në legjislacion, përmirësimet institucionale dhe funksionimin e vetë KKAK-u.

Duke u bazuar në efektivitetin e punës dhe funksionimit të KKAK-ut për një periudhë 5-vjeçare dhe rekomandimeve të Komitetit të OKB-së për përmirësimet të legjislacionit, Plani parashikon masa të tilla që kanë të bëjnë me: rishikimin e ligjit kuadrë “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”, në funksion të përmirësimit të monitorimit dhe koordinimit të politikave për aftësinë e kufizuar në të gjitha nivelet; rivlerësimin e analizave të legjislacionit kombëtar të kryera në 5 vitet e fundit lidhur me përputhshmërinë e tij me



KDPAK-un; organizimin e takimeve periodike me pikat fokale për aftësinë e kufizuar në ministritë e linjës dhe bashki; kryerjen e vizitave në NJQV të ndryshme për të përçuar problematikat që ngrihen nga grupet e interesit gjatë takimeve të KKAK-ut.

Objektivi specifik 3. Ngritja e një sistemi statistikor të qëndrueshëm, për matjen e indikatorëve të monitorimit, në reference dhe përputhje me treguesit e SDG-së për aftësinë e kufizuar

Neni 31 i Konventës, “Statistikat dhe mbledhja e të dhënave” përcakton rëndësinë e mbledhjes së informacionit përkatës dhe të dhënave statistikore të konsiderueshme për formulimin dhe zbatimin e politikave efektive për personat me aftësi të kufizuara. Informacioni përdoret, gjithashtu, si një mjet për vlerësimin e zbatimit të masave, si dhe për identifikimin dhe heqjen e barrierave me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara kur zbatojnë të drejtat e tyre personale. Për të formuluar politikën shtetërore për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë efektive, është e rëndësishme të krijohet një sistem të dhënash statistikore të sakta për numrin, nevojat e përgjithshme dhe ato specifike të këtij target grupi.

Ligji nr. 93/2014, neni 17, përcakton detyrimin e institucioneve të mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar sipas fushave ku ato operojnë, të përcaktuara sipas VKM-së nr. 708, datë 26.8.2015, “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, një akt nënligjor i pazbatuar deri tani nga të gjitha institucionet. Në kuadrin e zbatimit të PKVPAK 2021–2025, dhe të rekomandimeve të Komitetit, rishikimi i tij do të ishte i vlefshëm duke iu referuar tashmë edhe indikatorëve të SDG për aftësinë e kufizuar. Një bazë e mirë referuese për ngritjen e sistemit të të dhënave për aftësinë e kufizuar është edhe Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale. Për të garantuar që të gjitha zyrat e qeverisë janë në gjendje të mbledhin të dhënat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të këtij Plani Veprimi, nevojitet edhe ngritja e mëtejshme e kapaciteteve.

Instituti i Statistikave ka përfshirë disa pyetje për aftësinë e kufizuar në studimet kombëtare si anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës (SILC), anketa evropiane e shëndetit (EHIS). Gjithashtu, në CENS 2022, synohet të mblidhen të dhëna për PAK. SILV mbledh të dhëna si për gjendjen

shëndetësore, perceptimin e të anketuarit për gjendjen shëndetësore, sëmundjeve kronike dhe rreth kufizimeve në kryerjen e aktiviteteve.

Anketa evropiane e shëndetit mbledh të dhëna të detajuara dhe të krahasueshme për gjendjen shëndetësore dhe kujdesin shëndetësor me qëllim matjen e prevalencës së kufizimeve. Gjithashtu, CENS 2022 synon të mbledhë të dhëna për personat me aftësi të kufizuara bazuar në setin e shkurtuar të Washington Group me pyetje specifike.

Masat e parashikuara për arritjen e këtij objektivi janë përmirësimi i gjithë statistikave për aftësinë e kufizuar duke përmirësuar mbledhjen e të dhënave administrative në të gjithë sektorët e nivelet, si dhe trajnimi i punonjësve të statistikës në të gjitha institucionet lidhur me rëndësinë e të dhënave për aftësinë e kufizuar dhe mënyrën e mbledhjes së tyre.

Objektivi specifik 4. Nxjitja e bashkëpunimit rajonal për zbatimin e KDPAK-ut

Ky objektivi është i lidhur tërësisht dhe vjen nga neni 32, “Bashkëpunimi ndërkombëtar” i KDPAK-ut, dhe është parashikuar të ndikojë në progresin që duhet të bëjë vendi ynë duke u mbështetur dhe shkëmbyer eksperiencat pozitive me vendet e rajonit dhe më gjerë.

Një vend të rëndësishëm për arritjen e këtij objektivi do të luajë funksionimi proaktiv i KKAK-ut, i cili në mënyrë periodike duhet të propozojë pranë qeverisë shqiptare dhe institucioneve që hartojnë e zbatojnë politika të aftësisë së kufizuar, kryerjen e aktiviteteve e konferencave rajonale, si dhe shkëmbim të eksperiencave pozitive në favor të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara.

PJESA III ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Përgjegjësia e institucioneve

Fushat e politikave të përfshira në PKVPAK 2021–2025 përcaktojnë qartë ministritë e linjës dhe institucionet në varësi të tyre që janë përgjegjëse për zbatimin e tij.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Drejtësisë



Ministria e Brendshme

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Kulturës

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Autoriteti i Mediave Audiovizive

Inspektorati Shtetëror i Punës e Shërbimeve Shoqërore

Instituti i Statistikave

Plani i Veprimit përcakton Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucionin përgjegjës kryesor të raportimit për progresin e këtij Plani edhe pse pjesa më e madhe e veprimtarive do të kërkojë bashkëpunim ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile, kryesisht ato të personave me aftësi të kufizuara dhe njësitë e qeverisjes vendore. Institucionet përgjegjëse për çdo masë sipas objektivave specifike dhe fushave të politikës janë të përcaktuara pjesën III “Zbatimi, përgjegjësia e institucioneve, llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi”.

Llogaridhënia, monitorimi dhe raportimi

Kuadri monitorues do të ushqejë orientimin e politikave në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e resurseve të vendit. Ai do të furnizojë me raporte monitoruese dhe vlerësuese Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), për Sektorin e Punësimit dhe atë Social, i ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave dhe zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, të cilat monitorojnë reformat sektoriale në Shqipëri në përputhje me prioritetet e qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), procesin e anëtarësimit në BE dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij Plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve në

takimet e nëngrupit tematik të përfshirjes sociale që do të udhëhiqet nga MSHMS-ja dhe përbërje të strukturave ndërsektoriale. Sipas ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”, Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Diskriminimin” janë institucione monitoruese të zbatimit të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Bazuar në detyrimin ligjor, zbatimi i Planit të Veprimit monitorohet, gjithashtu, nga Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar i ngritur me urdhrin nr. 12 të Kryeministrit, në shkurt 2015, Këshilli funksionon bazuar mbi “Për një ndryshim në vendimin nr. 48, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit kombëtar për aftësinë e kufizuar” (i ndryshuar) dhe përbëhet nga ministrat që mbulojnë sektorët përkatës dhe anëtarë që përfaqësojnë organizatat e personave me aftësi të kufizuara. MSHMS-ja nëpërmjet hartimit dhe aplikimit të një Guide Metodologjike do të mbështesë bashkitë për hartimin dhe zbatimin e planeve të tyre të veprimit për përfshirje të personave me aftësi të kufizuara. Bashkërendimi i punës do të bëhet nëpërmjet pikës fokale për aftësinë e kufizuar në çdo bashki.

Gjatë punës së përditshme, përgjegjësia për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit qëndron te nëpunësit përgjegjës të ministrive të linjës që do të vënë në jetë aktivitetet, do të mbledhin të dhëna dhe do të dorëzojnë raportet e progresit për çdo sektor. Ministrinë dhe bashkitë kanë identifikuar një nëpunës përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar bazuar edhe në ligjin nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK-ut”, por përgjegjësitë e kompetencat e tyre për këtë fushë duhet të përfshihen në përkrahimin detyrues të tyre të punës dhe të mos mbivendosen. Nisur nga specifikat, trajnimet duhet të jenë të vazhdueshme. Një modul i tillë është realizuar nga MSHMS-ja në bashkëpunim me ASPA-në duke institucionalizuar këtë përqasje që të mundësohet modul trajnimit i aprovuar.

MSHMS-ja ka rol koordinues dhe raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit. Sekretariati Teknik i KKAK-ut dhe Sektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, do të jenë përgjegjëse për koordinimin e aktorëve të ndryshëm dhe do të raportojnë mbi zbatimin e Planit të Veprimit bazuar në të dhënat nga ministrinë e linjës. Plani i Veprimit parashikon



publikimin e raport progresit vjetor gjatë 5 viteve të ardhshme dhe mbështetjen për raportet monitoruese të shoqërisë civile.

Organizatat e shoqërisë civile luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin rreth problemeve në zbatimin dhe në mbështetjen e proceseve të mbledhjes së të dhënave. Duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me personat me aftësi të kufizuara, organizatat e shoqërisë civile janë në vendin e duhur për të mbajtur shënim mësimet e marra nga zbatimi i politikës dhe për t'u shpjeguar pjesëmarrësve të mundshëm rëndësinë e mbledhjes së të dhënave.

PJESA IV ANALIZA BUXHETORE

4.1 Analiza e buxhetit për zbatimin e PKVPAK-së

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen e kostove indikative dhe burimeve financiare që financojnë masat e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025. Efektet

financiare janë përllogaritur për çdo masë bazuar në aktivitetet që janë të parashikuara në Planin e Veprimit. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, si dhe nga buxheti i donatorëve dhe institucioneve të tjera për një pjesë të masave.

Procesi i kostimit është mbështetur në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu Programi Buxhetor Afatmesëm 2021–2023, si dhe konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira. Plani i veprimit shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e këtij plani veprimi është 1,466,608,650 lekë, ose 11,827,489 euro. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 124 lek për 1 euro. Tabela pasqyron kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 5 viteve të zbatimit të planit.


Nevojat (në Lek)

Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale 2020-2025	Kostot e Planifikuara PBA 2021-2023 Buxheti dhe Donatorët	Kosto për tu Planifikuar në Buxhetin 2024- 2025	Hendeku Financiar 2021-2025
P1: Të ofrohet akses i barabartë në shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara	Korente	162,986,704	65,661,632	50,590,976	56,796,596
	Kapitale	126,488,500	94,725,500	21,700,500	
P2: Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara	Korente	89,539,632	11,384,346	149,734,397	52,620,889
	Kapitale	124,545,000	0	345,000	
P3: Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe nxitja e mundësive të barabarta për punë të denjë për personat	Korente	135,445,952	75,196,704	44,818,448	15,430,800
	Kapitale	0	0	0	
P4: Ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara	Korente	218,406,474	86,929,578	92,657,748	38,819,148
	Kapitale	0	0	0	
P5: Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitimeve të	Korente	119,414,160	66,158,192	41,365,168	11,890,800
	Kapitale	0	0	0	
P6: Realizimi i një kujdesi shëndetësor të aksesueshëm e të përbalueshëm për të gjitha kategoritë e personave me	Korente	189,252,088	73,720,544	111,692,264	38,339,280
	Kapitale	170,200,000	34,500,000	101,200,000	
P7: Garantimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike në Shqipëri	Korente	83,866,868	30,101,502	22,310,966	31,454,400
	Kapitale	0	0	0	
P8: Krijimi i sinergjive ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm për nxitjen dhe monitorimin e	Korente	46,463,272	21,987,776	7,775,896	16,699,600
	Kapitale	0	0	0	
TOTALI [Lekë]		1,466,608,650	560,365,774	644,191,363	262,051,513
TOTALI [Euro]		11,827,489	4,519,079	5,195,092	2,113,319
1 euro 124 Lekë					



Vëllimi i politikës VI, pritët të ketë në terma financiare peshën më të madhe në zbatimin e planit, përkatësisht 24.5%. Qëllimi i politikës I kap vlerën 19.7%, ndërsa qëllimi i politikës IV dhe II kapin respektivisht 14.9% dhe 14.6 % të koston së përgjithshme të planit.

NDARJA E SHPENZIMEVE




Financimi i planit të veprimit do të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e donatorëve. Për periudhën 2021–2025, buxheti i shtetit pritët të financojë zbatimin e planit në masën 75% të financimit të nevojshëm, 7% pritët të financohet nga donatorë dhe burime të tjera, ndërsa 18% është hendek financiar.

Kostot korente zënë rreth 71% të shpenzimeve totale, ndërsa pjesa tjetër (29%) është e parashikuar për kosto kapitale.



Të ndara sipas qëllimeve të politikave, kostot pasqyrohen në grafikun më poshtë:



Plani i Veprimit do të rishikohet pas 3 vitesh vit për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform nevojave dhe programeve buxhetore afatmesme 2024–2025, të çdo institucioni. Për masa të Planit të Veprimit që janë të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve

buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar.



Viti 2021 – Numri 75

Page | 8246



Viti 2021 – Numri 75

Page | 8247

Fletorja Zyrtare



Viti 2021 – Numri 75

[illegible]

**Viti 2021 – Numri 75**Page | 8249

[illegible]

Qilimi strategji 3. Retija e pjestonarëve në tregun e peshës dhe shtija e mundësive të bazuarit për peshë të dyqit për peshonat ose shtet të kulturave

III. Pagumti šacheta qđ kontroluon pta qđllimn e polistiko: 10530 Terga i punbt; 94170 Inspektori i punbt; 19430 Pibajdreja sociate; 18/10100 Plastifikim, mernachim, administrativim

[illegible]

[illegible]

Qitimi strategjik 4. Ofisi i analizës gjërat që duhet të bëjë dhe cilat për të gjatë shpreh të tjerë të kësaj

IV. Pagrabi nosaukumi ar kontrolējamā pilsētās un pilsētās: U/HHH Pilsētas, rezervācija, administrācija: 0010 Arīzi bazī, 0020 Arīzi i mēne (izpildītāji)

[illegible]

[illegible]

Notă: Informațiile în acest fișier pot fi utilizate în scopuri de marketing sau de vânzare de produse și servicii, în funcție de preferințele dvs. de marketing și de vânzare de produse și servicii.

V. Programi buhetarësh që kontrollohen për qëllime të politikës: 11430 Përkrahja sociale; 11,50130 Planifikim, merrvendje, administrim

[illegible]

Page | 8253

[illegible]

[illegible]

VII. Programi bachelor që kontrollohen për qëllimin e poshëm 0530 Veprimtaria administrative e institucioneve; 12/0110 Planifikim, organizim, administrim; 0820 Arti dhe Kultura; 0500 Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë

[illegible]

**Viti 2021 – Numri 75**Page | 8255

Fletorja Zyrtare Viti 2021 – Numri 75



Fletorja Zyrtare  Viti 2021 – Numri 75

Fletorja Zyrtare  Viti 2021 – Numri 75



Qëllimi i																		I:	
Përmirësimi i cilësisë, aksesibilitë dhe konsistencës së të dhënave të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime																		politikës	
Objektivat specifike	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostot treguese			Burimi i mbulimit deri në 2022									Hendeku financiar 2023–2030 (në lekë)		
Qëllimi strategjik 1: Të ofrohet akses i barabartë në shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara																			
Objektivat specifike	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i financimit			Hendeku financiar 2021–2025 (në lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 124 ALL)	
								PBA 2021–2023 (në lekë)			Financimi i huaj (në lekë)								Buxheti 2024–2026 (në lekë)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontraktues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Kostoja totale	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së	Korente	Kapitale	Totali i FFI-së	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së			
Objektivi specifik 1.1: Realizimi i aksesueshmërisë në mjedise për personat me aftësi të kufizuara	MSHIMS-ja	Ministritë e largës/Task-Forca/ISI IP&SI ISI SH-ja/NJVQV-të	2021	2025	76,118,152	0	76,118,152	20,186,024	0	20,186,024	0	0	0	33,130,832	0	33,130,832	(22,801,296)	613,856	
Objektivi specifik 1.2: Realizimi i aksesueshmërisë në transport për personat me aftësi të kufizuara	MIE/MSHIMS-ja/AKSHI	MSHIMS-ja/MD-ja/MFE-ja/shoqatat e transportit dhe OJQ-të	2021	2025	32,800,208	75,612,500	108,412,708	15,318,608	0	15,318,608	0	65,550,000	65,550,000	8,188,800	0	8,188,800	(19,355,300)	874,296	
Objektivi specifik 1.3: Realizimi i aksesueshmërisë në informacion dhe në komunikim për personat me aftësi të kufizuara	AKSHI/AKEP-q/AMA/MSHIMS-ja	ADISA/MSHIMS-ja/të gjitha institucionet publike	2021	2025	54,068,344	50,876,000	104,944,344	14,947,232	29,175,500	44,122,732	15,209,768	0	15,209,768	9,271,344	21,700,500	30,971,844	(14,640,000)	846,325	
Kostoja totale e qëllimit të politikës I (objektivat specifike 1.1+1.2+1.3)					162,986,704	126,488,500	289,475,204	50,451,864	29,175,500	79,627,364	15,209,768	65,550,000	80,759,768	50,590,976	21,700,500	72,291,476	(56,796,596)	2,334,477	
Qëllimi strategjik 2: Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara																			
Objektivat specifike	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i financimit			Hendeku financiar 2021–2025 (në lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 124 ALL)	
								PBA 2021–2023 (në lekë)			Financimi i huaj (në lekë)								Buxheti 2024–2026 (në lekë)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontraktues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Kostoja totale	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së	Korente	Kapitale	Totali i FFI-së	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së			
Objektivi specifik 2.1: Rritja e numrit të individëve me aftësi të kufizuara që përdorin shërbimet e ndihmës juridike falas	DNJF-ja/MD-ja	MSHIMS-ja/ANAD-i	2021	2025	29,965,091	345,000	30,310,091	464,010	0	464,010	8,884,848	0	8,884,848	1,900,000	345,000	2,245,000	(18,716,233)	244,436	
Objektivi specifik 2.2: Niveli i barabartë para ligjit e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht i personave me aftësi të kufizuara mendore	MSHIMS-ja	MD-ja/KLCJ-ja	2021	2025	17,726,077	0	17,726,077	0	0	0	0	0	0	13,409,677	0	13,409,677	(4,316,400)	142,952	
Objektivi specifik 2.3: Garantimi i respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në institucionet e drejtësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare	MD-ja/DPP-ja	MSHIMS-ja	2021	2025	41,848,464	124,200,000	166,048,464	2,035,488	0	2,035,488	0	0	0	134,424,720	0	134,424,720	(29,588,256)	1,339,101	
Kostoja totale e qëllimit të politikës II (objektivat specifike 2.1+2.2+2.3+2.4+2.5)					89,539,632	124,545,000	214,084,632	2,499,498	0	2,499,498	8,884,848	0	8,884,848	149,734,397	345,000	150,079,397	(52,620,889)	1,726,489	
Qëllimi strategjik 3: Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe rolin e mundësive të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara																			
Objektivat specifike	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i financimit			Hendeku financiar 2021–2025 (në lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 124 ALL)	
								PBA 2021–2023 (në lekë)			Financimi i huaj (në lekë)								Buxheti 2024–2026 (në lekë)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontraktues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Kostoja totale	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Totali i FFI-së	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së			
Objektivi specifik 3.1: Rritja e cilësisë në shërbimet e aftësimit për të notur përfituesin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës	MFE-ja	AKPA-ja	2021	2025	54,171,576	0	54,171,576	32,756,328	0	32,756,328	0	0	0	14,485,248	0	14,485,248	(6,930,000)	436,868	
Objektivi specifik 3.2: Rritja e mundësive për punësim dhe vetëpunësim për personat me aftësi të kufizuara	MFE-ja	AKPA-ja	2021	2025	65,848,608	0	65,848,608	38,868,304	0	38,868,304	0	0	0	26,980,304	0	26,980,304	-	531,037	
Objektivi specifik 3.3: Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve që synojnë mësimin e integruar të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës	MFE-ja	AKPA-ja/Inspektorati i Punës	2021	2025	15,425,768	0	15,425,768	3,572,072	0	3,572,072	0	0	0	3,352,896	0	3,352,896	(8,500,800)	124,401	
Kostoja totale e qëllimit të politikës III (objektivat specifike 3.1+3.2+3.3)					135,445,952	0	135,445,952	75,196,704	0	75,196,704	0	0	0	44,818,448	0	44,818,448	(15,430,800)	1,092,306	



Qilimi strategjik 4: Ofrimi i asistimit gjatëpërshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me afësi të kufizuara																		
Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i financimit			Herdoku financiar 2021–2025 (në lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 124 ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2021–2023 (në lekë)			Financim i huaj (në lekë)			Buxheti 2024–2025 (në lekë)				
								Korente	Kapitale	Kostoja totale	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së	Korente	Kapitale	Totali i FH-së		
Objektivi specifik 4.1: Rrëja e mundësive për pjesëmarrje në asistim gjatëpërshirës për fëmijët me lloje të ndryshme të afësive të kufizuara.	MASR-ja	MSHIMS-ja/DRAP-ja	2021	2025	160,144,670	0	160,144,670	85,309,698	0	85,309,698	0	0	0	66,841,772	0	66,841,772	(7,993,200)	1,291,489
Objektivi specifik 4.2: Shërbime të shëndetshme të specializuara në qendrat burimore.	MASR-ja		2021	2025	58,261,804	0	58,261,804	593,880	0	593,880	1/05,000	0	1/026,000	25,815,976	0	25,815,976	(30,825,948)	469,853
Kostoja totale e qilimit të politikës IV (objektiva specifike 4.1+4.2)					218,406,474	0	218,406,474	85,903,578	0	85,903,578	1,026,000	0	1,026,000	92,657,748	0	92,657,748	(38,819,148)	1,761,343
Qilimi strategjik 5: Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me afësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfshirjeve të aksesueshme, të përbalheshme financiarisht dhe që kanë në qendër klientin																		
Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i financimit			Herdoku financiar 2021–2025 (në lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 124 ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2021–2023 (në lekë)			Financim i huaj (në lekë)			Buxheti 2024–2025 (në lekë)				
								Korente	Kapitale	Kostoja totale	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së	Korente	Kapitale	Totali i FH-së		
Objektivi strategjik 5.1: Monitorimi i cilësive të shërbimeve të afësive të kufizuara nga komuniteti e reja, sipas modelit tri-palok social.	MSHIMS-ja	SHESH-ja	2021	2025	7,058,368	0	7,058,368	655,184	0	655,184	0	0	0	883,184	0	883,184	(5,520,000)	56,922
Objektivi specifik 5.2: Ofrimi i shërbimeve të integruara sociale me anë të komunitetit të pagësve me para në dorë (cash) me kujdesin social cilësor.	MSHIMS-ja	SHESH-ja/NJVQV-së	2021	2025	27,661,520	0	27,661,520	22,157,248	0	22,157,248	0	0	0	710,272	0	710,272	(4,794,000)	225,077
Objektivi specifik 5.3: Përmirësimi dhe reja e pajisjeve të pajisjeve nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve sociale komunitare.	MSHIMS-ja	SHESH-ja/NJVQV-së/MBE-ja/Drejtoria e Shërbimeve	2021	2025	84,694,272	0	84,694,272	43,345,760	0	43,345,760	0	0	0	39,771,712	0	39,771,712	(1,576,800)	683,018
Kostoja totale e qilimit të politikës V (objektiva specifike 5.1+5.2+5.3)					119,414,160	0	119,414,160	66,158,192	0	66,158,192	0	0	0	41,365,168	0	41,365,168	(11,890,800)	963,017
Qilimi strategjik 6: Realizimi i një llojesh shëndetësor të aksesueshëm e të përbalheshëm për të gjitha kategoritë e personave me afësi të kufizuara																		
Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i financimit			Herdoku financiar 2021–2025 (në lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 124 ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2021–2023 (në lekë)			Financim i huaj (në lekë)			Buxheti 2024–2025 (në lekë)				
								Korente	Kapitale	Kostoja totale	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së	Korente	Kapitale	Totali i FH-së		
Objektivi specifik 6.1: Lehtësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me afësi të kufizuara.	MSHIMS-ja		2021	2025	21,506,552	11,500,000	33,006,552	7,963,680	0	7,963,680	0	0	0	10,880,392	11,500,000	21,580,392	(3,462,480)	266,182
Objektivi specifik 6.2: Zbatim i shërbimeve të parandalimit, ndërtimit të herës dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rinjtë me afësi të kufizuara.	MSHIMS-ja		2021	2025	167,745,536	158,700,000	326,445,536	60,476,864	34,500,000	94,976,864	5,280,000	0	5,280,000	101,611,872	89,700,000	191,311,872	(34,876,800)	2,632,625
Kostoja totale e qilimit të politikës VI (objektiva specifike 6.1+6.2+6.3+6.4+6.5+6.6)					189,252,088	170,200,000	359,452,088	68,440,544	34,500,000	102,940,544	5,280,000	0	5,280,000	111,692,264	101,200,000	212,892,264	(38,339,280)	2,898,807
Qilimi strategjik 7: Garantimi i përshirjes së plotë të personave me afësi të kufizuara në jetën publike dhe politike në Shqipëri dhe mundësimi i mbrojtjes së interesave të tyre																		
Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i financimit			Herdoku financiar 2021–2025 (në lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 124 ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2021–2023 (në lekë)			Financim i huaj (në lekë)			Buxheti 2024–2025 (në lekë)				
								Korente	Kapitale	Kostoja totale	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së	Korente	Kapitale	Totali i FH-së		
Objektivi specifik 7.1: Rrëja e numrit të personave me afësi të kufizuara në procesin e votimit, dhënies e mundësive për të marrë pjesë në vendimarrje.	KQZ-ja	Kuvendi, partitë politike	2021	2025	23,037,620	0	23,037,620	13,060,590	0	13,060,590	0	0	0	7,466,630	0	7,466,630	(2,510,400)	185,787
Objektivi specifik 7.2: Promovimi i punës së artistëve me afësi të kufizuara dhe përfshirja e personave me afësi të kufizuara në jetën artistike.	MK-ja	Institucionet e varësive/NJVQV-së	2021	2025	10,287,648	0	10,287,648	6,610,912	0	6,610,912	0	0	0	3,676,736	0	3,676,736	-	82,965



Objektivi specifik 3: Rritja e mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitetet dhe eventet sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.	MASR-ja	Special Olympics - Albania	2021	2025	50,541,600	0	50,541,600	5,232,600	0	5,232,600	5,197,400	0	5,197,400	11,167,600	0	11,167,600	(28,944,000)	407,594
Kostoja totale e qëllimit të politikës VII (objektivi specifikë 7.1+7.2+7.3)					83,866,868	0	83,866,868	24,904,102	0	24,904,102	5,197,400	0	5,197,400	22,310,966	0	22,310,966	(31,454,400)	676,346
Qëllimi strategjik 8: Krijimi i sinergjive ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm për mënyrën dhe monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të plotë, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme																		
Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indirekte totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i financimit			Hendeku financiar 2021–2025 (në lek)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 124 ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2021–2023 (në lek)			Financim i huaj (në lek)			Buxheti 2024–2025 (në lek)				
								Korente	Kapitale	Kostoja totale	Korente	Kapitale	Totali i FFI-së	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së		
Objektivi specifik 1: Sigurimi i një bashkëpunimi dhe koordinimi më të mirë ndërinstitucional në nivel horizontal dhe vertikal me qëllim promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.	MSHMS-ja	Ministritë e leqës/NJV/QV-at/OJF-at	2021	2025	6,564,432	0	6,564,432	2,569,536	0	2,569,536	0	0	0	1,550,496	0	1,550,496	(2,444,400)	52,939
Objektivi specifik 2: Monitorimi i përparësive me të cilat përballen persona me aftësi të kufizuara dhe koordinimi i politikave publike që synojnë uljen e tyre.	MSHMS-ja		2021	2025	17,239,320	0	17,239,320	9,401,920	0	9,401,920	0	0	0	4,209,400	0	4,209,400	(3,628,000)	139,027
Objektivi specifik 3: Ngritja e sistemit për mbledhjen e indikatorëve të monitorimit të shoqëruar me pasaportat për çdo indikator.	MSHMS-ja	INST/AT-4	2022	2022	3,123,520	0	3,123,520	2,240,320	0	2,240,320	0	0	0	0	0	0	(883,200)	25,190
Objektivi specifik 4: Ngritja e bashkëpunimit rajonal për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.	MSHMS-ja		2023	2023	19,536,000	0	19,536,000	7,776,000	0	7,776,000	0	0	0	2,016,000	0	2,016,000	(9,744,000)	157,548
Kostoja totale e qëllimit të politikës VII (objektivi specifikë 8.1+8.2+8.3)					46,463,272	0	46,463,272	21,987,776	0	21,987,776	0	0	0	7,775,896	0	7,775,896	(16,699,600)	374,704
Kostoja totale (QS1+QS2+QS3+QS4+QS5+QS6+QS7+QS8)					1,045,375,150	421,233,500	1,466,608,650	395,542,258	63,675,500	459,217,758	35,598,016	65,550,000	101,148,016	520,945,863	123,245,500	644,191,363	(262,051,513)	11,827,489

Kostoja totale e PKV-së	1,466,608,650
MTDP-ja 2021–2023	459,217,758
Financimi i huaj	101,148,016
Buxheti 2024–2025	644,191,363
Hendeku financiar 2021–2025	-262,051,513



	Kostoja korente	Kostoja kapitale	Në %
Qëllimi i politikës I	162,986,704	126,488,500	19.7%
Qëllimi i politikës II	89,539,632	124,545,000	14.6%
Qëllimi i politikës III	135,445,952	0	9.2%
Qëllimi i politikës IV	218,406,474	0	14.9%
Qëllimi i politikës V	119,414,160	0	8.1%
Qëllimi i politikës VI	189,252,088	170,200,000	24.5%
Qëllimi i politikës VII	83,866,868	0	5.7%
Qëllimi i politikës VIII	46,463,272	0	3.2%


Kostoja korente	1,045,375,150
Kostoja kapitale	421,233,500
Kostoja totale	1,466,608,650



Nevojat (në lekë)

Qëllimi i politikave	Natyra/tipologjia e kostove	Kostoja totale 2020–2025	Kostot e planifikuara PBA 2021–2023 Buxheti dhe donatorët	Kostoja për t'u planifikuar në buxhetin 2024–2025	Hendeku financiar 2021–2025
P1: Të ofrohet akses i barabartë në shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara.	Korente	162,986,704	65,661,632	50,590,976	56,796,596
	Kapitale	126,488,500	94,725,500	21,700,500	
P2: Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.	Korente	89,539,632	11,384,346	149,734,397	52,620,889
	Kapitale	124,545,000	0	345,000	
P3: Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe nxitja e mundësive të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara.	Korente	135,445,952	75,196,704	44,818,448	15,430,800
	Kapitale	0	0	0	
P4: Ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësorë për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.	Korente	218,406,474	86,929,578	92,657,748	38,819,148
	Kapitale	0	0	0	
P5: Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitimeve të aksesueshme, të përballueshme financiarisht dhe që kanë në qendër klientin.	Korente	119,414,160	66,158,192	41,365,168	11,890,800
	Kapitale	0	0	0	
P6: Realizimi i një kujdesi shëndetësor të aksesueshëm e të përballueshëm për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.	Korente	189,252,088	73,720,544	111,692,264	38,339,280
	Kapitale	170,200,000	34,500,000	101,200,000	
P7: Garantimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike në Shqipëri dhe mundësimi i mbrojtjes së interesave të tyre.	Korente	83,866,868	30,101,502	22,310,966	31,454,400
	Kapitale	0	0	0	
P8: Krijimi i sinergjive ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm, për nxitjen dhe monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të plotë, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.	Korente	46,463,272	21,987,776	7,775,896	16,699,600
	Kapitale	0	0	0	
TOTALI [lekë]		1,466,608,650	560,365,774	644,191,363	262,051,513
TOTALI [euro]		11,827,489	4,519,079	5,195,092	2,113,319
1 euro = 124 lekë					

**NDARJA E SHPENZIMEVE****NATYRA EKONOMIKE E KOSTOVE TË
Planit të Veprimit**



UDHËZIM
Nr. 2, datë 5.5.2021

**PËR KRITERET E KUALIFIKIMIT
DHE KATEGORITË E DREJTIMIT TË
MJETEVE LUNDRUESE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 102 e 401, germa “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 5, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare në Republikën e Shqipërisë”, nenit 4, pika 7, e ligjit nr. 127/2020, “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit”,

UDHËZOJ:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka si qëllim të rregullojë procedurat e trajnimit dhe testimit të kandidatëve për t'u

pajisur me dëshmi aftësie për drejtimin e mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtim sipas kategorive dhe zonave të lundrimit, kriteret që duhet të plotësojnë qendrat e trajnimit dhe metodikat trajnuese teorike dhe praktike që do të përdoren.

Neni 2
Përkufizime

Në zbatim të këtij udhëzimi përdoren termat e mëposhtëm:

1. *Mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtim* – janë mjetet sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me tonazh nën 500 GT që kanë një fuqi të përgjithshme të motorit ose të motorëve të marrë së bashku më të lartë se 30 *kw* ose 40.8 KF, të klasifikuara si të tilla nga Regjistri Detar Shqiptar ose nga institucionet korresponduese të shteteve të tjera, që përdoren për qëllime turistike dhe argëtimi.

2. *Dëshmi aftësie* – certifikatë profesionale për drejtimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim sipas kategorive dhe zonave të lundrimit të përcaktuara në këtë udhëzim.



3. *Qendër trajnimi* – subjekt i licencuar nga autoritetet e licencimit për trajnimin e kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuar në licencë dhe kriterëve specifike të përcaktuara në legjislacionin ndërkombëtar detar.

4. *Certifikatë trajnimi* – certifikatë e lëshuar nga Qendra e Trajnimit mbas përfundimit të trajnimit teorik dhe praktik.

Neni 3

Qendrat e trajnimit dhe kriteret e veprimtarisë

1. Qendrat e trajnimit duhet të plotësojnë kriteret teknike dhe profesionale të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Qendrat e trajnimit zhvillojnë veprimtari trajnuese, instruktuese për formimin e drejtuesve të mjeteve të tjera të vogla lundruese, sipas përcaktimeve të licencës.

3. Qendrat e trajnimit që zhvillojnë veprimtari trajnuese për pajisjen e kandidatëve me dëshmi aftësie të kategorive “C” dhe “D”, të përcaktuara në këtë rregullore, përveç përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, duhet të plotësojnë edhe kriteret bazë për trajnimin dhe certifikimin e detarëve, të përcaktuara në Konventën Ndërkombëtare Detare STCW.

Neni 4

Qendrat e trajnimit për dëshmi aftësie kategoritë “A” dhe “B”

1. Qendrat e trajnimit që zhvillojnë veprimtari trajnuese për pajisjen e kandidatëve me dëshmi aftësie të kategorive “A” dhe “B”, të përcaktuara në këtë udhëzim, duhet të kenë:

a) Ambiente funksionale, ku përfshihen:

i. një klasë me ambient të mjaftueshëm dhe funksional, të ndarë nga zyrat e tjera ose nga zyra e pritjes së publikut. Klasa duhet të ketë ndriçim dhe ventilim të mjaftueshëm, si dhe mjetet e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri (MNZ);

ii. ambient hidrosanitar sipas rregullave në fuqi dhe me ujë të vazhdueshëm, brenda ambientit të qendrës së trajnimit;

iii. një tavolinë për mësuesin e teorisë;

iv. një tabelë shkrimi, prej dërrase ose xhami, me përmasa minimale 1.1m x 0.8 m;

v. tavolina dhe ndenjësë të përshtatshme, të vendosura në distancë të përshtatshme.

b) Materialet didaktike për mësimet e teorisë dhe praktikës ku përfshihen:

i. manuali i trajnimit teorik ku të jenë të përfshira temat e trajnimit, të ilustruara me figura shpjeguese;

ii. një seri tabelash me sinjale detare (dritat, bovat, fenerët dhe shenja të tjera);

iii. maket të një mjeti të vogël lundrues me të gjitha pajisjet e nevojshme të tij;

iv. kutia e ndihmës së shpejtë;

v. mjetet fikse të zjarrit;

vi. mjetet e shpëtimit të jetës në det;

vii. mjeti i vogël lundrues i pajisur me dokumentacion të vlefshëm.

Neni 5

Qendrat e trajnimit për dëshmi aftësie kategoritë “C” dhe “D”

Qendrat e trajnimit që zhvillojnë veprimtari trajnuese për pajisjen e kandidatëve me dëshmi aftësie të kategorisë “C” dhe “D”, përveç përcaktimeve në pikat “a” dhe “b”, të nenit 4, duhet të jenë të pajisura edhe me:

a) ambiente të dedikuara për zhvillimin e praktikës;

b) aparatura navigacionale (radar, busulla, radio, naftex, AIS etj.) për qëllim trajnimi;

c) harta detare me shkallë të ndryshme.

Neni 6

Dokumentet që administrohen nga qendrat e trajnimit

1. Licenca e veprimtarisë për qendrat e trajnimit, të marrë nga QKB-ja.

2. Dokumenti i identifikimit të titullarit të licencës dhe trajnuesit/trajnuesve.

3. Manuali i trajnimit teorik.

4. Rregullorja për funksionimin e Qendrës së Trajnimit ku janë përcaktuar:

a) orari ditor dhe ditët e veprimtarisë;

b) orët e zhvillimit të seancave të teorisë dhe praktikës;

c) detyrat dhe të drejtat e personelit;

d) detyrat dhe të drejtat e kandidatit;

e) kushtet e marrëveshjes me kandidatin dhe përcaktimi i tarifave të shërbimit.



5. Dokumentacioni i mjetit detar që do të përdoret për ushtrimin e praktikës. Nëse mjeti është marrë me qira, kontrata e marrjes me qira.

6. Dëshmitë e aftësisë profesionale të trajnuesit të teorisë dhe të praktikës, vërtetuar me CV-në personale, trajnime, certifikime.

7. Kontratat e punësimit (të lidhur midis titullarit të licencës dhe trajnuesit).

8. Regjistri i kandidatëve që trajnohen për drejtues mjeti të vogël lundrues.

Neni 7

Trajnerët e teorisë dhe të praktikës

1. Qendrat e trajnimit duhet të kenë të paktën një trajner për teorinë dhe praktikën.

2. Trajnerët e teorisë dhe praktikës duhet të jenë të pajisur me dëshmi të aftësive profesionale në fushën e detarisë, vërtetuar me CV-në personale, trajnime, certifikime.

Neni 8

Procedura e për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë së qendrave të trajnimit

1. Pas dorëzimit nga Qendra e Trajnimit të dokumenteve të përcaktuara në nenin 6, të këtij udhëzimi, DPD-ja, ka afat 30 ditë për të kryer verifikimet e nevojshme mbi plotësimin e kriterëve teknike dhe profesionale të Qendrës së Trajnimit për të ushtruar veprimtarinë sipas përcaktimeve të licencës. Verifikimi bëhet nga një Komision i ngritur nga drejtori i përgjithshëm i DPD-së, i cili ka në përbërje jo më pak se tre anëtarë.

2. Në përfundim, Komisioni harton procesverbalin e verifikimit ku do të përshkruhet qartë nëse Qendra e Trajnimit i plotëson ose jo kriterëve teknike dhe profesionale dhe të listojë mangësitë nëse ka.

3. Mbi bazën e licencës dhe të procesverbalit “Mbi verifikimin e kushteve për Qendrën e Trajnimit”, drejtori i përgjithshëm i DPD-së miraton ose refuzon kërkesën e qendrës për ushtrimin e aktivitetit.

Neni 9

Vendndodhja dhe transferimi

1. Qendra e Trajnimit duhet të afishojë në selinë e saj, ditët dhe orët e punës për mësimet teorike dhe praktike. Ndryshimi i vendndodhjes së Qendrës së Trajnimit bëhet duke paraqitur kërkesë me shkrim pranë DPD-së, 30 ditë përpara se të bëhet transferimi. Ndryshim i vendndodhjes së Qendrës së Trajnimit bëhet sipas ndryshimeve që bëhen në licencën e zhvillimit të veprimtarisë në QKB.

2. Në rast ndryshimi të vendndodhjes së aktivitetit të Qendrës së Trajnimit, pa bërë ndryshimet në QKB dhe pa u verifikuar nga DPD-ja aktiviteti i Qendrës së Trajnimit pezullohet për një periudhë nga një deri në tre muaj.

Neni 10

Regjistrimi i kandidatëve

1. Regjistrimi i personave të interesuar për t'u pajisur me dëshmi aftësie bëhet në qendrat e trajnimit.

2. Kandidati i interesuar për t'u pajisur me dëshmi aftësie, duhet:

- të plotësojnë kërkesat e moshës minimale të lejuar;
- të paraqesë vërtetim mbi gjendjen shëndetësore sipas kategorisë që trajnohet;
- dokument identifikimi të vlefshëm;
- katër fotografi të nxjerra jo më vonë se 6 muaj përpara.

Neni 11

Regjistrimi i kandidatëve me nënshtetësi të huaj

1. Të gjithë personat e interesuar, që nuk janë shtetas shqiptarë, por që kanë leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë apo dokument tjetër identifikues lëshuar nga autoritetet shqiptare mund të pajisen me dëshmi aftësie, pasi të paraqesin dokumentet e përcaktuara në nenin 10, të kësaj rregulloreje.

2. Rregullat e përgatitjes dhe të testimit për të marrë dëshmi aftësie të mjetit lundrues për këta persona janë të njëjta si për shtetasit shqiptarë.

3. Në testimin e njohurive teorike dhe praktike, për pajisje me dëshmi aftësie, personi i interesuar



ka të drejtë të asistohet me përkthyes të zgjedhur prej tij.

Neni 12

Paraqitja e kandidatëve për testim teorik dhe praktik

1. Testimi teorik dhe praktik zhvillohet në kohën dhe vendin e caktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

2. Qendrat e trajnimit, 24 orë para, depozitojnë pranë Drejtorisë e Përgjithshme Detare listën me kandidatët që kanë mbaruar trajnimin dhe do të testohen, duke përcaktuar llojin e testimit sipas kategorive të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Njoftimet për trajnim do të protokollohen në protokollin e Drejtorisë.

4. Kandidatët që paraqiten për testim duhet të jenë të pajisur me mjet identifikues.

Neni 13

Përcaktimi i zonave të lundrimit

1. Në zbatim të këtij udhëzimi, zonat e lundrimit për mjetet e tjera të vogla lundruese do të ndahen në:

- a) zona e lundrimit I – mbulon lundrimin në det, mbi 6 milje nga bregu;
- b) zona e lundrimit II – mbulon lundrimin në det, por jo më shumë se 6 milje nga bregu;
- c) zona e lundrimit III – mbulon lundrimin në det, por jo më shumë se 3 milje nga bregu;
- d) zona e lundrimit IV – mbulon lundrimin në det, lumenj dhe liqene në distancë jo më të madhe se 1 milje nga bregu.

Neni 14

Kategoritë e dëshmimeve të aftësisë

1. Në zbatim të këtij udhëzimi, kategoritë e dëshmimeve të aftësisë për mjetet e tjera të vogla lundruese do të ndahen në:

- a) dëshmia e aftësisë kategoria “A” – zona e lundrimit “IV”;
- b) dëshmia e aftësisë kategoria “B” – zonat e lundrimit “III” dhe “IV”;
- c) dëshmia e aftësisë kategoria “C” – zonat e lundrimit “II”, “III” dhe “IV”;
- d) dëshmia e aftësisë kategoria “D” – zonat e lundrimit “I”, “II”, “III” dhe “IV”.

Neni 15

Dëshmia e aftësisë kategoria “A” dhe kriteret e veçanta

1. Kjo dëshmi i lëshohet një personi i cili mund të drejtojë një mjetet tjetër të vogël lundrues me largim deri 1 milje nga bregu dhe që lejohet të lundrojnë në zonën IV të lundrimit; dhe:

- a) është mbi 16 vjeç;
- b) ka përfunduar kursin e trajnimit në një nga qendrat e trajnimit sipas shtojcës përkatëse të përcaktuar në këtë udhëzim;
- c) paraqet një raport shëndetësor “i aftë për punë”;
- d) kalon me sukses testimin teorik dhe praktik të përcaktuar në këtë rregullore.

2. Kjo dëshmi aftësie lëshohet më afat vlefshmërie 5 vjet me të drejtë rinovimi shoqëruar me raport mjekësor “i aftë për punë”.

Neni 16

Dëshmia e aftësisë kategoria “B” dhe kriteret e veçanta

1. Kjo dëshmi i lëshohet një personi, i cili mund të drejtojë një mjetet tjetër të vogël lundrues me largim deri 3 milje nga bregu dhe që lejohet të lundrojnë në zonën III të lundrimit dhe duhet të plotësojë këto kriteret të veçanta:

- a) është mbi 16 vjeç;
- b) ka përfunduar kursin e trajnimit në një nga qendrat e trajnimit sipas shtojcës përkatëse të përcaktuar në këtë udhëzim;
- c) paraqet një raport shëndetësor “i aftë për punë”;
- d) kalon me sukses testimin teorik dhe praktik të përcaktuar në këtë rregullore.

Mbajtësit e dëshmisë së aftësisë kategoria “A” për të paktën tre vjet, pasi të ketë kaluar me sukses vetëm testimin teorik për këtë lloj kategorie.

2. Kjo dëshmi aftësie lëshohet më afat vlefshmërie 5 vjet, me të drejtë rinovimi, shoqëruar me një raport mjekësor “i aftë për punë”.

Neni 17

Dëshmia e aftësisë kategoria “C” dhe kriteret e veçanta

1. Kjo dëshmi i lëshohet një personi, i cili mund të drejtojë një mjet tjetër të vogël lundrues me



largim deri 6 milje nga bregu dhe që lejohet të lundrojnë në zonën II të lundrimit duhet të plotësojnë këto kriteret të veçanta:

a) është mbi 18 vjeç;

b) ka përfunduar kursin e trajnimit në një nga qendrat e trajnimit sipas shtojcës përkatëse të përcaktuar në këtë udhëzim;

c) paraqet një raport mjekësor “i aftë për punë”;

d) kalon me sukses testimin teorik dhe praktik; ose

Personat e pajisur me dëshmi aftësie për kategorinë “B” prej të paktën tre vjet, mund të pajisen me dëshmi aftësi të kategorisë “C” nëse do të kalojnë me sukses vetëm testimin teorik sipas kësaj kategorie.

2. Kjo dëshmi aftësie lëshohet më afat vlefshmërie 5 vjet me të drejtë rinovimi, duke paraqitur raport të gjendjes shëndetësore kryesisht për shikimin dhe dëgjimin.

Neni 18

Dëshmia e aftësisë kategoria “D” dhe kriteret e veçanta

1. Kjo dëshmi i lëshohet një personi, i cili mund të drejtojë një mjet tjetër të vogël lundrues me largim deri 12 milje nga bregu dhe që lejohet të lundrojnë në zonën I të lundrimit duhet të plotësojnë këto kriteret të veçanta:

a) është mbi 18 vjeç;

b) ka përfunduar kursin e trajnimit në një nga qendrat e trajnimit sipas shtojcës përkatëse të përcaktuar në këtë udhëzim;

c) është i aftë nga ana shëndetësore kryesisht për shikimin dhe dëgjimin;

d) kalon me sukses testimin teorik dhe praktik të përcaktuar në këtë udhëzim; ose

Personat e pajisur me dëshmi aftësie për kategorinë “C” prej të paktën tre vjet, mund të pajisen me dëshmi aftësi të kategorisë “D” nëse do të kalojnë me sukses vetëm testimin teorik sipas kësaj kategorie.

2. Kjo dëshmi aftësie lëshohet më afat vlefshmërie 5 vjet me të drejtë rinovimi, duke paraqitur raport të gjendjes shëndetësore kryesisht për shikimin dhe dëgjimin.

Neni 19

E drejta për tu pajisur me dëshmi aftësie kategoritë “A” dhe “B”

1. I lind e drejta të pajiset me dëshmi aftësie të kategorive “A” dhe “B”, pa qenë nevoja të kryejë kurset e trajnimit të përcaktuara në këtë udhëzim çdo personi, që:

a) ka kryer arsimin e lartë *Bachelor* dega navigacion ose inxhinieri detare; është i aftë nga ana shëndetësore për “punë”; ose

b) zotëron certifikatë kompetence II/1 ose II/2 ose II/3, sipas kodit STCW; ose;

c) zotëron certifikatë të tipit II/5, III/1, III/2, III/3, sipas kodit STCW; është i aftë nga ana shëndetësore për “punë”, kalon me sukses vetëm testimin teorik të përcaktuar për këtë kategori.

2. Pajisja me dëshmi aftësie e personave që plotësojnë kriteret e pikave “a” dhe “b”, të këtij neni, do të bëhet nga Sektori i Regjistrimit të Mjeteve të Vogla Lundruese dhe Detarëve pasi të jetë grumbulluar dokumentacioni i kërkuar në këto pika.

Neni 20

E drejta për t'u pajisur me dëshmi aftësie kategoria “C”

1. I lind e drejta të pajiset me dëshmi aftësie të kategorisë “C”, pa qenë nevoja të kryejë kurset e trajnimit të përcaktuara në këtë udhëzim, çdo personi, që:

a) ka kryer arsimin e lartë *Bachelor* dega navigacion, është i aftë nga ana shëndetësore për “punë”, ka të paktën 3 muaj eksperiencë lundrimore, kalon me sukses vetëm testin teorik sipas kësaj kategorie; ose

b) zotëron certifikatë kompetence II/1 ose II/2 ose II/3, sipas kodit STCW; ose

c) zotëron certifikatë të tipit II/5, III/1, III/2, III/3, sipas kodit STCW, është i aftë nga ana shëndetësore për “punë”, ka të paktën 12 muaj eksperiencë lundrimore, kalon me sukses vetëm testin teorik sipas kësaj kategorie; ose

d) ka të paktën 24 muaj eksperiencë lundrimi në anije përfshirë anijet e peshkim dhe anijet e shërbimeve portuale; kalon me sukses vetëm testin teorik sipas kësaj kategorie.

2. Pajisja me dëshmi aftësie e personave që plotësojnë kriteret e pikave “a” dhe “b”, të këtij



neni, do të bëhet nga Sektori i Regjistrimit të Mjeteve të Vogla Lundruese dhe Detarëve pasi të jetë grumbulluar dokumentacioni i kërkuar në këto pika.

Neni 21

E drejta për tu pajisur me dëshmi aftësie kategoria “D”

1. I lind e drejta të pajiset me dëshmi aftësie të kategorisë “D”, pa qenë nevoja të kryej kurset e trajnimit të përcaktuara në këtë udhëzim çdo personi, që:

a) ka kryer arsimin e lartë dega navigacion, është i aftë nga ana shëndetësore kryesisht për shikimin dhe dëgjimin, ka të paktën 6 muaj eksperiencë lundrimore; ose

b) zotëron certifikatë kompetence II/1 ose II/2, sipas kodit STCW; ose

c) zotëron certifikatë të tipit II/3, II/5, III/1, III/2, sipas kodit STCW, është i aftë nga ana shëndetësore kryesisht për shikimin dhe dëgjimin, ka të paktën 24 muaj eksperiencë lundrimore. Kalon me sukses vetëm testin teorik sipas kësaj kategorie; ose

d) ka të paktën 36 muaj eksperiencë lundrimi në anije përfshirë anijet e peshkimit dhe anijet e shërbimeve portuale, kalon me sukses vetëm testin teorik sipas kësaj kategorie.

2. Pajisja me dëshmi aftësie e personave që plotësojnë kriteret e pikave “a” dhe “b”, të këtij neni, do të bëhet nga Sektori i Regjistrimit të Mjeteve të Vogla Lundruese dhe Detarëve pasi të jetë grumbulluar dokumentacioni i kërkuar në këto pika.

Neni 22

Komisioni i Testimit

1. Testimi i personave që i plotësojnë kriteret e nevojshme bëhet nga Komisioni i Testimit.

2. Përbërja dhe afati i funksionimit të Komisionit të Testimit përcaktohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

3. Për kategori të veçanta të dëshmiave të aftësisë, komisionet e testimit mund të jenë të veçanta. Komisioni i Testimit përbëhet nga tre anëtarë, një prej të cilëve do të jetë kryetar i Komisionit. Kryetari i Komisionit duhet të ketë

njohuri dhe eksperiencë praktike në fushën e detarisë.

4. Në raste të veçanta, Komisioni i Testimit mund të kryejë funksionin e tij edhe nëse përbëhet nga të paktën dy anëtarë.

5. Komisioni i Testimit formulon dhe miraton testet e testimit teorik për kandidatët. Për formulimin e testit teorik, Komisioni do të bazohet në identifikimin e të gjitha njohurive që përmbajnë manualët e trajnimit sipas kategorive të përcaktuara në këtë udhëzim.

6. Formularët e testimit, për kategori të ndryshme, përpilohen në të paktën tri variante të ndryshme.

7. Në formularët e testimit, që nuk janë në formë elektronike, duhet të identifikohet me shkrim dore nga vetë kandidati, data e testimit, emri/mbiemri i personit që testohet, numri personal i identifikimit dhe nënshkrimi i tij në të gjitha fletët e testit.

8. Kandidati do të konsiderohet kalues në testin teorik nëse plotëson të paktën 70% të testit ose grumbullon 70% të pikëve të përcaktuara në test.

9. Kandidati do të konsiderohet kalues në testin praktik në gjykimin profesional të anëtarit/ve të Komisionit.

Neni 23

Procedurat e testimit

1. Testimi teorik i kandidatëve do të mbikëqyret nga Komisioni i Testimit.

2. Testimi praktik kryhet në det me mjetin e vogël lundrues të Qendrës së Trajnimit, nën mbikëqyrjen e të paktën njërit prej anëtarëve të Komisionit.

3. Vetëm kandidatët që përfundojnë me sukses testimin teorik kanë të drejtë të kryejnë testimin e praktikës në det.

4. Vetëm kandidatët, të cilët përfundojnë me sukses testimin teorik dhe praktik, kanë të drejtë të pajisen me dëshmi aftësie për drejtimin e mjeteve të tjera të vogla lundruese, sipas kategorisë së testimit.

5. Kandidatët, të cilët rezultojnë jokalue në njërin nga testimet, kanë të drejtë që të rritestohen. Ritestimi do të kryhet vetëm për llojin e testimit që kandidati ka rezultuar jokalue. Afati kohor për ritestim nuk duhet të jetë më vonë se dy muaj.



6. Në përfundim të testimit teorik dhe praktik, Komisioni i Testimit përpilon një procesverbal në tri kopje ku duhet të identifikohet:

- a) data kur është kryer testimi;
- b) Qendra e Trajnimit ku kandidati është trajnuar;
- c) lista rendore e kandidatëve që kanë kaluar me sukses testimin teorik dhe praktik;
- d) kategoria e dëshmisë së aftësisë që do të lëshohet për çdo kandidat.

7. Procesverbali do të firmoset nga anëtarët e Komisionit dhe do të protokollohet në protokollin e Drejtorisë.

Neni 24

Certifikata e trajnimit

1. Certifikata e trajnimit duhet të përpilohet në gjuhën shqipe dhe/ose angleze nga Qendra e Trajnimit dhe do t'i lëshohet personit të trajnuar mbasi të ketë kaluar me sukses testimin teorik dhe praktik dhe do të jetë e firmosur nga administratori i shoqërisë trajnuese dhe me vulën përkatëse të shoqërisë.

2. Në certifikatën e trajnimit, duhet të identifikohen:

- a) logoja e shoqërisë trajnuese;
- b) numri i certifikatës;
- c) lloji i trajnimit sipas kategorive;
- d) numri i regjistrimit;
- e) gjeneralitetet e personit të certifikuar, numri i kartës së identitetit/pasaportës;
- f) fotografi e personit të certifikuar;
- g) periudha kohore e trajnimit... nga data... deri datë;
- h) titulli/përmbajtja e trajnimit të kryer;
- i) vendi ku është kryer trajnimi;
- j) administratori, firma, vula;
- k) adresa e Qendrës së Trajnimit dhe kontaktet telefonike.

Neni 25

Dëshmia e aftësisë

1. Dëshmia e aftësisë sipas kategorive të përcaktuara në këtë udhëzim do të lëshohet nga Sektori i Regjistrimit të Mjeteve të Vogla Lundruese dhe Detarëve.

2. Dëshmia e aftësisë do të përpilohet në gjuhën shqipe dhe angleze.

3. Format i dëshmisë së aftësisë do të jetë sipas përcaktimit në shtojcën 5, të këtij udhëzimi.

4. Dëshmia e aftësisë do të mbajë firmën dhe vulën e përgjegjësit të Sektorit të Regjistrimit të Mjeteve të Vogla Lundruese dhe Detarëve.

5. Procedurat që duhet të ndjekë kandidati fitues për t'u pajisur me dëshmi aftësie do të bëhen nëpërmjet portalit *online* e-Albania të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

Neni 26

Grumbullimi i dokumentacionit të testimit

Komisioni i testimit duhet të krijojë dosje të veçanta për secilën shoqëri trajnimi dhe do të grumbullojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) njoftimin për testim nga shoqëria e trajnimit;
- b) një kopje të procesverbalit të testimit për secilën shoqëri trajnimi;
- c) testet e plotësuar dhe të korrigjuara të personave të testuar;
- d) fotokopje e firmosur e certifikatës së trajnimit të çdo personi të testuar.

Neni 27

E drejta që lind nga dëshmia e aftësisë për qëllime ekonomike sipas kategorisë

1. Çdo person, që zotëron një dëshmi aftësie të vlefshme sipas kategorisë "C", i lejohet:

- a) të drejtojë një mjet detar për transportin e brendshëm dhe turistik të pasagjerëve:
 - i. në zonat e lundrimit "III" dhe "IV";
 - ii. numri i pasagjerëve nuk është më shumë se 100 pasagjerë;
- b) të drejtojë një anije peshkimi që përdor trata dhe peshkim selektiv;
 - i. në zonat e lundrimit "II", "III" dhe "IV";
- c) të drejtojë një mjet lundrues për shërbimet portuale.

2. Çdo person që zotëron një dëshmi aftësie të vlefshme sipas kategorisë "D", i lejohet:

- a) të drejtojë një mjet detar për transportin e brendshëm dhe turistik të pasagjerëve:
 - i. në zonat e lundrimit "II", "III" dhe "IV";
 - ii. numri i pasagjerëve mund të jetë më shumë se 100 pasagjerë;
 - iii. mjeti lundrues nuk është më shumë se 500 GT;



b) të drejtojë një anije peshkimi që përdor trata dhe peshkim selektiv.

i. në zonat e lundrimit “II”, “III” dhe “IV”;

c) të drejtojë një mjet lundrues për shërbimet portuale.

Neni 28

Dëshmitë e aftësisë “Skipper”

1. Dëshmitë e aftësisë “Skipper” lëshuar përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi do të vlerësohen dhe do të konvertohen në dëshmi aftësie të kategorisë “B”.

2. Konvertimi i dëshmisë do të kryhet pranë Zyrës së Regjistrimit të Mjeteve të Vogla dhe Detarëve, duke dorëzuar dëshminë “Skipper”.

3. Dëshmitë e aftësisë “Skipper”, të grumbulluara mbas konvertimit, do të administrohen nga Zyra e Regjistrimit të Mjeteve të Vogla dhe Detarëve, sipas procedurave të nxjerra nga DPD-ja.

Neni 29

Anijet turistike të tipit jahte dhe kroçera

1. Ekuipazhi i anijeve turistike, me fuqi motorike më të madhe se 40.8 KF dhe deri në 500 GRT dhe që kryejnë lundrime mbi 12 milje detare nga bregu për qëllime ekonomike, duhet të certifikohet sipas parashikimeve të Konventës STCW Manila 2010.

2. Drejtuesit e anijeve turistike, me fuqi motorike më të madhe se 40.8 KF dhe deri në 500 GRT dhe që kryejnë lundrime mbi 12 milje detare nga bregu, por jo për qëllime ekonomike duhet të jenë të pajisur me dëshmi aftësie kategoria “D”.

Neni 30

Auditim dhe inspektimi i qendrave të trajnimit

1. Qendrat e trajnimit auditohen nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

2. Auditimi i qendrave të trajnimit realizohet për një periudhë jo më pak se një herë në vit.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare mund të auditojë qendrat e trajnimit pas një njoftimi paraprak jo më pak se tri ditë kalendarike.

4. Drejtoria e Përgjithshme Detare përcakton procedurat e auditimit të qendrave të trajnimit.

5. Me qëllim zbatimin e kriterëve të kualifikimit të kryerjes së trajnimeve nga qendrat e trajnimit, Drejtoria e Përgjithshme Detare mund të bëjë inspektime të menjëhershme dhe pa paralajmërim të këtyre qendrave trajnuese.

Neni 31

Pezullimi i dëshmisë të aftësisë

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare ka të drejtë të pezullojë dëshminë e aftësisë në rast se zotëruesi i dëshmisë i saj:

a) drejton një mjet detar në kundërshtim me parashikimet e këtij udhëzimi;

b) nuk zbaton urdhrat, udhëzimet dhe instruksionet e Kapitenerisë së Portit;

c) nuk zbaton rregullat e lundrimit dhe parandalimit të përplasjeve;

d) nuk njofton Kapitenerinë e Portit në rast se shkakton ndotje detare;

e) nuk respekton regjimin e lundrimit në lidhje me distancën e lejuar nga bregu;

f) drejton një mjet në gjendje të dehur ose nën efektin e lëndëve narkotike;

g) nuk është i aftë nga ana shëndetësore.

2. Pezullimi i dëshmisë së aftësisë, për rastet e shkeljeve të përmendura në pikën 1, të këtij neni, mund të aplikohet për një periudhë nga një muaj deri në një vit.

Neni 32

Masat administrative ndaj qendrave të trajnimit

1. Për qendrat e trajnimit, të cilat kryejnë aktivitetin e tyre në kundërshtim me parashikimet e këtij udhëzimi edhe pas njoftimit nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, në mënyrë të përshkallëzuar, merren këto masa administrative:

a) paralajmërim për pezullim aktiviteti;

b) pezullim aktiviteti deri në gjashtë muaj;

c) pezullim i aktivitetit të trajnimit deri në dy vjet.

2. Masat administrative, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vendosen nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

3. Menjëherë pas dhënies së masës, Drejtoria e Përgjithshme Detare informon me shkrim ministrin përgjegjës për transportin për llojin,



shkaqet dhe provat e evidentuara për vendosjen e masës ndaj Qendrës së Trajnimit.

Neni 33

Dispozitat transitorë dhe të fundit

1. Dëshmitë e aftësisë “Skipper” do të lëshohen në formatin ekzistues për një afat jo më shumë se një vit me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

2. Drejtoria e Përgjithshme Detare, me hyrjen në fuqi të udhëzimit, duhet të marrë masa për zbatimin e tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

SHTOJCË 1

PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR DËSHMITË E AFTËSISË KATEGORIA “A”

1. Njohuritë mbi lundrimin e sigurt me mjetin *jet ski* ku të përfshihet, familjarizimi i personave që trajnohen me mjetin nëpërmjet leximit të manualit të përdorimit mbi funksionimin dhe përdorimin e tij.

2. Njohuritë mbi procedurat e ndezjes dhe fikjes së motorit.

3. Njohuritë mbi rregullat e përdorimit të mjetit, rregullat për parandalimin e aksidentëve detare, njohuri mbi kufizimet detare dhe plazheve publike e private, njohuri mbi përdorimin e mjeteve të shpëtimit (xhaketonit të shpëtimit).

SHTOJCË 2

PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR DËSHMITË E AFTËSISË KATEGORIA “B”

1. Manuali i trajnimit për t’u pajisur me dëshmi aftësie, për mjetet e vogla lundruese kategoria “B”, duhet të përfshijë temat e mëposhtëm:

I. informacion të përgjithshëm mbi detarinë dhe mbi funksionimin e institucioneve shtetërore që merren me veprimtaritë detare;

II. njohuritë mbi lundrimet bregdetare, përgatitja e mjetit për lundrim, përcaktimet e kurseve të lundrimit, shmangien e rreziqeve detare, parashikimi i motit etj.;

III. njohuritë mbi lundrimin e sigurt, përdorimi i mjeteve të shpëtimit, mjeteve zjarrfikëse, dhënia e ndihmës së parë, sinjalet e rrezikut, përdorimin e mjeteve të komunikimit, lundrimi në kohë të keqe dhe me pamje të kufizuar;

IV. njohuritë e përgjithshme mbi verifikimin e gjendjes fizike të mjetit, akostim-çakostimin e mjetit me këmbë, bord, kalimi në kanale dhe zona të kufizuara, bovat orientuese, dritat e lundrimit, orientimi astronomik në vijat e përgjithshme;

V. njohuritë mbi veprimet që duhet të ndërmerren në raste të emergjencës, si: zjarr në mjet, rënie në cekëtinë, përplasje etj.;

VI. njohuritë mbi mirëmbajtjen e mjetit, përgjegjësitë për ndotjet detare dhe detyrimi për parandalimin e ndotjeve detare.

2. Programi trajnues duhet të përfshijë trajnimin teorik dhe praktik të kandidatëve.

SHTOJCË 3

PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR DËSHMITË E AFTËSISË KATEGORIA “C”

	FUSHA E TRAJNIMIT	ORËT	
		Trajnim teorik	Trajnim praktik
1	LUNDRIM		
1.1	Hartat detare, njohuri mbi (llojin, përmbajtjen e hartës, shkallën)	3.0	1.0
1.1.1	Leximi i hartave		
1.1.2	Hedhja e kursit		
1.1.3	Matja e distancës në hartë		
1.1.4	Hedhja e vendndodhjes së anijes në hartë		
1.2	Njohuri mbi:	6	2.0
1.2.1	radarët, parimi i punës, matja e distancës me radar, interference e radarit dhe shenjat false;		
1.2.2	sistemi i lundrimit me satelit: GPS, përcaktimi i pozicionit të anijes		



	nëpërmjet sistemit GPS;		
1.2.3	busulla, leximi dhe përdorimi i busullës, gabimi i busullës;		
1.2.4	fenerët dhe renditja e tyre, bovat, llojet dhe përdorimi i tyre.		
1.3	Planifikimi i lundrimit	0.5	-
2	Mashina dhe masat mbrojtëse	3	0.5
2.1	Pajisjet lëvizëse mekanike, ndarja		
2.1.1	Konceptet themelore të funksionimit, përgatitja për operim; vënia në punë dhe ndalimi		
2.1.2	Mënyrat e referimit; lubrifikimi dhe ftohja		
2.1.3	Instrumentet kontrolluese, përcaktimi i defektit dhe eliminimi i tij, bateritë, karburanti (masat paraprake përpara dërgesës)		
2.2	Aparaturat e luftës kundër zjarrit dhe praktika e luftës kundër zjarrit	1.0	0.5
2.3	Parandalimi i ndotjeve	1.5	-
2.3.1	Burimi i ndotjes		
2.3.2	Masat paraprake, monitorimi i punës dhe procedurat e parandalimit të ndotjes		
2.3.3	Metodat dhe manualët për parandalimin e ndotjes detare nga anijet		
3	Ligje dhe rregullore	2.5	
3.1	Njohja e legjislacionit kombëtar detar		-
3.1.1	Rregullore për lundrimin në porte, ngushtica, ujërat e brendshme dhe detin territorial		
3.1.2	Boat ID		
3.1.3	Autoriteti portual mbi anijet dhe ekuipazhi i varkës		
3.2	Mjetet e transportit detar	1.5	-
3.2.1	Anije, anije dhe jahte të llojeve të ndryshme, teknologji dhe materialeve të ndërtimit		
3.2.2	Pajisjet e shpëtimit të jetës në det		
3.3	Cimat dhe përdorimi i tyre	-	1.5
3.4	Dhënia e ndihmës së parë	1.5	0.5
3.4.1	Mjetet e ndihmës së parë		
3.4.2	Burimet e dëmtimeve në anije		
3.4.3	Frymëmarrja artificiale		
3.4.4	Ndihma e parë në rast të hipotermisë, ngrirjes dhe temperaturave të larta atmosferike		
3.5	Meteorologjia në përgjithësi	1.5	-
3.5.1	Elementet meteorologjike – temperatura e ajrit, presioni atmosferik, lagështia		
3.5.2	Rrymat ajrore;		
3.5.3	Retë, reshjet, mjegulla, pamshmeria		
3.5.4	Erërat në Adriatik dhe Jon, dallgët, Deti i Vdekur		
3.5.5	Raporte dhe njoftime, koha dhe kushtet e lundrimit		
4.1	Manovrimi i anijeve – termi, llojet e manovrimit dhe kuptimi	3.0	2.5
4.1.1	Njohuri për manovrimin e anijes		
4.1.2	Menaxhimi praktik i anijes në lundrim dhe ankorim		
4.1.3	Kushtet e manovrimit të jashtëm (era, valët, rrymat)		
4.2	Rregulla për shmangien e përplasjeve në det	0.5	0.5
4.2.1	Dritat e lundrimit, sinjalet e ditës		
4.3	Njohuri për procedurat e urgjencës	0.5	0.5
4.3.1	Sinjalet e rrezikut		
TOTALI		26	9.5



SHTOJCË 4
PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR DËSHMITË E AFTËSISË KATEGORIA “D”

	FUSHA E TRAJNIMIT	ORËT	
		Trajnim teorik	Trajnim praktik
1	LUNDRIM		
1.1	Hartat detare, njohuri mbi (llojin, përmbajtjen e hartës, shkallën)	4.0	2.0
1.1.1	Leximi i hartave		
1.1.2	Hedhja e kursit		
1.1.3	Matja e distancës në hartë		
1.1.4	Hedhja e vendndodhjes së anijes në hartë		
1.2	Njohuri mbi:	6	3.0
1.2.1	radarët, parimi i punës, matja e distancës me radar, interference e radarit dhe shenjat false;		
1.2.2	sistemi i lundrimit me satelit: GPS, përcaktimi i pozicionit të anijes nëpërmjet sistemit GPS;		
1.2.3	busulla, leximi dhe përdorimi i busullës, gabimi i busullës;		
1.2.4	fenerët dhe renditja e tyre, bovat, llojet dhe përdorimi i tyre.		
1.3	Planifikimi i lundrimit	1.5	-
2.	Mashina dhe masat mbrojtëse	4	1.5
2.1	Pajisjet lëvizëse mekanike, ndarja		
2.1.1	Konceptet themelore të funksionimit, përgatitja për operim; vënia në punë dhe ndalimi		
2.1.2	Mënyrat e referimit; lubrifikimi dhe ftohja		
2.1.3	Instrumentet kontrolluese, përcaktimi i defektit dhe eliminimi i tij, bateritë, karburanti (masat paraprake përpara dërgesës)		
2.2	Aparaturat e luftës kundër zjarrit dhe praktika e luftës kundër zjarrit	2.0	1.0
2.3	Parandalimi i ndotjeve	3.5	-
2.3.1	Burimi i ndotjes		
2.3.2	Masat paraprake, monitorimi i punës dhe procedurat e parandalimit të ndotjes		
2.3.3	metodat dhe manualët për parandalimin e ndotjes detare nga anijet		
3	Ligje dhe rregullore	2.5	
3.1	Njohja e legjislacionit kombëtar detar		-
3.1.1	Rregullore për lundrimin në porte, ngushtica, ujërat e brendshme dhe detin territorial		
3.1.2	Boat ID		
3.1.3	Autoriteti portual mbi anijet dhe ekuipazhi i varkës		
3.2	Mjetet e transportit detar	2.5	-
3.2.1	Anije, anije dhe jahte të llojeve të ndryshme, teknologjive dhe materialeve të ndërtimit		
3.2.2	Pajisjet e shpëtimit të jetës në det		
3.3	Cimat dhe përdorimi i tyre	-	2.5
3.4	Dhënia e ndihmës së parë	3.5	0.5
3.4.1	Mjetet e ndihmës së parë		
3.4.2	Burimet e dëmtimeve në anije		
3.4.3	Frymëmarrja artificiale		
3.4.4	Ndihma e parë në rast të hipotermisë, ngrirjes dhe temperaturave të larta atmosferike		
3.5	Meteorologjia në përgjithësi	3.5	-
3.5.1	Elementet meteorologjike – temperatura e ajrit, presioni atmosferik, lagështia		
3.5.2	Rrymat ajrore		
3.5.3	Retë, reshjet, mjegulla, pamshmeria		
3.5.4	Erërat në Adriatik dhe Jon, dallgët, Deti i Vdekur		
3.5.5	Raporte dhe njoftime, koha dhe kushtet e lundrimit		
4.1	Manovrimi i anijeve – termi, llojet e manovrimit dhe kuptimi	3.0	2.5
4.1.1	Njohuri për manovrimin e anijes		
4.1.2	Menaxhimi praktik i anijes në lundrim dhe ankorim		
4.1.3	Kushtet e manovrimit të jashtëm (era, valët, rrymat)		
4.2	Rregulla për shmangien e përplasjeve në det	1.5	0.5
4.2.1	Dritat e lundrimit, sinjalet e ditës		
4.3	Njohuri për procedurat e urgjencës	1.5	0.5
4.3.1	Sinjalet e rrezikut		
TOTALI		39	14



SHTOJCË 5
MODELI I DËSHMISË SË AFTËSISË

Dëshmia e aftësisë do të jetë biometrike ku, në anën ballore përmban të dhënat personale dhe mbrapa zonat e lundrimit sipas kategorive.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE	 	REPUBLIC OF ALBANIA MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENERGY GENERAL MARITIME DIRECTORATE
	Emri/Name 2. Mbiemri/Surname 3. Data dhe vendlindja <i>Place and DOB</i> 4. Data e lëshimit <i>Date of issue</i> 5. Lëshuar nga <i>Issued by</i>	Anije Turistike 1.1.2000 Sarandë 1.1.2020 DPD Durrës
NR. 0000000	Kategoria/ Category	

KA	Mbajtësi i kësaj dëshmie aftësie ka të drejtë të:
T	
A	Të drejtojnë një mjet të vogël lundrues jo më shumë se 1 milje nga bregu
B	Të drejtojnë një mjet të vogël lundrues jo më shumë se 3 milje nga bregu
C	Të drejtojnë një mjet të vogël lundrues, anije peshkimi, anije me vela, jaht, anije për shërbime portuale jo më shumë se 6 milje nga bregu
D	Të drejtojnë një mjet të vogël lundrues për qëllime ekonomike, anije peshkimi, anije me vela, jaht, anije për shërbime portuale jo më shumë se 12 milje nga bregu

CAT	The holder of this certificate has competency to operate:
A	A boat in a distance less than 1 mile from coast
B	A boat in a distance less than 3 mile from coast
C	A fishing boat, a sailing boat, a yacht, port services boats in a distance less than 6 mile from coast
D	A fishing boat, a sailing boat, a yacht, for economic purpose, port services boats in a distance less than 12 mile from coast

EMËR MBIEMËR

Lëshuar në/at _____

Datë/date _____

Firma

Vula



URDHËR

Nr. 197, datë 10.5.2021

Neni 2

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR TRANSPORTIN AJROR TË
MALLRAVE TË RREZIKSHME NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 126, të ligjit 96/2020, datë 23.7.2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, nënshkruar më 7 dhjetor 1944 në Çikago, miratuar me dekret të Presidentit nr. 7438, datë 1.12.1990, “Për aderimin në Konventën për Aviacionin Civil (ICAO) dhe në protokollin për tekstin autentik tregjuhësh të kësaj Konvente”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për transportin ajror të mallrave të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

**RREGULLORE
PËR TRANSPORTIN AJROR TË
MALLRAVE TË RREZIKSHME NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

**KAPITULLI 1
KUSHTET E PËRGJITHSHME**

Neni 1

Kjo Rregullore përcakton kushtet dhe procedurat për transportin e sigurt të mallrave të rrezikshme.

1. Termat e përdorur në këtë Rregullore kanë kuptimin e mëposhtëm:

“Listëkontroll pranimi” do të thotë një dokument i përdorur për të ndihmuar në kryerjen e kontrollit të paraqitjes së jashtme të paketimeve të mallrave të rrezikshme dhe dokumenteve të tyre shoqëruese, për të përcaktuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e duhura;

“Avion mallrash” do të thotë çdo avion i cili transporton mallra por jo pasagjerë.

“Mallra të rrezikshme” do të thotë çdo artikull ose substancë, e cila gjatë transportit ajror mund të rrezikojë shëndetin, sigurinë dhe pronën.

“Aksident me mallra të rrezikshme” do të thotë një ngjarje e shoqëruar dhe e lidhur me transportin ajror të mallrave të rrezikshme, e cila rezulton me plagosje fatale ose të rëndë të një personi ose në një dëmtim të madh të pronës.

“Incident me mallra të rrezikshme” do të thotë një ngjarje, ndryshe nga aksidenti me mallra të rrezikshme, e cila:

a) është e shoqëruar dhe e lidhur me transportin ajror të mallrave të rrezikshme, e cila jo domosdoshmërisht ndodh në bord të avionit dhe që rezulton me plagosje të një personi, dëmtim të pronës, zjarr, thyerje, derdhje apo pikime të lëngjeve ose rrezatim, ose ndonjë evidencë tjetër që tregon se nuk është ruajtur integriteti i paketimit; ose

b) lidhet me transportin e mallrave të rrezikshme dhe e cila rrezikon avionin ose personat që janë në të.

“Dokument i mallrave të rrezikshme” do të thotë një dokument i cili është i specifikuar nga udhëzimet teknike dhe përmban informacion rreth mallrave të rrezikshme;

“Kontejner mallrash” do të thotë një mjet për transportin e materialeve radioaktive, i projektuar për të lehtësuar transportin e këtyre materialeve, qoftë të paketuara apo jo dhe nëpërmjet një ose më shumë mënyrash transporti, por që nuk përfshin pajisjen unike të ngarkimit.

“Agjent i përpunimit të mallrave” do të thotë një agjent i cili kryen për llogari të operatorit disa apo të gjitha funksionet e këtij të fundit përfshirë pritjen, ngarkimin, shkarkimin, transferimin ose përpunime të tjera të pasagjerëve ose mallrave.



“Numri ID” do të thotë një numër identifikimi i specifikuar në udhëzimet teknike për një artikull të mallrave të rrezikshme për të cilin nuk është caktuar një numër UN.

“Pako e përbërë” do të thotë bashkimi në një njësi, e përdorur nga një ngarkues i vetëm, i një ose më shumë pakosh dhe formimi i një njësie përpunimi për të lehtësuar përpunimin dhe magazinimin, por që nuk përfshin një pajisje unike të ngarkimit.

“Pako” do të thotë produkti përfundimtar i operacionit të paketimit që konsiston në paketimin dhe përgatitjen e përmbajtjes së saj për transport.

“Paketim” do të thotë kutitë dhe përbërësit ose materialet e tjera të nevojshme për kutinë për të kryer funksionet e saj mbajtëse;

“Emri vetjak i ngarkimit” do të thotë emri që duhet të përdoret për të përshkruar një artikull ose substancë në të gjitha dokumentet e ngarkimit dhe njoftimet dhe, kur është e përshtatshme, në paketimet;

“Plagosje serioze” do të thotë një plagosje që i ka ndodhur një personi në një aksident, e cila:

a) kërkon shtrimin në spital për më shumë se 48 orë, duke filluar brenda shtatë ditësh nga data kur është marrë plaga; ose

b) rezulton në thyerjen e ndonjë kocke (me përjashtim të frakturave të thjeshta të gishtërinjve ose hundës); ose

c) përfshin çarje të cilat shkaktojnë hemorragji të rënda, dëmtim të nervave, muskujve ose tendinëve; ose

d) përfshin dëmtime të organeve të brendshme; ose

e) përfshin djegie të shkallës së dytë ose të tretë, ose çdo djegie që përfshin më shumë se 5% të sipërfaqes së trupit; ose

f) përfshin ekspozim të vërtetuar kundrejt substancave infektive ose dëmtime rrezatimi.

“Udhëzimet teknike” do të thotë, në një kohë të përcaktuar, botimi që është i vlefshëm në atë kohë i dokumentit nr. 9284-AN/905, të titulluar “Udhëzimet teknike për transportin ajror të sigurt të mallrave të rrezikshme”, të hartuar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO).

Shënim 1. Çdo botim i udhëzimeve teknike përcakton në hyrjen e tij datat ndërmjet të cilave ai është i vlefshëm.

Shënim 2. Praktika e përgjithshme e industrisë është që të ndiqen rregullat e mallrave të rrezikshme të IATA-s, të cilat janë botuar në mënyrë më të shpeshtë se udhëzimet teknike. Kërkesat e rregullave të IATA-s janë ose të njëjta ose më të forta se kërkesat e udhëzimeve teknike. Në këtë rast, përputhja me rregullat e IATA-s do të rezultojë automatikisht në përputhjen me udhëzimet teknike.

“Numri i UN-së” do të thotë numri me katër shifra i caktuar nga Komiteti i Eksperteve të Kombeve të Bashkuara për Mallrat e Rrezikshme, për të identifikuar një substancë ose një grup të veçantë substancash.

“Pajisje unike të ngarkimit” do të thotë çdo tip kontejneri ose paletë e projektuar për ngarkimin në një avion, por nuk përfshin një kontejner mallrash për materiale radioaktive ose një pako të përbërë;

“Operator shqiptar” do të thotë një operator avioni i cili zotëron një certifikatë të operatorit ajror të lëshuar nga AAC-ja shqiptare.

2. Për të shmangur dyshimet, çdo referencë në udhëzimet teknike apo në këtë rregullore për marrjen në bord të avionit, ngarkimin në të apo transportin e mallrave të rrezikshme në një avion, për qëllime të kësaj rregulloreje, do të interpretohet, gjithashtu, në vendosjen ose transportin e tyre nën avion, përveç rasteve kur përmbajtja e paraqet atë në mënyrë evidente ndryshe.

Neni 3

Mallrat e rrezikshme do të pranohen për transport ajror në rast se ato janë në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë Rregullore dhe kërkesat dhe procedurat e detajuara në dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet Teknike të ICAO-s për Transportin e Sigurt Ajror të Mallrave të Rrezikshme - Dok. 9284-AN/905 (këtej e tutje të quajtura si “Udhëzime Teknike-TT”);

2. Rregulloret e IATA-s për Transportin e Sigurt të Mallrave të Rrezikshme (këtej e tutje të quajtura si “Rregullore e IATA-s (IR)”);

3. Kërkesat specifike të shteteve dhe të operatorëve që marrin pjesë gjatë gjithë rrugës në transportin ajror të mallrave të rrezikshme (këtej e tutje të quajtura si Kërkesa Specifike- (SR)).



Neni 4

1. Kërkesat e kësaj Rregulloreje do të zbatohen, për:

a) të gjitha fluturimet ndërkombëtare dhe kombëtare të avionëve shqiptarë dhe të huaj, kur nisja ose mbërritja është bërë në territorin e Republikës së Shqipërisë ose kur ata fluturojnë mbi hapësirën ajrore të saj;

b) të gjithë avionët që janë regjistruar në Regjistrin Shtetëror të Avionëve Civilë të Republikës së Shqipërisë, si dhe kur ata janë jashtë vendit, me përjashtim të rasteve kur atje janë në fuqi kërkesa më të larta.

2. Ministri përgjegjës për transportin mund të lejojë një përjashtim nga plotësimi i të gjithë këtyre kërkesave apo të disa kërkesave të kësaj rregulloreje në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, kur nuk mund të përdoret asnjë lloj tjetër transporti dhe kur është bërë çdo gjë tjetër e mundshme për arritjen e një niveli të përgjithshëm ekuivalent sigurie me atë të përcaktuar në këtë Rregullore.

Neni 5

1. Kërkesat e kësaj Rregulloreje nuk do të zbatohen për artikujt dhe/ose substancat, të cilët klasifikohen si mallra të rrezikshme, por janë të domosdoshëm të jenë në bord të avionit, në përputhje me kërkesat përkatëse të vlefshmërisë ajrore dhe rregullat e operimit.

2. Artikujt dhe/ose substancat, të cilët janë të destinuar si rezervë e domosdoshme në bord të avionit në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni do të transportohen në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje, me përjashtim të rasteve që përcaktohen në pjesët përkatëse të TI-së.

Neni 6

Artikujt dhe/ose substancat që janë të destinuar për përdorim personal nga pasagjerët dhe anëtarët e ekuipazhit do të përjashtohen nga kërkesat e kësaj Rregulloreje, sipas rasteve të përcaktuara në TI.

KAPITULLI 2

IDENTIFIKIMI DHE KLASIFIKIMI I
MALLRAVE TË RREZIKSHME

Neni 7

Mallrat e rrezikshme do të klasifikohen në 9 klasa, në përputhje me kushtet e përcaktuara në TI:

1. Klasa 1 - Substancat eksplozive:

a) Nënklasa 1.1 - Produkte dhe substanca që paraqesin një rrezik të eksplozionit masiv;

b) Nënklasa 1.2 - Produkte dhe substanca që paraqesin një rrezik të pritshëm por jo një rrezik shpërthimi masiv;

c) Nënklasa 1.3 - Produkte dhe substanca që paraqesin një rrezik zjarri ose një eksplozion jo të fuqishëm ose një rrezik të pritshëm ose të dyja, por jo një rrezik për shpërthim masiv;

d) Nënklasa 1.4 - Produkte dhe substanca që nuk paraqesin një rrezik të rëndësishëm;

e) Nënklasa 1.5 - Substanca mjaft të pandjeshme që nuk paraqesin një rrezik shpërthimi masiv;

f) Nënklasa 1.6 - Produkte që janë të pandjeshme në mënyrë ekstreme që nuk kanë ndonjë rrezik të shpërthimit masiv.

2. Klasa 2 - Gazrat:

a) Nënklasa 2.1 - Gazra të ndezshme;

b) Nënklasa 2.2 - Gazra të pandezshme johelmuese;

c) Nënklasa 2.3 - Gazra helmuese.

3. Klasa 3 - Lëngje të ndezshme.

4. Klasa 4 - Substanca të ngurta të ndezshme; substanca me prirje për vetëndezje spontane; substanca që lëshojnë gazra të ndezshme kur janë në kontakt me ujin:

a) Nënklasa 4.1 - Substanca të ngurta të ndezshme, substanca me vetëveprim;

b) Nënklasa 4.2 - Substanca me prirje për vetëndezje spontane;

c) Nënklasa 4.3 - Substanca që lëshojnë gazra të ndezshme kur janë në kontakt me ujin.

5. Klasa 5 - Substanca oksiduese ose perokside organike:

a) Nënklasa 5.1 - Substanca oksiduese;

b) Nënklasa 5.2 - Perokside organike.

6. Klasa 6 - Substanca helmuese dhe substanca infektuese:

a) Nënklasa 6.1 - Substanca toksike;



- b) Nënklasa 6.2 - Substanca infektuese.
7. Klasa 7 - Materiale radioaktive.
Kjo klasë nuk ka nënklasë.
8. Klasa 8 - Substanca gërryese.
Kjo klasë nuk ka nënklasë.
9. Klasa 9 - Mallra të rrezikshme të përziera.
Kjo klase nuk ka nënklasë.

Neni 8

Artikujt dhe/ose substancat që nuk janë specifikuar në nenin 7 dhe që paraqesin më shumë se një rrezik do të klasifikohen sipas rrezikut që paraqesin gjatë transportit në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në TI.

Neni 9

Artikujt dhe/ose substancat që nuk janë përmendur në nenin 7 të cilat janë referuar si “të pa specifikuar” (NS) mund të transportohen me transport ajror në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në TI.

KAPITULLI 3

KUFIZIMET NË TRANSPORTIN AJROR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME

Neni 10

Transporti ajror i mallrave të rrezikshme të paraqitura më poshtë është i ndaluar në çfarëdo rrethane:

1. Artikujt eksplozivë dhe/ose substancat, të cilët ndizen ose shpërbehen kur ekspozohen në një temperaturë prej 75°C për 48 orë.
2. Artikujt eksplozivë dhe/ose substancat që përmbajnë klorate dhe kripëra të amonit.
3. Artikujt eksplozivë dhe/ose substancat që përmbajnë përzierje të klorureve dhe të fosfateve;
4. Artikujt eksplozivë të ngurtë dhe/ose substanca të klasifikuara si mjaft të ndjeshme kundrejt përplasjeve mekanike.
5. Artikujt eksplozivë të lëngët dhe/ose substanca të klasifikuara si me ndjeshmëri mesatare kundrejt përplasjeve mekanike.

6. Artikujt dhe/ose substanca, që në kushte normale të transportit ajror mund të prodhojnë një rritje të rrezikshme të temperaturës ose gazra;

7. Artikujt të ngurtë të djegshëm dhe perokside organike që shfaqin veti eksplozive kur i teston dhe të pakeluar në një mënyrë të tillë që procedura e klasifikimit kërkon përdorimin e etiketave të rrezikut eksploziv, për shkak të rrezikut që fshehin.

Neni 11

Mallrat e rrezikshme, të cilat janë identifikuar nga TI-ja si të ndaluara për transport ajror në rrethana normale, si dhe kafshët e gjalla të infektuara nuk duhet të transportohen me avion. Megjithatë kjo mund të mos zbatohet nëse dispozitat e TI-së tregojnë se ato mund të transportohen sipas miratimit të lëshuar nga shteti i origjinës.

Neni 12

Në rastet kur zbulohen kushte që rrezikojnë sigurinë në fluturim, Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) mund t'i propozojë ministrit përgjegjës për transportin ndalimin e transportit ajror të artikujve dhe/ose substancave që nuk janë përfshirë si të kufizuara as në këtë Rregullore as dhe në TI.

KAPITULLI 4

PAKETIMI

Neni 13

Kërkesat e përgjithshme për paketimin, të përcaktuara në këtë kapitull do të zbatohen në transportin ajror të mallrave të rrezikshme me përjashtim të atyre që përfshihen në nenin 7, paragrafi 1, klasa 7. Në ato raste, përveç kërkesave të përgjithshme, duhet të plotësohen dhe kërkesat që përcaktohen në TI.

Neni 14

Mallrat e rrezikshme do të paketohen me paketim të cilësisë së mirë dhe të pacenueshëm, të projektuar dhe të mbyllur, në mënyrë të tillë që të ndalojë rrjedhjet apo derdhjet që mund të



ndodhin në kushte normale të transportit, lagështirës, presionit apo vibrimeve.

Paketimi duhet të plotësojë kërkesat e specifikimeve të TI-së për materiale dhe konstruksione.

Neni 15

1. Paketimi i tipave të vetëm apo të kombinuar, të përdorur për herë të parë apo të ripërdorur do të plotësojnë kërkesat teknike gjatë prodhimit dhe testimit në përputhje me standardet e publikuara në TI.

2. Asnjë paketim nuk do të ripërdoret deri sa ai të jetë inspektuar dhe të jetë gjetur pa korrozion apo dëmtime të tjera. Kur një paketim ripërdoret, duhet të merren të gjitha masat për të ndaluar ndotjen e përmbajtjes së ngarkesës pasardhëse.

Neni 16

Paketimi, i cili është në kontakt direkt me substancat e rrezikshme duhet të jetë rezistent kundrejt çdo kimikati apo nga ndonjë efekt tjetër i këtyre substancave. Materialet nga të cilat do të përgatiten paketimet nuk do të përmbajnë substanca të cilat mund të reagojnë në mënyrë të rrezikshme me përmbajtjet, nga përbërësit e rrezikshëm ose që përkeqësojnë në mënyrë të konsiderueshme karakteristikat e tyre.

Neni 17

Kur një ose më shumë pako vendosen në një pako të përbërë, mallrat e rrezikshme nuk do të paketohen në të njëjtin paketim të jashtëm me mallrat e rrezikshme ose mallra të tjera, në rast se ato reagojnë në mënyrë të rrezikshme me njëri-tjetrin. Pakoja e përbërë përmban vetëm pako të mallrave të lejueshme për t'u transportuar sipas kërkesave përkatëse të TI-së dhe se pakoja e përbërë duhet të jetë e shënuar dhe etiketuar siç kërkohet nga kërkesat respektive të TI-së.

Neni 18

1. Paketimi, funksioni bazë i të cilit është mbajtja e lëngjeve, duhet të jetë në gjendje t'i

rezistojë, pa rrjedhur, presionit të përcaktuar në TI.

2. Kontejnerët dhe paketimi i brendshëm do të bëhen të sigurt nga thyerjet, përhapja apo përzierja e substancave, nëpërmjet bashkuesve apo materialeve thithëse. Materialet e veshjes së brendshme dhe materialet thithëse nuk duhet të reagojnë në mënyrë të rrezikshme me përmbajtjen e pakos. Paketimi do të kryhet në përputhje me udhëzimet e paketimit të përcaktuara në TI.

Neni 19

Paketimi do të bëhet me dimensione të tilla që të ketë hapësirë të mjaftueshme për të vendosur të gjitha etiketat dhe shënimet, përveçse kur përcaktohet ndryshe në TI.

KAPITULLI 5 SHËNIMET DHE ETIKETIMI

Neni 20

Çdo paketim i mallrave të rrezikshme do të etiketohet me etiketën e saktë të mallrave të rrezikshme sipas përcaktimeve të TI-së.

Neni 21

Çdo paketim me mallra të rrezikshme do të shënohet me emrin ekzakt të dërguesit të mallit, të përmbajtjes së tij, numrin e përcaktuar nga OKB-ja, si dhe me shënime të tjera sipas përcaktimeve në TI.

Neni 22

Mbishkrimi i shigjetave nuk do të lejohet në paketime që përmbajnë mallra të rrezikshme të lëngëta, për qëllime të tjera nga tregimi i orientimit respektiv të pakos.

Neni 23

1. Në shtesë të gjuhës që mund të kërkohet nga vendi i dërgimit të mallit, për mbishkrimet lidhur me mallrat e rrezikshme do të përdoret dhe gjuha angleze.



2. Çdo pako me mallra të rrezikshme (përfshirë materialet radioaktive) do të shënohet dhe etiketohet me etiketat për mallrat e rrezikshme të treguara në pjesët përkatëse të TI-së.

Neni 24

1. Të gjitha shënimet dhe etiketat duhet të vendosen në pako ose pakot e përbëra në mënyrë të tillë, që të mos mbulohen apo të errësohen nga asnjë pjesë apo shtojcë që i ngjitet pakos nga ndonjë etiketë apo shënim tjetër. Shënimet e kërkuara nuk duhet të ndodhen së bashku me shënime të tjera të pakos, të cilat mund të ulin efikasitetin e tyre.

2. Të gjitha shënimet duhet të jenë:

a) të qëndrueshme dhe të printuara ose ndryshe të shënuara mbi pako ose të fiksuara në sipërfaqen e jashtme të pakos apo pakove të përbëra;

b) të dukshme dhe të lexueshme qartë;

c) të afta për t'i qëndruar ekspozimit në mot të hapur pa ulur efikasitetin e tyre bazë; dhe

d) të ekspozuara në një sfond me ngjyrë kontrasti.

3. Materiali i çdo etikete, printimi dhe çdo ngjitje mbi to duhet të jetë mjaft i qëndrueshëm për të përballuar kushtet normale të transportit përfshirë ekspozimin në ambient të hapur pa ulur dukshëm efikasitetin e tyre, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në TI.

KAPITULLI 6

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E DËRGUESIT TË MALLIT

Neni 25

1. Përpara dorëzimit të çdo malli të rrezikshëm për transport ajror, dërguesi i mallit duhet të garantojë, se:

a) mallrat nuk janë të ndaluar për t'u transportuar me ajër në asnjë rrethanë sipas përcaktimeve të TI-së;

b) në rast se mallrat janë të ndaluara për transport ajror dhe pa miratim, atëherë është përgjegjësia e dërguesit të mallit të marrë të gjitha miratimet në vendin që përcaktojnë udhëzimet teknike (TI);

c) mallrat klasifikohen në përputhje me kriteret e klasifikimit, sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe të TI-së;

d) mallrat janë paketuar në përputhje me kërkesat e kapitullit 4 të kësaj Rregulloreje;

e) pakot janë shënuar dhe etiketuar në përputhje me kërkesat e kapitullit 5 të kësaj rregulloreje;

f) paketimi është në gjendje të përshtatshme për transport ajror;

g) kur përdoret një “pako e përbërë”, atëherë kjo pako nuk duhet të përmbajë pako të cilat kanë në përbërje të tyre substanca të ndryshme që mund të reagojnë në mënyrë të rrezikshme me njëra-tjetrën ose pako me mallra të rrezikshme, të cilat kërkojnë ndarje njëra nga tjetra në përputhje me kërkesat e TI-së.

2. Kur paraqiten mallrat e rrezikshme për transport, dërguesi i mallit do të paraqesë “deklaratën e dërguesit të mallit” të përgatitur dhe të firmosur nga ai. Ajo duhet të përmbajë kërkesat e nevojshme në përputhje me kërkesat e TI-së, sipas një modeli që paraqitet në shtojcën nr. 1 të kësaj Rregulloreje.

3. Deklarata e dërguesit të mallrave do të përgatitet në dy kopje dhe do t'i bashkëlidhet Policë-Ngarkesës Ajrore (AWB). Një kopje do të mbahet nga transportuesi dhe kopja tjetër do të shoqërojë mallin.

4. Policë-Ngarkesa Ajrore duhet të tregojë në mënyrë të qartë që pakoja përmban mallra të rrezikshme, siç përshkruhet në deklaratën shoqëruese të dërguesit të mallit. Në të do të futet informacioni i nevojshëm i treguar në pjesën përkatëse të TI-së.

5. Përveç gjuhës që mund të kërkohej nga vendi i dërgesës, për plotësimin e deklaratës së dërguesit të mallrave që shoqëron mallrat e rrezikshme, do të përdoret dhe gjuha angleze.

Neni 26

Dërguesi i mallit do të dorëzojë mallrat e rrezikshme në aeroportin e ngarkimit ekzaktësisht në kohën e rënë dakord me transportuesin. Magazinimi i mallrave të rrezikshme në aeroport nuk do të lejohet me përjashtim të rasteve kur atje ka vende magazinimi të përgatitura në mënyrë të veçantë për këtë qëllim.



KAPITULLI 7 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E OPERATORIT (TRANSPORTUESIT)

Neni 27

1. Asnjë avion nuk do të transportojë apo të ketë ngarkuar në bord ndonjë mall të rrezikshëm, përveçse kur:

a) operatori është i miratuar sipas kësaj Rregulloreje; dhe

b) këto mallra të rrezikshme janë transportuar ose ngarkuar, në përputhje me:

i. të gjitha kushtet nga të cilat varet ky miratim; dhe

ii. në përputhje me TI-në.

2. Miratimi sipas kësaj Rregulloreje:

a) do të jepet nga AAC-ja në rast se ai është i bindur se operatori është kompetent për të kryer transport të sigurt të mallrave të rrezikshme;

b) do të jetë me shkrim; dhe

c) do të jetë i kushtëzuar nga kushte të tilla, të cilat konsiderohen të përshtatshme nga AAC-ja.

Neni 28

1. Detyrimet e transportuesit do të shtrihen, gjithashtu, dhe tek agjentët e tij të shërbimeve.

2. Në vartësi të paragrafëve 3 dhe 4 asnjë person nuk do të:

a) dërgojë apo do të shkaktojë dërgimin për transport në, ose

b) marrë apo do të shkaktojë marrjen në bord, të një avioni mallra të rrezikshme, të cilat ai i njeh ose duhet t'i njohë ose dyshon të jenë mallra të afta për të sjellë rrezik për shëndetin, sigurinë, pronën apo ambientin kur transportohen nëpërmjet transportit ajror, përveçse kur janë plotësuar kërkesat e TI-së dhe paketimi i këtyre mallrave është në kushte të përshtatshme për transport ajror.

3. Në vartësi të paragrafit 4, kjo Rregullore nuk do të zbatohet për ato mallra të rrezikshme të specifikuar në TI, që janë:

a) për vetë lundrimin ose sigurinë e fluturimit;

b) për të siguruar, gjatë fluturimit, ndihmë mjekësore për ndonjë pacient;

c) për të siguruar, gjatë fluturimit, ndihmë veterinare për kafshët e gjalla;

d) për të siguruar, gjatë fluturimit, ndihmë në lidhje me operimet e kërkim shpëtimit;

e) të lejuara për transport nga pasagjerët ose anëtarët e ekuipazhit; ose

f) për përdorim ose shitje gjatë fluturimit në fjalë.

4. Mallrat e specifikuar në paragrafin 3 do të transportohen, vetëm me kushte që:

a) ato të përputhen me kërkesat e aplikueshme të TI-së;

b) mallrat e specifikuar në nënparagrafin 3(a) do të transportohen, vetëm nëse:

i. ato janë kërkuar të transportohen në avion për përdorim në atë avion për qëllim të mbarëvajtjes së fluturimit, në përputhje me praktikatat normale;

ii. kur ato do të përdoren si pjesë këmbimi ose janë hequr për t'u zëvendësuar, ato janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në TI;

c) mallrat e specifikuar në nënparagrafin 3(b) dhe 3(c) do të transportohen, vetëm nëse:

i. ato janë ose mund të përdoren gjatë fluturimit;

ii. ato janë ose mund të kërkohen për përdorim gjatë një fluturimi pasues nga i njëjti avion dhe se nuk do të jetë praktikë ngarkimi i mallrave në avion në periudhën ndërmjetëse përpara fillimit të këtij fluturimi pasues; ose

iii. ato janë përdorur ose mund të jenë kërkuar për t'u përdorur gjatë fluturimit të mëparshëm nga i njëjti avion dhe se nuk ka qenë e mundur praktikisht që të shkarkoheshin nga avioni që nga ai fluturim;

d) mallrat e specifikuar në nënparagrafin 3(e) do të merren vetëm nga pasagjerët ose anëtarët e ekuipazhit, në rast se ato janë në përputhje me parashikimet e TI-së;

e) mallrat e specifikuar në nënparagrafin 3(f) do të transportohen vetëm nëse udhëzimet teknike i identifikojnë ato se janë artikuj që janë transportuar në një avion për shitje ose përdorim gjatë fluturimit ose, kur ato do të përdoren për zëvendësim për këto artikuj apo janë hequr për t'u zëvendësuar, ato janë transportuar në përputhje me kërkesat e TI-së.

Neni 29

1. Operatori i një avioni, që fluturon për qëllime të transportit publik, do të garantojë:



a) se të gjitha manualët përkatëse, përfshirë manualin e operimeve, përmbajnë informacion rreth mallrave të rrezikshme, në mënyrë që stafi i tokës dhe anëtarët e ekuipazhit të mund të kryejnë detyrat e tyre, në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme, përfshirë veprimet që duhet të ndërmerren në rastet e emergjencave që përfshijnë mallrat e rrezikshme.

b) Atje ku është e zbatueshme, operatori do të garantojë se ky informacion u është dhënë agjenteve të tij të shërbimeve në tokë. Detyrimet e transportuesit do të shtrihen edhe tek agjentët e tij.

2. Operatori i një avioni në të cilin transportohen mallra të rrezikshme, si kargo, do të garantojë që, përpara se të fillojë fluturimi, komandanti i avionit është pajisur, me:

a) informacionin e shkruar (sipas shtojcës nr. 2) për mallrat e rrezikshme, siç specifikohet në TI; dhe

b) informacionin për ta përdorur në përgjigje të ndonjë emergjence në fluturim, siç përcaktohet në pjesët përkatëse të TI-së.

3. Operatori i një avioni, i cili është i përfshirë në një aksident apo incident të avionit në Republikën e Shqipërisë do të njoftojë pa vonesë AAC-në shqiptare për çdo mall të rrezikshëm që po transporton si ngarkesë në avion.

Neni 30

1. Operatori i një avioni, në të cilin do të transportohen mallra të rrezikshme do të garantojë që asnjë pako, pako e përbërë apo kontejner malli, i cili përmban mallra të rrezikshme nuk është pranuar për transport në avion, përderisa kjo pako, pako e përbërë apo kontejner malli të jetë inspektuar, për të përcaktuar që:

a) të garantojë për sa është e arsyeshme, se në asnjë rrethane, mallrat nuk janë të ndaluar për transport ajror, sipas përcaktimeve të TI-së;

b) të garantojë për sa është e arsyeshme, që mallrat janë klasifikuar siç kërkohet nga TI-ja;

c) të garantojë për sa është e arsyeshme, që mallrat janë paketuar sipas kërkesave të TI-së;

d) Pako, pako e përbërë apo kontejner i mallrave është shënuar dhe etiketuar në përputhje me kushtet e TI-së;

e) Pako, pako e përbërë apo kontejner i mallrave nuk ka rrjedhje apo dëmtime që të derdhet përmbajtja.

2. Operatori i një avioni në të cilin do të transportohen mallra të rrezikshme do të garantojë se asnjë pako, pako e përbërë apo kontejner mallrash, të cilët përmbajnë mallra të rrezikshme, nuk do të pranohet për transport në atë avion, përveçse kur ai është i shoqëruar me dokumentet e transportit të mallrave të rrezikshme, me përjashtim të rasteve kur TI-ja përcakton se këto dokumente nuk kërkohen dhe se do të inspektojë këto dokumente për të përcaktuar që ato përputhen me kushtet e TI-së.

3. Udhëzimet e veçanta lidhur me pranimin e paketimeve të jashtme përmbahen në TI.

4. Për qëllim të secilit nga inspektimet e kërkuara nga paragrafët 1 dhe 2 më sipër:

a) do të përdoret një listë kontrolli pranimi dhe rezultatet e inspektimit do të shënohen në të.

b) listëkontrolli i pranimi do të jetë i një forme të tillë që të parashikojë përfshirjen e këtyre detajeve për të mundësuar që inspektimi përkatës të jetë bërë i plotë dhe i saktë, duke iu referuar plotësimi të listës. Modeli i listëkontrollit që do të përdoret është sipas shtojcave nr. 3 dhe nr. 3A.

5) Operatori i një avioni në të cilin do të transportohen mallra të rrezikshme ka të drejtën të inspektojë pakot, pakot e përbëra dhe kontejnerët e mallit të cilët përmbajnë mallra të rrezikshme dhe dokumentet që shoqërojnë ato për përputhjen me kërkesat e kësaj Rregulloreje si në prezencë ashtu dhe në mungesë të përfaqësuesit të dërguesit të mallit. Sapo të zbulojë ndonjë shkelje lidhur me përmbajtjet, paketimin, shënimin apo dokumentet që shoqërojnë pakon, operatori do të ketë të drejtën të refuzojë ngarkesën ose ta ndërpresë atë në çdo pikë të rrugës. Operatori do të njoftojë menjëherë dërguesin për veprimin e ndërmarrë.

Neni 31

1. Operatori i një avioni, në të cilin do të transportohen mallra të rrezikshme si ngarkesë, do të garantojë që mallrat e rrezikshme nuk janë transportuar në ndonjë ndarje të zënë nga pasagjerët apo në kuvertën e fluturimit, me



përfashtim të rrethanave të lejuara nga kushtet e përcaktuara në TI.

2. Operatori i një avioni në të cilin do të transportohen mallra të rrezikshme do të garantojë që çdo pako, pako e përbërë apo kontejner malli, të cilët përmbajnë mallra të rrezikshme është ngarkuar, ndarë, stivuar dhe siguruar në avion, në përputhje me kushtet e përcaktuara në TI.

3. Operatori i një avioni në të cilin do të transportohen mallra të rrezikshme do të garantojë që pakot, pakot e përbëra dhe kontejnerët e mallit që kanë një tregues se ato mund të transportohen vetëm në avion mallrash, janë ngarkuar, stivuar dhe fiksuar në një mënyrë të tillë që të ndalojë çdo lëvizje gjatë së cilës ato mund të ndryshojnë gjendjen e pakove, në përputhje me kushtet e përcaktuara në TI dhe nuk janë ngarkuar në një avion që transporton pasagjerë.

4. Pakot me mallra të rrezikshme të etiketuara si “vetëm për avion mallrash” do të ngarkohen në një mënyrë të tillë që një anëtar i ekuipazhit ose një person tjetër i autorizuar të jetë në gjendje t’i inspektojë dhe nëse është e nevojshme dhe ku e lejon vendi dhe pesha t’i ndajë këto pako nga mallrat e tjera gjatë fluturimit. Kjo nuk do të zbatohet në rastet e treguara në përcaktimet e TI-së.

5. Avionët e mallrave do të ngarkohen dhe do të shkarkohen në vende të përgatitura dhe pajisura në mënyrë të veçantë në zonën e aeroportit, në një vend dhe distancë të tillë, në mënyrë që ato të mos rrezikojnë jetën e njerëzve në aeroport dhe në ndërtesat përreth si dhe pajisjet dhe sigurinë e fluturimit për avionët e tjerë.

Neni 32

Kontrolli për pranimin dhe dërgimin e mallrave të rrezikshme për transport ajror nga shërbimi postar do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara nga Posta Shqiptare, në përputhje me procedurat ndërkombëtare për kontrollin dhe paraqitjen e mallrave të rrezikshme për transport ajror nëpërmjet shërbimeve postare të përcaktuara nga Bashkimi i Përgjithshëm i Postave, në koordinim me ministrin përgjegjës për transportin.

Neni 33

Në rast se rruga për transportin ajror të mallrave të rrezikshme kërkon që transporti të kryhet me avionë të dy ose më shumë transportuesve, operatori i parë, i cili ka marrë kërkesën për këtë transport mund të konfirmojë kryerjen e tij, vetëm pasi të ketë marrë konfirmimin nga të gjithë transportuesit që marrin pjesë në transportin ajror të mallrave të rrezikshme.

Neni 34

1. Operatori i një avioni në të cilin do të transportohen mallra të rrezikshme do të garantojë se pakot, pakot e përbëra apo kontejnerët e mallrave janë inspektuar për të evidentuar ndonjë rrjedhje apo dëmtim përpara se të ngarkohen në avion apo të vendosen në një njësi unike ngarkimi.

2. Operatori i një avioni në të cilin do të ngarkohen mallra të rrezikshme do të garantojë se njësia unike e ngarkimit që përmban mallra të rrezikshme nuk do të ngarkohet përveçse kur ajo është inspektuar dhe është gjetur pa asnjë shenjë rrjedhjeje apo dëmtimi në pakot, pakot e përbëra apo kontejnerët e mallrave që ajo përmban.

3. Operatori i një avioni në të cilin do të ngarkohen mallra të rrezikshme do të garantojë se asnjë pako, pako e përbërë apo kontejner mallrash, të cilët përmbajnë mallra të rrezikshme, nuk do të ngarkohet në avion, nëse kanë rrjedhje apo dëmtime.

4. Operatori i një avioni në të cilin do të ngarkohen mallra të rrezikshme do të garantojë se asnjë pako, pako e përbërë apo kontejner mallrash, të cilët përmbajnë mallra të rrezikshme që janë gjetur me rrjedhje apo dëmtime në një avion janë, hequr nga avioni dhe se mallrat apo bagazhet e tjera në avion janë në gjendje të përshtatshme për transport ajror dhe nuk kanë ndotje.

5. Operatori i një avioni në të cilin do të ngarkohen mallra të rrezikshme do të garantojë se pas shkarkimit, të gjitha pakot, pakot e përbëra apo kontejnerët e mallrave të cilët përmbajnë mallra të rrezikshme janë inspektuar për shenja dëmtimi apo rrjedhje dhe nëse ka gjurmë të tilla do të garantojë se çdo pjesë e avionit ku kanë



qenë vendosur pakot, pakot e përbëra apo kontejnerët e mallrave, çdo material lidhës ose aparat tjetër që është përdorur për të fiksuar mallrat nën avion është inspektuar për dëmtime apo ndotje.

Neni 35

Operatori i një avioni në të cilin do të transportohen mallra të rrezikshme do të garantojë se çdo ndotje e gjetur, si rrjedhojë e rrjedhjes apo e dëmtimit të pakove, pakove të përbëra apo kontejnerëve të mallrave është hequr pa vonesë.

Neni 36

1. Kur janë pranuar apo transportuar substanca infektive apo helmuese ose materiale radioaktive, transportuesi duhet të marrë në konsideratë kërkesat e veçanta të përcaktuara në TI.

2. Substancat e shënuara ose të ditura si helmuese ose infektuese (klasa 6) nuk do të transportohen në të njëjtin seksion së bashku me kafshët e gjalla, produktet ushqimore, ushqimin për kafshët apo medikamente. Njësitë e veçanta të mallrave që përmbajnë substanca helmuese ose infektuese nuk do të vendosen në bord të një avioni ngjitur me njësinë unike të ngarkesës (ULD), që përmban produkte ushqimore, ushqime për kafshët apo medikamente.

Neni 37

Një avion i ndotur me materiale radioaktive do të ndalohet menjëherë nga operimi për sa kohë që nivelet e rrezatimit në çdo sipërfaqeje të arritshme të tij, si dhe ndotja e lirë kalojnë vlerat e treguara në TI.

Neni 38

Pakot me materiale radioaktive të ngarkuara në një avion do të jenë të ndara nga njerëzit, kafshët e gjalla dhe materialet fotografike të pazhvilluara, duke mbajtur distancat e ndarjes të treguara në tabelat përkatëse të TI-së.

Neni 39

Ngarkimi dhe shkarkimi i avionëve që transportojnë mallra të rrezikshme do të kryhet në përputhje me rregullat nga punonjës të trajnuar dhe të instruktuar në mënyrë të veçantë, ndërkohë që merren masat e nevojshme për sigurinë dhe higjienën e punonjësve, masa parandaluese për zjarrin etj., në përputhje me aktet respektive rregullatore.

Neni 40

Në manualin e tij të fluturimit, operatori do të japë informacion të tillë, i cili përcakton të drejtat dhe detyrimet e ekuipazhit lidhur me transportin e mallrave të rrezikshme dhe udhëzime për veprimet që duhet të merren, në rast të situatave emergjente që ndodhin gjatë transportimit të mallrave të rrezikshme.

Neni 41

Në rast se gjatë fluturimit dalin situata emergjente, komandanti i avionit që transporton mallra të rrezikshme, do të informojë kontrollin përkatës të trafikut ajror për mallrat e rrezikshme që ka në bord të avionit. Në rast se situata emergjente e lejon, informacioni do të përfshijë emrin e saktë të ngarkesës, klasën, rreziqet shtesë për çdo etiketë, grupin e përshtatshmërisë për klasën 1 dhe sasinë dhe vendndodhjen e mallrave të rrezikshme në bord të avionit.

Neni 42

Kur ka ndodhur një aksident me një avion që transporton mallra të rrezikshme, operatori do të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur vendin në të cilin ka ndodhur aksidenti rreth mallrave të rrezikshme të transportuara së bashku me emrin e tyre të saktë, klasën, rreziqet shtesë për çdo etiketë, grupin e përputhshmërisë për klasën 1 dhe sasinë dhe vendndodhjen e mallrave të rrezikshme në bord të avionit.

Neni 43

Kur shfaqet një parakusht për një aksident për një avion që transporton mallra të rrezikshme,



me kërkesën e vendit në të cilin ka lindur parakushti, transportuesi do të japë informacionin e nevojshëm për të minimizuar rreziqet që krijohen, si rrjedhojë e ndonjë dëmtimi të mallrave të rrezikshme të transportuara.

KAPITULLI 8 KUALIFIKIMI I STAFIT

Neni 44

1. Dërguesi i mallrave dhe çdo agent i tij do të garantojë që përpara se të ofrohet nga ai një dërgesë mallrash të rrezikshme për transport ajror, të gjithë personat e përfshirë në përgatitjen e tij janë trajnuar sipas specifikimeve të përcaktuara në TI, për të mundësuar ata që të kryejnë detyrat e tyre lidhur me transportin ajror të mallrave të rrezikshme.

2. Një operator shqiptar dhe çdo agent i tij do të garantojë se i gjithë stafi përkatës i përfshirë në transportin ajror të pasagjerëve ose të mallrave:

a) ka kryer trajnimin që përputhet me nënparagrafët “c” dhe “d”;

b) operatori i një avioni do të garantojë se stafi i agentëve të tij të shërbimeve në tokë ka kryer këtë trajnim;

c) trajnimi do të specifikohet në TI.

d) trajnimi është miratuar sipas paragrafit 8 të këtij neni.

3. Agjenti i një operatori joshqiptar do të garantojë:

a) se i gjithë stafi i përfshirë në transportin ajror të pasagjerëve dhe të mallrave kanë marrë trajnimin, i cili përputhet me nënparagrafët “b” dhe “c” më poshtë;

b) trajnimi do të jetë sipas specifikimeve në pjesët përkatëse të TI;

c) trajnimi është miratuar sipas paragrafit 8.

4. Përmbajtja e programeve të trajnimit do të jetë sipas specifikimit të bërë në TI.

5. Programet e trajnimit fillestar dhe periodik do të vendosen dhe do të mbahen nga ose në emër të dërguesit të mallrave apo të agentëve të tij, operatori i një avioni nëse ai është një operator shqiptar dhe agjenti i operatorit pavarësisht nëse ai është operator shqiptar apo joshqiptar, në përputhje me përcaktimet e TI-së. Trajnimi periodik do të kryhet detyrimisht

brenda 24 muajve nga data e trajnimit të mëparshëm. Kërkesat minimale të trajnimit janë sipas shtojcës nr. 4 të kësaj rregulloreje.

6. Regjistrimet e trajnimit do të mbahen sipas specifikimeve të përcaktuara në TI.

7. Asnjë person nuk do të ofrojë apo kryejë trajnimet e kërkuara sipas kësaj pjese të Rregullores, përveçse kur:

a) ai ka:

i. marrë një miratim si instruktor trajnimi sipas paragrafit 9 të këtij neni; dhe

ii. trajnimi është miratuar sipas paragrafit 8 të këtij neni.

8. Miratimi i trajnimit, sipas kësaj rregulloreje, do të:

a) jepet me shkrim nga AAC-ja, në rast se ai është i bindur se forma dhe përmbajtja e trajnimit është e përshtatshme për qëllimin e tij; dhe

b) i kushtëzuar nga kushte të tilla që AAC-ja i konsideron si të përshtatshme dhe, në veçanti, mund të përfshijë një kusht që trajnimi të kryhet nga një person i cili mban miratimin e instruktorit të trajnimit të dhënë apo të njohur nga AAC-ja, sipas paragrafit 9.

c) instruktori i kurseve të trajnimit të mallrave të rrezikshme duhet të ketë minimumi kualifikimet e mëposhtme:

i. instruktorët duhet të demonstrojnë nivelin e aftësive “të përparuar”, në lidhje me funksionet me të cilat merren;

ii. një instruktor duhet të ketë njohuri aktuale të rregulloreve kombëtare të aviacionit civil të mallrave të rrezikshme dhe prova të miratimit si instruktor i mallrave të rrezikshme nga shteti i operatorit nëse kërkohet;

iii. instruktorët të kenë njohuri dhe përvojë pune 3-vjeçare (trevjeçare) në mallra të rrezikshme dhe operacione sigurie ose përvojë në operacione të ngarkesave, përfshirë kryerjen e funksionit në të cilin po trajnohen.

Një alternativë ndaj kësaj përvojë pune është një program trajnimi i dedikuar për instruktorë, i cili do të plotësonte kërkesat. Kërkohet dëshmi nga punëdhënësi që instruktori ka kaluar një program të tillë ose kërkohet një program i miratuar nga shteti i operatorit;

iv. instruktorët, gjithashtu, duhet të ndërmarrin një program të përvojës “praktikë”/



“në punë” në një shumëllojshmëri funksionesh që kërkojnë trajnim për mallra të rrezikshme.

9. Miratimi i instruktorit të trajnimit, sipas kësaj rregulloreje, do të:

a) jepet me shkrim nga AAC-ja kur personi ka kryer trajnimin përkatës të instruktorit për mallrat e rrezikshme nga një organizatë trajnimi e miratuar ose e pranuar nga AAC-ja, dhe kur ai është i bindur që personi është kompetent për të kryer trajnimin e specifikuar në miratimin e dhënë, sipas paragrafit 8; dhe

b) i kushtëzuar nga kushte të tilla që AAC-ja i konsideron të përshtatshme.

KAPITULLI 9 INFORMIMI I PASAGJERËVE LIDHUR ME MALLRAT E RREZIKSHME

Neni 45

1. Operatori i aeroportit dhe operatori i avionit, i cili fluturon për transportin publik të pasagjerëve ose agentët e tyre do të garantojnë se personat që janë ose do të bëhen pasagjerë të një avioni që fluturon për qëllime të transportit publik janë njoftuar për llojin e mallrave të rrezikshme, të cilat janë të ndaluara që t'i transportojnë me avion, si bagazh i kontrolluar (bagazh hambari) ose më vete si bagazh dore, duke vënë njoftime të mjaftueshme në numër dhe në vende të dukshme për këtë qëllim:

a) në çdo vend të një aeroporti ku lëshohen biletat;

b) në çdo zonë të aeroportit ku mbledhen pasagjerët për të hipur në avion; dhe

c) në çdo vend ku mund të kontrollohet pasagjeri për nisje.

2. Operatori i një avioni që fluturon për qëllime të transportit publik të pasagjerëve apo agjenti i tij do të garantojë që pasagjerët janë njoftuar për llojin e mallrave të rrezikshme që ata janë të ndaluar të marrin si bagazh i kontrolluar ose si bagazh dore më vete ose duke dhënë informacion në çdo biletë të pasagjerit, të mjaftueshëm për këtë qëllim, ose nëpërmjet mjeteve të tjera të përshtatshme të tilla që pasagjerët të marrin një njoftim shtesë nga ai i kërkuar në paragrafin 1.

3. Çdo person, i cili pret bileta në Shqipëri për transport ajror do të garantojë që personat të

cilët janë ose do të bëhen pasagjerë në një avion, i cili fluturon për qëllime të transportit publik janë njoftuar për llojet e mallrave të rrezikshme, të cilat ata janë të ndaluar t'i transportojnë në avion si bagazh i kontrolluar (hambari) ose më vete si bagazh dore, duke vënë njoftime të mjaftueshme në numër dhe të dukshme për këtë qëllim në vendet ku shiten biletat për fluturimin.

Neni 46

Operatori i një avioni për transport mallrash dhe çdo agjent i tij do të garantojnë se janë vendosur njoftimet me informacion rreth mallrave të rrezikshme në numër të mjaftueshëm dhe në vende të dukshme për këtë qëllim, në ato vende ku këto mallra do të pranohen për transport.

KAPITULLI 10 DOKUMENTET DHE REGJISTRIMET, FUQITË ZBATUESE DHE PËRGJITHËSIMET

Neni 47

1. Operatori i një avioni që transporton mallra të rrezikshme, si mallra do të garantojë se një kopje e dokumenteve të transportit të mallrave të rrezikshme të kërkuara nga neni 30(2) i kësaj Rregulloreje dhe informacioni i shkruar për komandantin i kërkuar, sipas nenit 29 (2)(a) të kësaj rregulloreje, janë ruajtur në një vend që mund të gjenden lehtë deri në fund të periudhës së fluturimit në të cilin janë transportuar mallrat.

2. Operatori i avionit në të cilin janë transportuar mallrat e rrezikshme do të ruajë për jo më pak se tre muaj:

a) çdo dokument të mallrave të rrezikshme ose dokumente të tjera lidhur me mallrat e rrezikshme të cilat i janë furnizuar atij nga dorëzuesi i mallrave, në përputhje me nenin 30(2) të kësaj Rregulloreje;

b) regjistrimet e çdo liste kontrolli pranimi, në përputhje me nenin 30(4) të kësaj Rregulloreje; dhe

c) informacionin me shkrim të komandantit sipas kërkesave të nenit 29(2)(a).

3. Regjistrimet referuar paragrafit 2(b) të këtij neni duhet të jenë në një formë të lexueshme.



Neni 48

1. Operatori i një avioni në të cilin janë ose do të transportohen mallra të rrezikshme dhe çdo agjent i tij do t'i prodhojë një personi të autorizuar, brenda një kohe të arsyeshme mbasi ky person t'i ketë kërkuar, këto dokumente të mëposhtme, sipas kërkesës së këtij personi:

i. miratimin me shkrim sipas përcaktimit të nenit 27(1) të kësaj Rregulloreje;

ii. dokumentet e transportit të mallrave të rrezikshme, siç referohet në nenin 30(2) të kësaj Rregulloreje;

iii. listëkontrollin e pranimit të plotësuar në një formë të lexueshme, lidhur me mallrat e rrezikshme, sipas referimit të nenit 30(4) të kësaj Rregulloreje; dhe

iv. një kopje të informacionit të shkruar të dhënë komandantit të avionit, lidhur me mallrat e rrezikshme, sipas referimit të nenit 29(2)(a) të kësaj Rregulloreje.

2. Operatori i avionit, dërguesi i mallit ose çdo agjent i ndonjërit prej tyre apo të gjithë së bashku, do të prodhojnë për çdo person të autorizuar, brenda një kohe të arsyeshme, mbasi t'i jetë bërë kërkesa, çdo dokument i cili lidhet me mallrat të cilat personi i autorizuar ka arsye të bazuara të dyshojë se janë mallra të rrezikshme, në lidhje me kushtet me të cilat përputhet kjo Rregullore.

Neni 49

1. Një person i autorizuar mund të ekzaminojë, të marrë mostra dhe të ndalojë të gjitha mallrat për të cilat personi i autorizuar ka arsye të bazuara të dyshojë se mund të jenë mallra të rrezikshme që nuk janë në përputhje me përcaktimet e kësaj Rregulloreje.

2. Një person i autorizuar mund të hapë ose të kërkojë hapjen e çdo bagazhi ose pakoje për të cilat personi i autorizuar ka arsye të bazuara të dyshojë se ato mund të përmbajnë mallra të rrezikshme të cilat nuk përputhen me kërkesat e kësaj rregulloreje.

3. Për sa u përket mostrave, ato duhet që:

a) Në vartësi të paragrafit 5, çdo mostër e marrë apo mall i ndaluar nga personi i autorizuar, sipas kësaj rregulloreje do të mbahet ose do të ndalohet për sa kohë që AAC-ja e konsideron të

nevojshme në çdo rrethanë dhe do të sistemohet në një mënyrë të tillë që AAC-ja e konsideron të përshtatshme në të gjitha rrethanat.

b) Pa paragjykuar në përgjithësimin e nënparagrafit (a), çdo mostër e marrë apo mallra të ndaluar sipas kësaj rregulloreje mund të mbahen ose ndalohen respektivisht:

i. për t'u përdorur si evidencë në një gjyq për një kundërvajtje; ose

ii. për ekzaminim ligjor ose për hetime, në lidhje me një kundërvajtje.

4. Për artikujt e mbajtur ose të ndaluar:

a) personi të cilit i janë mbajtur mallrat nga një person i autorizuar, sipas kësaj Rregulloreje mund të aplikojë tek AAC-ja që artikulli t'i kthehet atij.

b) aplikimi sipas këtij paragrafi do të bëhet me shkrim dhe do të shoqërohet me evidencën e pronësisë së aplikuesit;

c) kur AAC-ja është e bindur se aplikuesi është pronar i artikullit në fjalë dhe se nuk është e nevojshme ndalimi i mëtejshëm i tij për qëllim të hapjes së ndonjë procedure penale, ai do të marrë masat që t'i kthejë aplikuesit artikullin në fjalë.

5. Kur mbajtja e mëtejshme e mallrave nuk është më e nevojshme, sipas gjykimit të AAC-së, dhe asnjë aplikim nuk është bërë sipas paragrafit 4 më sipër ose ndonjë aplikim i tillë nuk ka qenë i rregullt, atëherë mallrat do të shkatërrohen sipas udhëzimeve të AAC-së.

KAPITULLI 11

RAPORTIMI I NGJARJEVE

Neni 50

1. Një operator shqiptar do të garantojë se çdo aksident me mallra të rrezikshme, incident me mallra të rrezikshme ose gjetjen e mallrave të rrezikshme të padëklaruara në mallrat apo bagazhet e pasagjerëve, kudo që ndodh kjo, raportohet tek AAC-ja.

2. Një operator joshqiptar do të garantojë se çdo aksident me mallra të rrezikshme, incident me mallra të rrezikshme apo gjetje e mallrave të rrezikshme të padëklaruara në mallrat ose bagazhet e pasagjerëve, të cilat ndodhin në Republikën e Shqipërisë, raportohet tek AAC-ja.



3. Raporti që kërkohet, sipas paragrafit 1 ose 2, do të përmbajë informacionin e mëposhtëm sipas përkatësisë së ngjarjes:

- a) datën e ngjarjes;
- b) vendin e ndodhjes së ngjarjes, numrin e fluturimit dhe datën e fluturimit;
